

Universiteti i EJL  
ЈИЕ Универзитет  
SEE University



Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore  
Факултет за Современи Општествени Науки  
Faculty of Contemporary Social Science

**Punim magjistrature në temë**  
**PROCESET DHE LËVIZJET SOCIO-EKONOMIKE NË**  
**RAJONIN E POLLOGUT NË PERIUDHËN 2000-2020**

Kandidat  
Haqif Kodra

Mentor  
Prof.dr. Agron Rustemi

*Tetovë , 2021*

### **Deklarata e ndershmërisë**

Unë Haqif Kodra, student në studimet postdiplomike në Fakultetin e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore pranë Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë, nën përgjegjësi të plotë morale dhe ligjore deklaroj që ky punim magjistrature është rezultat i punës sime hulumtuese dhe asnjë pjesë e tij nuk është marrë nga autorë tjerë, në përjashtim të pjesëve që janë të regjistruara me referencat përkatëse.

Tetor, Maj, 2021

Tetovë

Haqif Kodra

---

**Mentor**

**Prof.dr. Agron Rustemi**

**Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë**

**Komisioni**

**Prof.dr. Agron Rustemi**

**Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë**

**Prof.dr. Etem Aziri**

**Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë**

**Prof.dr. Merita Zylfiu**

**Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë**

## Abstrakt

Rajoni i Pollogut është njëri nga tetë rajonet planore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ky rajon përfshin dy komuna me seli në qytet dhe dy komuna me seli në fshat. Ndonëse i dyti për nga numri i popullsisë, rajoni i Pollogut është ndër rajonet më të vogla për nga shtrirja territoriale në vend. Territori i tij është i kufizuar gjeografikisht nga kufijtë natyror që e bëjnë Pollogun një rajon me territor kompakt. Nga ana tjetër ky rajon karakterizohet me një diversitet të veçantë etnik dhe fetar të popullsisë. Në fakt, në këtë rajon gërshetohen së paku disa kultura që janë zhvilluar historikisht krah njëra tjetrës por në mënyrë paralele dhe si të veçanta.

Synimi primarë i disertacionit të magjistraturës është të ofrohet një analizë e thuktë e të gjitha aspekteve socio-ekonomike që e bëjnë rajonin e Pollogut të veçantë. Pra, bëhet fjalë për një punim që është enkas i fokusuar në rajonin e Pollogut, dhe që synon të ofrojë një kornizë të thuktë mbi të cilën mundet të ndërtohen një varg i studimeve specifike nga kjo lëmi lidhur me këtë rajon, e pse jo të shërbejë edhe si mostër për ndërtim të analizave të ngjashme të rajoneve tjera në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

**Fjalë kyç:** Pollogu, papunësia, arsimi, popullsia, mbrojtja sociale, nataliteti, mortaliteti, aktiviteti ekonomik

**Abstract**

The Polog region is one of the eight planning regions in the Republic of North Macedonia. This region includes tëo urban-based municipalities and tëo rural-based municipalities. Although second in terms of population, the Polog region is among the smallest regions in terms of territorial extent in the country. Its territory is geographically limited by the natural borders that make Polog a region ëith a compact territory. On the other hand this region is characterized by a special ethnic and religious diversity of the population. In fact, in this region are intertëined several cultures that have historically developed side by side but in parallel and as separate. The primary aim of the master's dissertation is to provide a thorough analysis of all socio-economic aspects that make the Polog region special. So, this is a paper that is specifically focused on the Polog region, and that aims to provide an in-depth frameëork on which to build a series of specific studies in this area related to this region, and why not serve also as a sample for construction of similar analyzes of other regions in the Republic of Northern Macedonia.

**Key words:** Polog, unemployment, education, population, social protection, birth rate, mortality, economic activity

## Абстракт

Полошкиот регион е еден од осумте плански региони во Република Северна Македонија. Овој регион вклучува две општини со седиште во град и две општини со седиште во руралните средини. Иако е втор според бројот на население, полошкиот регион е меѓу најмалите региони според површината во земјата. Неговата територија е географски ограничена со природните граници што го прават Полог регион со компактна територија. Од друга страна, овој регион се карактеризира со посебна етничка и верска неколку култури кои историски се развиле рамо до рамо, но паралелно и како одвоени.

Примарната цел на магистерската дисертација е да обезбеди темелна анализа на сите социо-економски аспекти што го прават Полошкиот регион посебен. Значи, ова е труд кој е специјално фокусиран на полошкиот регион и има за цел да обезбеди длабинска рамка за градење на спектар на специфични студии во оваа област поврзани со овој регион, и зошто да не служи и како примерок за градење слични анализи на други региони во Република Северна Македонија.

Клучни зборови: Полог, невработеност, образование, население, социјална заштита, наталитет, морталитет, економска активност

## **Përmbajtje e shkurtë**

**Kapitulli I:** Pozita e rajonit të Pollogut në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020

**Kapitulli II:** Trende të përgjithshme ekonomike në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

**Kapitulli III:** Specifika dhe trendë të popullsisë në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

**Kapitulli IV:** Arsimi dhe shëndetësia në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

**Kapitulli V:** Specifika sociale të popullsisë në rajonin e Pollogut

**Kapitulli VI:** Qëndrimet e qytetarëve mbi proceset dhe lëvizjet socio-ekonomike në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

## Përmbajtja

|                                   |        |
|-----------------------------------|--------|
| Lista e tabelave .....            | 10     |
| Lista e grafikoneve .....         | 12     |
| <br>Hyrje .....                   | <br>16 |
| 1. Lënda e hulumtimit.....        | 16     |
| 3. Hipotezat .....                | 17     |
| 4. Metodologjia e hulumtimit..... | 18     |
| 5. Rëndësia e punimit.....        | 18     |

### **Kapitulli I: Pozita e rajonit të Pollogut në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020**

|                                                                                                                               |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1.Procese dhe lëvizje të përgjithëshme socio-ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020 .....      | 20 |
| 2.Ndarja administrative dhe territoriale e Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020 .....                    | 38 |
| 3.Analizë krahasimore e rajoneve planore dhe administrative në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020 ..... | 41 |

### **Kapitulli II: Trende të përgjithshme ekonomike në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020**

|                                                                                     |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1.Tendencat dhe trendët afariste në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020 ..... | 64 |
| 2.Ndërtimtaria në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020 .....                   | 66 |
| 3.Bujqësia në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020 .....                       | 69 |
| 4.Blegtoria në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020 .....                      | 75 |
| 5.Gjahtaria në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020 .....                      | 76 |
| 6.Pylltaria në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020 .....                      | 77 |
| 7.Turizmi në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020 .....                        | 79 |



### **Kapitulli III: Specifika dhe trendë të popullsisë në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020**

|                                                                                                |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1. Karakteristika demografike të popullsisë në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020 ..... | 86 |
| 2. Shtimi natyror i popullsisë së Pollogut në periudhën 2000-2020.....                         | 91 |
| 3. Migrimet e popullsisë së Pollogut në periudhën 2000-2020 .....                              | 99 |

### **Kapitulli IV: Arsimi dhe shëndetësia në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020**

|                                                                      |     |
|----------------------------------------------------------------------|-----|
| 1. Arsimi fillorë në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020.....  | 104 |
| 2. Arsimi i mesëm në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020 ..... | 108 |
| 3. Arsimi i lartë në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020 ..... | 111 |

### **Kapitulli V: Specifika sociale të popullsisë në rajonin e Pollogut**

|                                                                           |     |
|---------------------------------------------------------------------------|-----|
| 1. Papunësia në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020.....            | 114 |
| 2. Punësimi në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020 .....            | 116 |
| 3. Mbrojtja sociale në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020.....     | 117 |
| 4. Mbrojtja e fëmijëve në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020 ..... | 118 |

### **Kapitulli VI: Qëndrimet e qytetarëve mbi proceset dhe lëvizjet socio-ekonomike në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020**

|                                |     |
|--------------------------------|-----|
| 1.Përshkrim i mostrës .....    | 122 |
| 2.Përshkrim i rezultateve..... | 127 |
| 3.Komentim i rezultateve ..... | 138 |

|                            |     |
|----------------------------|-----|
| Diskutime përmbyllëse..... | 139 |
|----------------------------|-----|

|                                              |     |
|----------------------------------------------|-----|
| Diskutimi i hipotezave të parashtruara ..... | 139 |
|----------------------------------------------|-----|

|                                  |     |
|----------------------------------|-----|
| Përfundime dhe rekomandime ..... | 140 |
|----------------------------------|-----|

|                    |     |
|--------------------|-----|
| Bibliografia ..... | 143 |
|--------------------|-----|

## Lista e tabelave

- Tab.1. Participimi i ndërmarrjeve të mëdha në numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2010-2020
- Tab.2. Tregues të varfërisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën 2010-2019 (në %)
- Tab.3. Blegtoria, shpezëtaria dhe bletaria në Maqedoninë e Veriut në periudhën 2000-2019
- Tab.4. Shkalët e papunësisë në RMV për periudhën 2000-2020
- Tab.5. Shkalët e punësisë në RMV për periudhën 2000-2020
- Tab.6. Rajonet planore në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- Tab.7. persona të ardhur në RMV sipas regjioneve në vitet 2000-2019
- Tab.8. Persona të shpërngulur nga RMV sipas regjioneve në vitet 2000-2019
- Tab.9. Nxënës në shkollat fillore të RMV sipas regjioneve
- Tab.10. Shkolla fillore në pronësi shtetërore sipas rajoneve në Republikën e Maqedonisë
- Tab.11. Numri i studentëve të diplomuar sipas rajoneve në periudhën 2000-2019së Veriut
- Tab.12. Subjekte afariste aktive në komunat e rajonit të Pollogut në periudhën 2010-2020
- Tab.13. Ndërmarrje në rajonin e Pollogut sipas numrit të punësuarve në periudhën 2008-2020
- Tab.14. Leje ndërtimi sipas tipit të objektit për periudhën 2008-2020 në rajonin e Pollogut
- Tab.15. tëdhëna mbi ekonomitë dhe sipërfaqet bujqësore sipas rajoneve në vitin 2016
- Tab.16. Pemë të kultivuara në rajonin e Pollogut
- Tab.17. Numri i turistëve në rajonin e Pollogut në periudhën 2006-2020
- Tab.18. Struktura gjinore e komunave në rajonin e Pollogut
- Tab.19. Struktura etnike e popullsisë në komunat e veçanta në rajonin e Pollogut
- Tab.20. Imigrantë në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019
- Tab.21. Migrimet e brendëshme në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019
- Tab.22. Mësues në shkollat fillore në rajonin e Pollogut
- Tab.23. Mësimdhënës në shkollat e mesme në rajonin e Pollogut

Tab.24. mësimdhënës në shkollat e mesme të Pollogut sipas viteve shkollore

## Lista e grafikoneve

- Graf.1. GDP e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020 (Në million denar)
- Graf.2. Biznese aktive në Maqedoninë e Veriut në periudhën 2010-2020
- Graf.3. Popullsia në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020 komfor projeksioneve të Entit Shtetërorë të Statistikave
- Graf.4. Shtimi natyror i popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020
- Graf.5. Migrimet e jashtme të nënshtetasve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën 2005-2019
- Graf.6. Ardhje dhe shpërngulje të qytetarëve të huaj në RMV në periudhën 2005-2019
- Graf.7. Saldoja e migrameve të jashtme në RMV në periudhën 2005-2019
- Graf.8. Të punësuar sipas lartësisë së pagës neto në periudhën 2017-2020
- Graf.9. Struktura e të punësuarve sipas pagës neto në vitin 2020
- Graf.10. Përfitues të ndihmës sociale në periudhën 2000-2016
- Graf.11. Rajonet planore në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas sipërfaqes
- Graf.12. Rajonet planore në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas popullsisë
- Graf.13. Të ardhur sipas rajoneve në vitet 2000-2019
- Graf.14. Të shpërngulur sipas rajoneve në vitet 2000-2019
- Graf.15. Numri i mësuesve në arsimin fillorë sipas rajoneve në vitin shkollor 2019/2020
- Graf.16. Proporcioni mësues-nxënës në arsimin fillorë sipas rajoneve në vitin shkollor 2019/2020
- Graf.17. Numri i nxënësve në shkollat e mesme sipas rajoneve në vitin shkollor 2019/2020
- Graf.18. Numri i shkollave të mesme sipas rajoneve në vitin shkollor 2019/2020
- Graf.19. Numri i nxënësve për shkollë të mesme sipas rajoneve në vitin shkollor 2019/2020
- Graf.20. Totali i të diplomuarve sipas rajoneve në vitet 2000-2019
- Graf.21. Subjekte afariste aktive në rajonin e Pollogut në periudhën 2010-2020
- Graf.22. Trendi i dhënies së lejeve për ndërtim në rajonin e Pollogut në periudhën 2008-2020
- Graf.23. Objekte të ndërtuara në rajonin e Pollogut në periudhën 2007-2020

Graf.24. Vlera monetare e objekteve të ndërtuara në rajonin e Pollogut në periudhën 2007-2020 (në denar)

Graf.25. Numri i ekonomive bujqësore sipas kulturave bujqësore në rajonin e Pollogut në vitin 2016

Graf.26. Sipërfaqe bujqësore sipas dedikimit në rajonin e Pollogut në vitin 2016

Graf.27. Sipërfaqe bujqësore sipas kulturës bujqësore në rajonin e Pollogut në vitin 2016

Graf.28. Sipërfaqe bujqësore sipas klasës në rajonin e Pollogut në vitin 2016

Graf.8. Njësi blegtorale sipas rajoneve në vitin 2016

Graf.30. Njësi blegtorale në rajonin e Pollogut në vitin 2016

Graf.31. Gajhtaria në rajonin e Pollogut në periudhën 2010-2019

Graf.32. Sipërfaqe pyjore në rajonin e Pollogut në periudhën 2010-2019

Graf.33. Drunj të prerë në rajonin e Pollogut në periudhën 2010-2019

Graf.34. Drunj të prerë në mënyrë të jashtëligjshme rajonin e Pollogut në periudhën 2010-2019

Graf.35. Netë të kaluara në rajonin e Pollogut nga ana e turistëve në periudhën 2006-2020

Graf.36. Kapacitete për akomodim të turistëve në rajonin e Pollogut në periudhën 2006-2020

Graf.37. Popullsia e komunave të rajonit të Pollogut sipas regjistrimit të vitit 2002 të popullsisë

Graf.38. Pjesëmarrja e komunave të veçanta në totalin e popullsisë së rajonit të Pollogut sipas regjistrimit të vitit 2002

Graf.39. Struktura etnike e popullsisë së Pollogut

Graf.40. Foshnje të lindura të gjalla në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019

Graf.41. Numri i të vdekurve në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019

Graf.42. Shtimi natyror i popullsisë në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019

Graf.43. Analizë krahasimore e shtimit natyror të popullsisë në rajonet e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2019

Graf.44. Nataliteti në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019

Graf.45. Analizë krahasimore e natalitetit në rajonin e Pollogut dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2019

Graf.46. Mortaliteti në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019

Graf.47. Shkalla e shtimit natyror të popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019

Graf.48. Emigrime nga rajoni i Pollogut në periudhën 2000-2019

Graf.49. Numri i nxënësve në shkollat fillore në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

Graf.50. Analizë krahasimore e lëvizjes së nxënësve në shkollat fillore sipas komunave për vite të caktuara shkollore

Graf.51. Numri i nxënësve në arsimin e mesëm në rajonin e Pollogut

Graf.52. Studentë të diplomuar në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019

Graf.53. Persona të papunësuar në rajonin e Pollogut në periudhën 2007-2020

Graf.54. Struktura gjinore e të papunësuarve në rajonin e Pollogut më datë 31.Dhjetor.2021

Graf.55. Struktura moshore e të papunësuarve më datë 31.Dhjetor.2021

Graf.56. Shkalla e punësimit në rajonin e Pollogut për periudhën 2009-2020

Graf.57. Familje shfrytëzuese të ndihmës sociale në periudhën 2000-2016 në rajonin e Pollogut

Graf.58. Shfrytëzues të ndihmës sociale në periudhën 2000-2016 në rajonin e Pollogut

Graf.59. Fëmijë nën përkujdesje në çerdhe në periudhën 2000-2017 në rajonin e Pollogut

Graf.60. Persona të punësuar për përkujdesje për fëmijë

Graf.61. Struktura gjinore e të anketuarve

Graf.62. Struktura moshore e të anketuarve

Graf.63. Struktura arsimore e të anketuarve

Graf.64. Struktura e të anketuarve sipas përkatësisë etnike

Graf.65. Struktura e të anketuarve sipas përkatësisë fetare

Graf.66. Struktura e të anketuarve sipas tipit të vendbanimit

Graf.68. Besueshmëria e qytetarëve në rezultatet e regjistrimit të popullsisë në vitin 2002

Graf.69. Shkalla e pajtueshmërisë së bashkësive etnike se regjistrimi i vitit 2002 nuk reflekton në mënyrë adekuate strukturën reale etnike të popullsisë në Pollog (në %)

Graf.70. Shkalla e pajtueshmërisë së bashkësive fetare se të dhënat mbi strukturën fetare të popullsisë në Pollog nuk e reflektojnë realitetin (në %)

Graf.71. Perceptimet e respondentëve mbi arsyet e rrënies së numrit të nxënësve në shkollim fillorë në rajonin e Pollogut

Graf.72. Perceptimet e respondentëve mbi cilësinë në shkollim fillorë në rajonin e Pollogut

Graf.73. Perceptimet e respondentëve mbi arsyet e rrënies së numrit të nxënësve në shkollim e mesëm në rajonin e Pollogut

Graf.74. Perceptimet e respondentëve mbi cilësinë në shkollim e mesëm në rajonin e Pollogut

Graf.75. Perceptimet e respondentëve mbi gjendjen ekonomike në rajonin e Pollogut

Graf.76. Perceptimet e respondentëve mbi ndërtimtarinë në rajonin e Pollogut

Graf.77. Perceptimet e respondentëve mbi bujqësinë dhe blegtorinë në rajonin e Pollogut

Graf.78. Arsye më të zakonata për ikje prej bujqësisë dhe blegtorisë

Graf.79. Perceptimet e respondentëve mbi arsyet e emigrimeve të popullsisë së Pollogut

## Hyrje

### 1. Lënda e hulumtimit

Që nga viti 2009, territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut është i ndarë në tetë rajone administrative, edhe atë: Rajoni lindor, rajoni verilindor, rajoni i Pellagonisë, rajoni i Pollogut, rajoni i Shkupit, rajoni juglindor, rajoni jugperëndimor dhe ai i Vardarit.

Ndonëse ligjërisht i barabartë në të drejta dhe obligime me shtatë rajonet tjera administrative në vend, në kontekst socio-ekonomik rajoni i Pollogut si rajoni i vetëm me popullsi dominuese shqiptare në vend, në shumë aspekte ngec dukshëm pas rajoneve tjera. Ngecjet në fjalë vërehen gati në të gjitha porët e organizimit të jetës shoqërore dhe ekonomike, përfshirë këtu edhe investimet publike dhe gjendjen e infrastrukturës. Ky rajon që shpesh-herë klasifikohet edhe në Pollogun e Epërm dhe të Poshtëm përfshin dy komuna urbane edhe atë Gostivarin dhe Tetovën si dhe disa komuna rurale dhe një numër të konsiderueshëm të fshatrave.

Lëndë hulumtimi e disertacionit të magjistraturës do të jenë proceset dhe lëvizjet socio-ekonomike në rajonin e Pollogut, duke përfshirë këtu një analizë të thuktë të strukturës moshore, etnike dhe fetare të popullsisë, strukturës arsimore të popullsisë, lëvizjeve migruese të popullsisë, shtimit natyror të popullsisë dhe gjithsesi parametrave të ndryshëm që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike në këtë regjion. Pos kësaj, të dhënat në fjalë do të vihen gjithnjë në krahasim me të dhënat e ngjashme për rajonet tjera në vend në drejtim të identifikimit dhe argumentimit të dallimeve potenciale në mes rajoneve në fjalë. Pos kësaj gjendja socio-ekonomike në rajonin e Pollogut do të kundrohet edhe në kontekst të trendit historik me qëllim të identifikimit të trendëve rritëse ose rrenëse në parametra të ndryshëm.

Disertacioni i magjistraturës do të pasurohet dhe nga një studim në terren i qëndrimeve të qytetarëve të Pollogut për trendët dhe lëvizjet socio-ekonomike nëpër komuna, me qëllim të mishërimit të dhënave statistikore me qëndrimet e vetë qytetarëve. Kjo me qëllim të përfitimit të një pasqyre më të plotë e cila do të mundësojë jo thjeshtë identifikimin e gjendjes ekzistuese, por edhe gjetjen e shkaqeve dhe arsyeve që kanë shkaktuar proceset dhe lëvizjet socio-ekonomike përkatëse në këtë rajon.



## 2. Qëllimet e hulumtimit

Synimi parësorë i disertacionit të magjistraturës është ofrimi i një analize të thuktë teorikisht të pranueshme dhe praktikisht korrekte rreth proceseve dhe lëvizjeve socio-ekonomike në rajonin e Pollogut ndër vite.

Si qëllime specifike të disertacionit të magjistraturës mundet të veçohen:

- Të ofrohet një analizë ekstenzive e literaturës vendore dhe ndërkombëtare relevante në fushën e lëvizjeve dhe proceseve socio-ekonomike.
- Të ofrohet një analizë e detajuar e proceseve dhe lëvizjeve të përgjithshme socio-ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020.
- Të ofrohet një analizë e thuktë e pozitës reale të rajonit të Pollogut në krahasim me rajonet tjera në vend.
- Të ofrohet një analizë e thuktë e karakteristikave demografike të popullsisë në rajonin e Pollogut.
- Të ofrohet një analizë e thuktë e shtimit natyror të popullsisë së rajonit të Pollogut në rrjedhën e deritanishme të shek. XXI.
- Të ofrohet një analizë e thuktë e lëvizjeve migrative të popullsisë së rajonit të Pollogut në rrjedhën e deritanishme të shek. XXI.
- Të ofrohet një analizë e thuktë e lëvizjeve të shkallës së papunësisë dhe punësimit në rajonin e Pollogut në rrjedhën e deritanishme të shek. XXI.
- Të ofrohet një analizë e thuktë e parametrave kryesor ekonomik rajonit të Pollogut në rrjedhën e deritanishme të shek. XXI.

## 3. Hipotezat

Punimi i magjistraturës do të synon testimin e disa hipotezave, dhe atë:

- *“Rajoni i Pollogut karakterizohet me trende të pavolitshme socio-ekonomike në rrjedhën e deritanishme të shek. XXI, në krahasim me rajone tjera të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.*

- *“Nuk ekzistojnë dallime të mëdha në trendët socio-ekonomike në mes dy komunave urbane të rajonit të Pollogut”.*
- *“Ekzistojnë dallime të shprehura në trendët socio-ekonomike në mes komunave urbane dhe rurale të rajonit të Pollogut”.*

#### **4. Metodologjia e hulumtimit**

Gjatë përpilimit të punimit të magjistraturës do të implementohen metodat dhe teknikat bazë për hulumtim shkencor. Në këtë drejtim në masë të konsiderueshme do të shfrytëzohen analiza, sinteza, metoda induktive dhe metoda deduktive me qëllim të ardhjes në përfundime logjike dhe shkencërisht të pranueshme lidhur me proceset dhe lëvizjet-socio-ekonomike në rajonin e Pollogut.

Gjatë shqyrtimit të literaturës bazë sidomos do vijnë në shprehje metoda empirike me qëllim të përcaktimit të rezultateve konkrete deri tek të cilat kanë arritur hulumtuesit e kësaj problematike në studime paraprake.

Me rastin e krahasimit të gjendjes socio-ekonomike në mes rajoneve dhe komunave në suaza të rajoneve si dhe me dimension kohor do të shfrytëzohen metoda krahasuese dhe ajo historike.

Me qëllim të shqyrtimit të qëndrimeve të qytetarëve mbi lëvizjet dhe proceset socio-ekonomike në rajonin e Pollogut do të shfrytëzohet pyetësori në terren, ndërsa për fazën e organizimit dhe përpunimit të të dhënave do të përdorim kryesisht metoda statistikore si dhe pakoja SPSS për përpunimin e të dhënave.

#### **5. Rëndësia e punimit**

Rëndësia e punimit të magjistraturës qëndron në atë që ky do të jetë një studim i thellë dhe i përpiktë mbi proceset dhe lëvizjet socio-ekonomike në rajonin e Pollogut në rrjedhën e deritanishme të shek. XXI. Rëndësia praktike e punimit të magjistraturës del nga vetë qëllimet dhe hipotezat e parashtruara si dhe nga fakti se disertacioni do të paraqes një bazë solide dhe pikënisje për studime të ardhshme potenciale të kësaj problematike.

Kapitulli



# **Pozita e rajonit të Pollogut në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020**

- 
- 
1. Procese dhe lëvizje të përgjithëshme socio-ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020
  2. Ndarja administrative dhe territoriale e Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020
  3. Analizë krahasimore e rajoneve planore dhe administrative në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020


## 1 Procese dhe lëvizje të përgjithshme socio-ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020

Shumëçka mundet të theksohet në drejtim të diskutimit të trendëve të përgjithshëm socio-ekonomik në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020 e që koïncidon me zhvillim plural të vendit pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit që i dha fund konfliktit të armatosur të vitit 2001 që në atë periudhë sipas të gjitha gjasave ka manifestuar dhe kapacitete reale për t'u shndërruar në një luftë të plotë qytetare në mes bashkësive të ndryshme etnike, por ndoshta më pas edhe në mes bashkësive të ndryshme fetare në vend.

Analizat e realizuara dëshmojnë qartë se në periudhën në fjalë, Maqedonia e Veriut ka kaluar një varg të peripecive të brendshme dhe të jashtme. Kështu, në plan të brendshëm, ndonëse sipërfaqësisht të relaksuara, praktikisht në faza të caktuara mjaft të tensionuara, marrëdhëniet në mes dy bashkësive më të mëdha në vend në vazhdimësi kanë karakterizuar funksionimin e vendit. Situata bëhet edhe më komplekse duke patur para sysh edhe tensionimet Brenda-etnike, ndërjetare dhe Brenda-fetare, dhe ato sociale e politike në vend. Në plan të jashtëm Maqedonia ballafaqohet me vështirësi në integrimet Evropiane, e deri para disa muajve edhe ato Atlantike, pjesërisht edhe për shkak të marrëdhënieve jo shumë të relaksuara me vendet fqinje, përjashtuar këtu dy shtetet Shqiptare, pra Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Kosovës. Kështu, vendi ende ballafaqohet me problematikën e Kishës Ortodokse përkatësisht autoqefalin e saj të kontestuar nga Kisha Ortodokse Serbe, me probleme që tangojnë gjuhën dhe historinë me Bullgarinë. Nga ana tjetër, vendi pas Marrëveshjes së Prespës dhe ndryshimit të emrit arriti që disi të tejkalojë problemin madhorë me fqin jugor dhe ia doli të anëtarësohet në NATO. Megjithatë, ekziston një përshtypje gjenerale që ky anëtarësim nuk ka rezultuar edhe me përfitime ekonomike adekuate. Madje, meqë erdhi në pikun e pandemisë COVID-19 në një mënyrë nuk u prit ky anëtarësim me festimet e merituar madhështore si në vendet tjera. Por, mbetet fakti që ky anëtarësim pa pikë dyshimi rreshton vendin në paktin më të fuqishëm ushtarak aktual botërorë, orienton qartë të ardhmen e vendit drejt perëndimit dhe njëkohësisht ofron garanci për paprekshmërinë e territorit dhe sovranitetit shtetërorë nga çdo armik potencial i jashtëm.

Pa dyshim që periudha 2000-2020 është periudhë e sfidave të shumta, por edhe e të arriturave dhe avancimeve, ndonëse minore në plan ekonomik të vendit. Shikuar nga këndvështrimi ekonomik, me rëndësi të veçantë është se vendi në këtë periudhë ka arritur të ruajë një trend relativisht pozitiv të rritjes ekonomike, një rritje graduale të shkallës së punësimit, një rrënie graduale të shkallës së papunësisë. Por, paralelisht me këtë është shënuar edhe rrënie permanente e natalitetit, rritje permanente e migrameve të jashtme, rrënie e satisfacionit nga jeta në vend, dhe radhitje të vendit në pozitën më të lartë në listën e vendeve më të këqija për të ndërtuar jetesë dhe të ardhmen familjare.


Graf.1. GDP e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020 (në milion denar)



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Pra, siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm, në periudhën në fjalë Republika e Maqedonisë së Veriut ka shënuar rritje permanente të GDP-së së saj, ndonëse mundet të vërehet dhe periudha të stagnacionit e të cilat në esencë ndërlidhen edhe me trende globale që kanë karakterizuar periudhat në fjalë. Kështu mundet të veçohet periudha 2008,2009 si periudhë e kësaj natyre. Nënkuptohej që për shkak të ndikimit negative të pandemisë që ende nuk është e përmbyllur, në vitin 2020 vendi ka shënuar dhe një ulje ose siç komentohet në termine ekonomike rritje negative të GDP në krahasim me vitin paraprak, pra vitin 2019.

Graf.2. Biznese aktive në Maqedoninë e Veriut në periudhën 2010-2020



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Por, edhe pranë trendëve pozitiv në lëvizjen e shkallës së përgjithshme të GDP'së të dhënat statistikore tregojnë një lëvizje jo drejtvizore në numrin e subjekteve afariste aktive. Kështu në periudhën 2010-2019 numri i përgjithshëm i bizneseve aktive në vend ka mbetur gati i pandryshuar. Në fakt, poqëse shikohet statistikë, brenda kësaj decenie është shënuar zvogëlim i numrit të përgjithshëm të bizneseve aktive, nga 75497 në vitin 2000 në 73061 në vitin 2020. Pra, shënohet një rrënie prej më shumë se 2.000 subjekte afariste. Megjithatë, kjo teposhtëzë ndoshta duhet të shikohet si e përkohshme dhe normale, përkatësisht si pasojë e pandemisë COVID'19, ngjashëm si rasti me analizën e GDP' së vendit.

Ndonëse në shikim të parë trendët e mëlartëm mundet të lënë përshtypjen e trendëve plotësisht pozitiv, shikuar nga një këndvështrim jo edhe tërësisht ekonomik dhe statistikorë, duhet pranuar si shqetësues fakti që bizneset e mëdha shumë pak participojnë në numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve në Maqedoninë e Veriut. Kështu, siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën vijuese asnjëherë këto biznese në totalin e bizneseve në vend nuk kanë participuar në decenien e fundit me mbi 0.3%. E theksojmë këtë fakt si shqetësues, duke u nisur nga nevoja për luftrim permanent të papunësisë në vend.

Tab.1. Participimi i ndërmarrjeve të mëdha në numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2010-2020

| Viti | Gjithsej | Kompani me mbi 250 të punësuar |     |
|------|----------|--------------------------------|-----|
|      |          | n                              | %   |
| 2010 | 75497    | 203                            | 0.3 |
| 2011 | 73118    | 185                            | 0.3 |
| 2012 | 74424    | 201                            | 0.3 |
| 2013 | 71290    | 209                            | 0.3 |
| 2014 | 70659    | 206                            | 0.3 |
| 2015 | 70139    | 231                            | 0.3 |
| 2016 | 71519    | 233                            | 0.3 |
| 2017 | 71419    | 236                            | 0.3 |
| 2018 | 72315    | 240                            | 0.3 |
| 2019 | 75914    | 232                            | 0.3 |
| 2020 | 73061    | 233                            | 0.3 |

**Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Mjaft shqetësuese janë edhe të dhënat mbi varfërinë në vend, ndonëse përgjithësisht trendi është rrenës, tab.2.

Tab.2. Tregues të varfërisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën 2010-2019 (në %)

| Viti                                                                                             | Persona të varfër | Persona të varfër para transfereve sociale dhe pensione | Persona të varfër para transfereve sociale,por me pensione të paguara | Gini koeficienti |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|---------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|------------------|
| 2010                                                                                             | 27                | 44.1                                                    | 30.5                                                                  | 40.9             |
| 2011                                                                                             | 26.8              | 43.9                                                    | 30.4                                                                  | 38.5             |
| 2012                                                                                             | 26.2              | 42.6                                                    | 28.8                                                                  | 38.8             |
| 2013                                                                                             | 24.2              | 41                                                      | 26.8                                                                  | 37               |
| 2014                                                                                             | 22.1              | 41.7                                                    | 24.8                                                                  | 35.2             |
| 2015                                                                                             | 21.5              | 40.5                                                    | 24.8                                                                  | 33.7             |
| 2016                                                                                             | 21.9              | 41.6                                                    | 25.7                                                                  | 33.6             |
| 2017                                                                                             | 22.2              | 40.7                                                    | 25.9                                                                  | 32.5             |
| 2018                                                                                             | 21.9              | 40.8                                                    | 25.7                                                                  | 31.9             |
| 2019                                                                                             | 21.6              | 41.1                                                    | 25.4                                                                  | 30.7             |
| <b>Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut</b> |                   |                                                         |                                                                       |                  |

Pra, siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mëlartme, ndonëse në periudhën 2009-2019 është shënuar rrënie e varfërisë për rreth 10 pikë përqindëshe, përsëri situatë mbetet alarmuese duke patur para sysh se rreth 1/5 e popullsisë jetojnë nën kufirin e varfërisë e në veçanti duke patur parasysh faktin se kjo gjendje dukshëm zbutet nga transferet permanente sociale në vend.

**Tab.3. Blegtoaria, shpezëtaria dhe bletaria në Maqedoninë e Veriut në periudhën 2000-2019**

|  | Kuaj | Gjedhë | Derra | Dhen | Dhi | Shpezë | Kosherë |
|--|------|--------|-------|------|-----|--------|---------|
|--|------|--------|-------|------|-----|--------|---------|




|                                                                                                  |       |        |        |         |        |         | bletë |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|--------|--------|---------|--------|---------|-------|
| 2000                                                                                             | 56486 | 264968 | 204135 | 1250686 | 78913  | 3713369 | 75481 |
| 2001                                                                                             | 45638 | 265266 | 189293 | 1285099 | 81553  | 2749637 | 70869 |
| 2002                                                                                             | 41775 | 258973 | 196223 | 1233830 | 72091  | 2900966 | 70888 |
| 2003                                                                                             | 42883 | 259976 | 179050 | 1239330 | 68106  | 2417362 | 71602 |
| 2004                                                                                             | 40391 | 254803 | 158231 | 1432369 | 65668  | 2725298 | 69036 |
| 2005                                                                                             | 39651 | 248185 | 155753 | 1244000 | 62190  | 2617012 | 66738 |
| 2006                                                                                             | 40553 | 255430 | 167116 | 1248801 | 63579  | 2585327 | 67804 |
| 2007                                                                                             | 31066 | 253766 | 255146 | 817536  | 126452 | 2263894 | 58307 |
| 2008                                                                                             | 30936 | 253473 | 246874 | 816604  | 133017 | 2226055 | 61705 |
| 2009                                                                                             | 29418 | 252520 | 193840 | 755357  | 94017  | 2117889 | 53438 |
| 2010                                                                                             | 26661 | 259887 | 190552 | 778404  | 75708  | 1994852 | 76052 |
| 2011                                                                                             | 25415 | 265299 | 196570 | 766631  | 72778  | 1944260 | 65277 |
| 2012                                                                                             | 21676 | 251240 | 176920 | 732338  | 63585  | 1776297 | 52897 |
| 2013                                                                                             | 20682 | 238333 | 167492 | 731828  | 75028  | 2201550 | 68294 |
| 2014                                                                                             | 19371 | 241607 | 165053 | 740457  | 81344  | 1939879 | 73869 |
| 2015                                                                                             | 18784 | 253442 | 195443 | 733510  | 88064  | 1761145 | 73960 |
| 2016                                                                                             | 19263 | 254768 | 202758 | 723295  | 101669 | 1865769 | 81476 |
| 2017                                                                                             | 17951 | 255036 | 202197 | 724555  | 107466 | 1840173 | 75406 |
| 2018                                                                                             | 10041 | 256181 | 195538 | 726990  | 117447 | 1828287 | 81197 |
| 2019                                                                                             | 8952  | 217790 | 135770 | 684558  | 87581  | 1562089 | 96143 |
| <b>Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut</b> |       |        |        |         |        |         |       |

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mëlartme edhe pranë subvencionimit permanent të veprimtarive blegtorale në vend, në periudhën e studiuar është shënuar rrënie në këto degë të ekonomisë së vendit. Përfundim bëjnë vetëm kultivimi i dhive dhe kultivimi i bletëve.

Kur bëhet fjalë për lëvizjet e popullsisë në vend, fatkeqësisht nuk mundet të ofrohen të dhëna të besueshme, në veçanti duke patur para sysh dështimet e njëpasnjëshme të regjistrimit të popullsisë në vend si dhe vetë shprehjen e mosbesimit në rezultatet e regjistrimeve të realizuara nga ana e njëres nga dy bashkësitë më të mëdha etnike në vend, pra bashkësisë etnike shqiptare. Pra, pjesë më e madhe e të dhënave në vijim, e në veçanti ato që kanë të bëjnë me

strukturën etnike dhe fetare të popullsisë duhet trajtuar në rend të parë sit ë përfaqësues, e jo si plotësisht të sakta, mu për shkak të dyshimeve të lartë përmendura.

Graf.3. Popullsia në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020 komfor projeksioneve të Entit Shtetërorë të Statistikave




Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Pra, komfor projeksioneve të Entit Shtetërorë të Statistikave të Republikës së Maqedonisë së veriut, vendi në njëzet vitet e fundit ka patur një shtim shumë të ulët të popullsisë, me atë që enti projekton që në vitin 2019 numri i përgjithshëm i popullsisë të ketë qenë 2076255 krahasuar me 2031112 në vitin 2000, pra rritje për

mbi dyzet mijë banorë. Nga ana tjetër CIA Factbook raporton një popullsi prej 2128262 të vendit në vitin 2021 bazuar në kalkulimet e ekspertëve të tyre.

Graf.4. Shtimi natyror i popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020




Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Pra Republika e Maqedonisë së Veriut, që nga viti 2000 është ballafaquar më një rrënie të shkallës së shtimit natyrorë të popullsisë, edhe atë nga 12055 në vitin 2000 në 4074 në vitin 2005, 2614 në vitin 2015 dhe vetëm 1606 në vitin 2018. Në vitin 2019 është shënuar për herë të parë shtim negative natyror i popullsisë prej 621, pra për herë të parë për periudhën në fjalë mortaliteti në vend ka qenë më i lartë se nataliteti në të. Megjithatë, duhet theksuar se për këtë periudhë 19 vjeçare shtimi natyror i popullsisë ka qenë 93445 komfor të dhënave zyrtare, që i bën projeksionet e Entit Shtetërorë të Statistikave të dyshimta meqë aty raportohet një rritje e

përgjysmuar e numrit të përgjithshëm të popullsisë në vend. Gjithsesi që migrimet luajnë një rol në këtë drejtim, por përsëri bëhet fjalë për nënshtetas të Maqedonisë.

Graf.5. Migrimet e jashtme të nënshtetasve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën 2005-2019




Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm, për periudhën e studiuar, Republika e Maqedonisë së Veriut është ballafaquar në vazhdimësi me saldo negative kur bëhet fjalë për migrimet e jashtme të nënshtetasve të saj. Kështu, për periudhën në fjalë, komfor të dhënave zyrtare, nga

vendi janë shpërngulur (pra nuk përfshihen këtu emigrimet e përkohshme) rreth 11273 persona kurse janë kthyer rreth 5267 persona, që nënkupton një saldo negative prej afro 6000 persona. Por, edhe këto të dhëna nuk duhet konsideruar si konkluzive meqë përjashtohen të gjithë personat që janë shpërngulur por në në ndërkohë nuk kanë bërë evidentimet përkatëse pranë organeve të rendit. Nga ana tjetër, vendi shënon një saldo pozitive të të huajve që migrojnë në Maqedoni kundrejt atyre që largohen nga vendi, graf.6.

Graf.6. Ardhje dhe shpërngulje të qytetarëve të huaj në RMV në periudhën 2005-2019




Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Pra për periudhën e analizuar Maqedonia e Veriut ka shënuar një saldo jashtëzakonisht pozitive të migrameve të huaja. Në fakt, në këtë periudhë në Maqedoni kanë migruar 27589 të huaj, kurse prej saj janë larguar 1755 të huaj. Pra

mbi dyfish më shumë të huaj kanë ardhur në drejtim të Maqedonisë në periudhën e njëjtë krahasuar me numrin e qytetarëve të shpërngulur nga vendi në po të njëjtën periudhë. Kjo mundëson që vendi të ketë për këtë periudhë një saldo pozitive të migrameve të jashtme, graf.7.

Graf.7. Saldoja e migrameve të jashtme në RMV në periudhën 2005-2019



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm konfirmojnë trendin pozitiv në saldon e migrameve të jashtme, me atë që kjo saldo pozitive trend rritës ka shënuar në veçanti gjatë pesë viteve të fundit me atë që pikun e ka arritur në vitin 2015 kur është shënuar saldo pozitive e migrameve të jashtme prej 2860 persona, ndërsa pika më e ulat për periudhën në fjalë ka qenë viti 2008 me saldo pozitive prej vetëm 25 persona.

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mëposhtme, shkalla e papunësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut është përgjysmuar për periudhën e hulumtuar 2000-2020, me atë që fatkeqësisht gati në vazhdimësi shkalla e papunësisë te personat e grup moshave më të reja është më e lartë në krahasim me personat e grup moshave më të vjetra.

| Tab.4. Shkalët e papunësisë në RMV për periudhën 2000-2020 |       |      |       |       |       |       |       |       |       |       |       |       |
|------------------------------------------------------------|-------|------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Viti                                                       |       | Tot  | 15-19 | 20-24 | 25-29 | 30-34 | 35-39 | 40-44 | 45-49 | 50-54 | 55-59 | 60-64 |
| 2000                                                       | Total | 32.2 | 60.7  | 59.6  | 49.7  | 36    | 25.5  | 21.6  | 17.7  | 16.9  | 18.4  | 11.3  |
|                                                            | M     | 30.5 | 60.9  | 57.2  | 45.9  | 33.4  | 23.7  | 19.5  | 17.2  | 18    | 20.1  | 12.5  |
|                                                            | F     | 34.9 | 60.4  | 63    | 55.4  | 39.6  | 28    | 24.4  | 18.5  | 15    | 13.5  | 8.3   |
| 2001                                                       | Total | 30.5 | 57.6  | 55.7  | 44.1  | 36    | 26    | 20.8  | 16.9  | 16.8  | 14.3  | 10.8  |
|                                                            | M     | 29.5 | 59.6  | 56.6  | 41.1  | 33.4  | 25.2  | 19.5  | 16.1  | 17.8  | 16.5  | 12.2  |
|                                                            | F     | 32   | 54.9  | 54.4  | 48.2  | 39.6  | 27.2  | 22.7  | 18    | 15.3  | 9.4   | 6.5   |
| 2002                                                       | Total | 31.9 | 60.2  | 57.8  | 48    | 36.2  | 29.7  | 22.1  | 19.5  | 18.2  | 17.6  | 16.1  |
|                                                            | M     | 31.7 | 59.5  | 57.7  | 47.5  | 36.7  | 28.3  | 21.9  | 18.9  | 17.8  | 20    | 19.4  |
|                                                            | F     | 32.3 | 61.1  | 58    | 48.8  | 35.4  | 31.5  | 22.4  | 20.3  | 19    | 11.9  | 5.9   |
| 2003                                                       | Total | 36.7 | 66.6  | 65.5  | 50.8  | 43    | 32.7  | 26.1  | 21.9  | 22.6  | 23.2  | 14.3  |
|                                                            | M     | 37   | 65.4  | 65.1  | 50.9  | 43.5  | 32.9  | 26.9  | 22.5  | 23    | 26.6  | 18.5  |
|                                                            | F     | 36.3 | 68.1  | 66    | 50.6  | 42.3  | 32.4  | 24.9  | 20.9  | 21.9  | 15.9  | 1.4   |
| 2004                                                       | Total | 37.2 | 72.8  | 62.5  | 49.4  | 40    | 33.7  | 28.7  | 25.2  | 24.1  | 30.1  | 20.3  |
|                                                            | M     | 36.7 | 73.8  | 62.4  | 47.5  | 37.8  | 33.3  | 28.9  | 25    | 25.1  | 33.2  | 23.8  |
|                                                            | F     | 37.8 | 71.5  | 62.7  | 52    | 43.2  | 34.3  | 28.3  | 25.6  | 22.5  | 23    | 4.6   |
| 2005                                                       | Total | 37.3 | 63.5  | 62.4  | 47    | 39.9  | 33.6  | 31    | 28    | 26.9  | 30.8  | 25    |
|                                                            | M     | 36.5 | 65.8  | 62.1  | 44.5  | 37.4  | 31.2  | 30    | 27.9  | 27.9  | 34.4  | 29.1  |
|                                                            | F     | 38.4 | 60.1  | 62.8  | 50.5  | 43.4  | 37.2  | 32.3  | 28.1  | 25.2  | 23.2  | 11.9  |
| 2006                                                       | Total | 36   | 64    | 58.4  | 44.9  | 36.5  | 32.4  | 29.4  | 27.1  | 28.3  | 28.4  | 28.5  |
|                                                            | M     | 35.3 | 63.4  | 57.5  | 43.3  | 34.2  | 30.1  | 28.8  | 27.5  | 28.7  | 31    | 32.7  |
|                                                            | F     | 37.2 | 65    | 59.7  | 47.1  | 40.1  | 36    | 30.4  | 26.5  | 27.7  | 22.8  | 15    |
| 2007                                                       | Total | 34.9 | 62.6  | 56.1  | 42.5  | 36.2  | 30.8  | 28.7  | 25.6  | 28.9  | 28.2  | 27.7  |
|                                                            | M     | 34.5 | 62.8  | 55.5  | 41.7  | 33.9  | 30.2  | 26.6  | 25    | 29.2  | 31.4  | 32    |
|                                                            | F     | 35.5 | 62.2  | 57.1  | 43.6  | 39.3  | 31.6  | 31.7  | 26.6  | 28.5  | 21.8  | 15.6  |
| 2008                                                       | Total | 33.8 | 56.8  | 56.2  | 40.3  | 35    | 29.6  | 26.7  | 25.6  | 27.5  | 28.2  | 29.1  |
|                                                            | M     | 33.5 | 61.5  | 54    | 38.4  | 33.1  | 30.6  | 26.9  | 24.7  | 26.6  | 30.1  | 35.3  |
|                                                            | F     | 34.2 | 48.3  | 59.7  | 43.2  | 37.8  | 28.1  | 26.4  | 26.8  | 28.9  | 24.4  | 13.3  |
| 2009                                                       | Total | 32.2 | 57.1  | 54.6  | 37.7  | 33.1  | 27.4  | 27.4  | 25.1  | 25.5  | 25.7  | 27.7  |
|                                                            | M     | 31.8 | 56.1  | 51.8  | 36.9  | 31.5  | 26.4  | 28.9  | 24.5  | 25.7  | 27.1  | 29.6  |
|                                                            | F     | 32.8 | 59.1  | 59.4  | 39    | 35.4  | 28.9  | 25.2  | 26.1  | 25.2  | 22.8  | 22.8  |
| 2010                                                       | Total | 32   | 59.3  | 52.3  | 39.4  | 31.4  | 28.9  | 27.7  | 25    | 24.1  | 27    | 29.7  |

|                                                                                                  |       |      |      |      |      |      |      |      |      |      |      |      |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
|                                                                                                  | M     | 31.9 | 64   | 51.2 | 37.2 | 31   | 27.5 | 28.3 | 25.7 | 23.9 | 26.8 | 33   |
|                                                                                                  | F     | 32.2 | 48.5 | 54.3 | 42.5 | 31.9 | 31   | 26.7 | 23.9 | 24.5 | 27.4 | 21.6 |
| 2011                                                                                             | Total | 31.4 | 58.6 | 54.4 | 40.6 | 30.1 | 26.1 | 26   | 23.6 | 24   | 27.3 | 30.4 |
|                                                                                                  | M     | 31.8 | 65.4 | 52.9 | 38.7 | 31.4 | 25.8 | 27.2 | 24   | 23.3 | 27.7 | 35   |
|                                                                                                  | F     | 30.8 | 43.9 | 57.1 | 43.2 | 28.2 | 26.5 | 24.2 | 23   | 25   | 26.4 | 17.4 |
| 2012                                                                                             | Total | 31   | 58.7 | 53   | 41.5 | 29.6 | 29.4 | 24.5 | 23   | 23.6 | 25.8 | 23.7 |
|                                                                                                  | M     | 31.5 | 61.9 | 53.8 | 42   | 28.2 | 31.2 | 24.1 | 23.4 | 23.7 | 26.5 | 28.2 |
|                                                                                                  | F     | 30.3 | 51.8 | 51.8 | 40.9 | 31.4 | 26.5 | 25.1 | 22.2 | 23.5 | 24.4 | 13.8 |
| 2013                                                                                             | Total | 29   | 62.3 | 49.7 | 40.5 | 29.5 | 25.8 | 22.3 | 19   | 22.1 | 23.9 | 24.4 |
|                                                                                                  | M     | 29   | 65.2 | 49.7 | 39.7 | 30.2 | 27.6 | 19.8 | 19.2 | 21.2 | 22.6 | 29.1 |
|                                                                                                  | F     | 29   | 57.6 | 49.6 | 41.7 | 28.4 | 23.2 | 25.8 | 18.6 | 23.5 | 26.1 | 12.8 |
| 2014                                                                                             | Total | 28   | 63.5 | 51   | 39.3 | 28.9 | 21.2 | 21   | 20.7 | 22.1 | 21.3 | 26   |
|                                                                                                  | M     | 27.6 | 65.6 | 49.2 | 36.5 | 26.9 | 22.3 | 20.1 | 20.8 | 22.4 | 22.1 | 29.8 |
|                                                                                                  | F     | 28.6 | 59.9 | 54   | 43.2 | 31.7 | 19.6 | 22.2 | 20.5 | 21.6 | 20   | 15.8 |
| 2015                                                                                             | Total | 26.1 | 46.1 | 47.6 | 39   | 25   | 22.9 | 19.6 | 18.7 | 21   | 21.5 | 19.3 |
|                                                                                                  | M     | 26.7 | 47.1 | 50.2 | 40.2 | 25.7 | 23.1 | 19.4 | 17.8 | 20.7 | 22.3 | 23   |
|                                                                                                  | F     | 25.1 | 44.2 | 43.2 | 37.2 | 24   | 22.6 | 19.8 | 20   | 21.5 | 20   | 10.2 |
| 2016                                                                                             | Total | 23.7 | 58.9 | 46.1 | 35.2 | 23.2 | 20.6 | 18.6 | 17.8 | 16.3 | 18.6 | 16.1 |
|                                                                                                  | M     | 24.4 | 59.2 | 45.5 | 36   | 24.4 | 20.6 | 20   | 17.5 | 16.5 | 19.6 | 18.8 |
|                                                                                                  | F     | 22.7 | 58.1 | 47.3 | 34.1 | 21.6 | 20.5 | 16.5 | 18.4 | 16   | 16.6 | 8.2  |
| 2017                                                                                             | Total | 22.4 | 58   | 44.6 | 33.9 | 23.6 | 16.9 | 17.2 | 14.9 | 16.4 | 18.6 | 12.8 |
|                                                                                                  | M     | 22.7 | 59.3 | 42.9 | 31.3 | 24.3 | 17.7 | 18.6 | 15.3 | 16.5 | 21   | 14.7 |
|                                                                                                  | F     | 21.8 | 54.9 | 47.6 | 37.7 | 22.7 | 15.8 | 15.3 | 14.2 | 16.2 | 14.3 | 8    |
| 2018                                                                                             | Total | 20.7 | 61.7 | 42.6 | 31.4 | 23.4 | 13.5 | 14.1 | 15   | 15.6 | 17   | 16.8 |
|                                                                                                  | M     | 21.3 | 61   | 43.8 | 29.2 | 23.8 | 12.4 | 16.2 | 16.5 | 16.6 | 17.8 | 18.5 |
|                                                                                                  | F     | 19.9 | 63.2 | 40.1 | 34.4 | 22.8 | 14.9 | 11.1 | 12.7 | 14   | 15.7 | 12.4 |
| 2019                                                                                             | Total | 17.3 | 37.5 | 35.3 | 27   | 18.5 | 13   | 13.2 | 13.4 | 13.7 | 13.3 | 9.1  |
|                                                                                                  | M     | 16.5 | 37.3 | 32.8 | 25.3 | 19.1 | 12.4 | 12.2 | 13   | 12.8 | 12.1 | 9.9  |
|                                                                                                  | F     | 18.4 | 37.9 | 39   | 29.3 | 17.7 | 13.7 | 14.7 | 13.9 | 14.9 | 15.3 | 6.8  |
| 2020                                                                                             | Total | 16.4 | 46.7 | 33.9 | 25.5 | 16.9 | 13.2 | 11.4 | 13.2 | 13.1 | 12.5 | 11.4 |
|                                                                                                  | M     | 16.7 | 46.2 | 32   | 23.5 | 17.8 | 13.6 | 11.8 | 14.7 | 14.3 | 13   | 13.3 |
|                                                                                                  | F     | 15.9 | 47.7 | 37.2 | 28.1 | 15.7 | 12.5 | 10.7 | 11   | 11.4 | 11.8 | 6.4  |
| <b>Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut</b> |       |      |      |      |      |      |      |      |      |      |      |      |

Paralelisht me rënien e papunësisë, në periudhë 2000-2020 në Maqedoninë e Veriut është shënuar rritje e shkallës së punësisë, me atë që shkalla e punësisë është



ritur me intensitet më të vogël në krahasim me intensitetin e uljes së shkallës së papunësisë. Kështu në vitin 2000 rreth 35.8% e popullsisë ka qenë e punësuar, ndërsa dy dekenie më vonë ky numër ka arritur në 47.2%. Në këtë drejtim duhet theksuar se në kontekst në analizave të proceseve socio-ekonomike me rëndësi të veçantë është shkalla e punësimit, e jo thjeshtë shënimi i rënies së shkallës së papunësisë. Kjo në mënyrë të drejtpërdrejtë ka të bëjë me qasjen metodologjike në përllogaritjen e shkallës së papunësisë dhe mundësitë që përmes ndryshimeve (ndoshta edhe mekanike) në numrin e personave që kanë kërkuar të punësimit, mundet të paraqiten edhe rritje në shkallën e papunësisë në vend. Gjithsesi që dhe migrimet e jashtme janë një faktor i rëndësishëm në përllogaritjet në fjalë. Sido qoftë, mbetet fakti se gati në vazhdimësi, gjatë dy dekenieve të fundit, shkallë më të larta të punësimit shënohet te grup moshat e mesme, përkatësisht personat e moshës nga 30 deri 49 vjeçare. Trendët në fjalë, në veçanti mundet të vërehen nga të dhënat e paraqitura në tabelën vijuese, tab.5

Tab.5. Shkalët e punësisë në RMV për periudhën 2000-2020

| Viti |       | Tot  | 15-19 | 20-24 | 25-29 | 30-34 | 35-39 | 40-44 | 45-49 | 50-54 | 55-59 | 60-64 |
|------|-------|------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| 2000 | Total | 35.8 | 6.9   | 23.6  | 36.7  | 49.3  | 59    | 62.8  | 60.9  | 50.8  | 35.1  | 16.8  |
|      | M     | 44.7 | 7.9   | 29.2  | 47    | 59.6  | 68.8  | 73.2  | 72.7  | 65    | 52.9  | 25.1  |
|      | F     | 27.1 | 5.8   | 17.9  | 26.2  | 38.8  | 49.2  | 52.1  | 49.1  | 37.4  | 18.5  | 9.3   |
| 2001 | Total | 38.6 | 8.3   | 26.8  | 41.8  | 51.1  | 59.6  | 64.2  | 62.8  | 54.3  | 36.1  | 19    |
|      | M     | 46.3 | 8.7   | 29.5  | 50.4  | 60.3  | 68.9  | 73.9  | 72.6  | 65.8  | 50    | 30    |
|      | F     | 30.9 | 7.9   | 24    | 32.9  | 41.5  | 50    | 54.3  | 52.8  | 43.3  | 23.1  | 9     |
| 2002 | Total | 35.8 | 6.6   | 23.5  | 38.2  | 51.8  | 57.7  | 62.3  | 60.2  | 52.7  | 34    | 17.5  |
|      | M     | 43.5 | 7.4   | 28.2  | 45.4  | 58.8  | 67.3  | 72.3  | 71.9  | 68    | 47.7  | 26.8  |
|      | F     | 28.1 | 5.8   | 18    | 30.5  | 44.7  | 48.2  | 51.9  | 48.5  | 38.1  | 20.7  | 9     |
| 2003 | Total | 34.5 | 5.1   | 19.1  | 37.3  | 45.2  | 54.4  | 59    | 59.4  | 50.2  | 36.9  | 19.3  |
|      | M     | 41.3 | 5.8   | 22.5  | 43.2  | 51.3  | 62.3  | 67.6  | 69.2  | 62.3  | 49.2  | 28.9  |
|      | F     | 27.7 | 4.5   | 15.5  | 31.1  | 38.8  | 46    | 50.1  | 49.1  | 38.5  | 25.3  | 10.6  |
| 2004 | Total | 32.8 | 3.9   | 19.2  | 36.6  | 45.8  | 51.2  | 56    | 55.6  | 49.4  | 31.1  | 16.9  |
|      | M     | 40.2 | 4.3   | 22.9  | 43.9  | 55.5  | 60.3  | 63.6  | 65.5  | 59.9  | 42.6  | 27.3  |
|      | F     | 25.4 | 3.5   | 15.3  | 29    | 35.7  | 41.8  | 48.1  | 45.2  | 38.8  | 20.1  | 7.1   |
| 2005 | Total | 33.9 | 5.3   | 19.1  | 38.7  | 46.9  | 52.4  | 55.1  | 56.7  | 50.2  | 33.2  | 17.6  |
|      | M     | 41.2 | 5.8   | 22.4  | 46.2  | 56.4  | 62.9  | 63.6  | 65.2  | 60.4  | 43.7  | 26.4  |
|      | F     | 26.6 | 4.8   | 15.7  | 30.7  | 37.1  | 41.4  | 46.2  | 47.7  | 39.9  | 23.2  | 9.4   |


## Haqif Kodra: Proceset dhe lëvizjet socio-ekonomike në Rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

|      |       |      |     |      |      |      |      |      |      |      |      |      |
|------|-------|------|-----|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| 2006 | Total | 35.2 | 6.3 | 22.3 | 41.2 | 49.8 | 53.7 | 57.1 | 58.8 | 49.1 | 36.3 | 16.6 |
|      | M     | 43.5 | 7.5 | 26.8 | 48.7 | 61.8 | 65.9 | 66.8 | 67.5 | 60.7 | 49.4 | 24.9 |
|      | F     | 27   | 5   | 17.6 | 33.3 | 37.5 | 41.1 | 47   | 49.7 | 37.5 | 24.1 | 8.9  |
| 2007 | Total | 36.2 | 6.7 | 23.5 | 43.5 | 51.7 | 55.5 | 56.9 | 58.5 | 51.3 | 36.8 | 17.9 |
|      | M     | 44.1 | 8.6 | 28.6 | 50.5 | 61.6 | 65.4 | 67.5 | 68.3 | 60.7 | 47.8 | 25.9 |
|      | F     | 28.4 | 4.6 | 18.2 | 36.1 | 41.4 | 45.3 | 45.8 | 48.4 | 41.6 | 26.4 | 10.5 |
| 2008 | Total | 37.3 | 7   | 24   | 46   | 51.9 | 57.3 | 58.8 | 58.5 | 51.6 | 39.5 | 21.1 |
|      | M     | 45.7 | 7.9 | 30.1 | 55.3 | 63.2 | 66.3 | 67.6 | 69.6 | 63.2 | 53.1 | 29   |
|      | F     | 28.8 | 6.1 | 17.6 | 36.2 | 40.2 | 48   | 49.7 | 47.1 | 39.7 | 26.5 | 13.9 |
| 2009 | Total | 38.4 | 6.1 | 25   | 48.3 | 53.8 | 58.3 | 58.2 | 59.4 | 54.5 | 43.5 | 22.7 |
|      | M     | 47.5 | 8   | 32.5 | 56   | 65.1 | 70.9 | 66.4 | 71.1 | 65.8 | 58.3 | 33   |
|      | F     | 29.4 | 4   | 17   | 40   | 42.1 | 45.4 | 49.8 | 47.2 | 43   | 29.3 | 13.4 |
| 2010 | Total | 38.7 | 5.4 | 24.9 | 47.9 | 56.5 | 58   | 58.1 | 59   | 56   | 43.1 | 22.9 |
|      | M     | 47.5 | 6.4 | 31.8 | 56.2 | 67   | 69.7 | 67.8 | 68.7 | 68.3 | 57.6 | 32.3 |
|      | F     | 29.8 | 4.3 | 17.7 | 39.2 | 45.6 | 46   | 48.2 | 48.9 | 43.2 | 28.9 | 14.3 |
| 2011 | Total | 38.9 | 5.5 | 22.7 | 46.8 | 58.5 | 60.2 | 58.3 | 59.7 | 55.8 | 45.2 | 23.2 |
|      | M     | 47   | 6.1 | 28.6 | 53.9 | 64.7 | 70.2 | 68.6 | 70.7 | 67.5 | 57.9 | 33.5 |
|      | F     | 30.9 | 4.8 | 16.4 | 39.4 | 52.1 | 49.8 | 47.9 | 48.5 | 43.7 | 32.7 | 13.8 |
| 2012 | Total | 39   | 4.7 | 25.1 | 45.7 | 58.9 | 56.8 | 59.3 | 59.1 | 55.9 | 45.3 | 23.7 |
|      | M     | 47.1 | 5.7 | 29.3 | 50.9 | 67.3 | 65.4 | 71.1 | 71.3 | 68.4 | 58.5 | 32.1 |
|      | F     | 30.8 | 3.6 | 20.8 | 40.2 | 50   | 47.8 | 47.2 | 46.6 | 43.1 | 32.1 | 16.1 |
| 2013 | Total | 40.6 | 4.8 | 26.2 | 45.9 | 59.4 | 60   | 62   | 63.8 | 57.4 | 49.1 | 24.9 |
|      | M     | 48.7 | 5.3 | 31.1 | 52.3 | 66.7 | 68.7 | 74.8 | 74.4 | 69.7 | 61.9 | 34.4 |
|      | F     | 32.5 | 4.3 | 21.2 | 39.2 | 51.7 | 50.9 | 48.9 | 52.8 | 44.8 | 36.1 | 16   |
| 2014 | Total | 41.2 | 4.3 | 24.7 | 48.2 | 59   | 65.6 | 63.7 | 62.3 | 58.2 | 51.6 | 23.5 |
|      | M     | 50.1 | 4.9 | 31.2 | 57.1 | 69.7 | 74.3 | 75.6 | 74.4 | 69.1 | 64.1 | 33.8 |
|      | F     | 32.4 | 3.7 | 17.9 | 38.9 | 47.7 | 56.5 | 51.6 | 50   | 47   | 39   | 13.9 |
| 2015 | Total | 42.1 | 5.8 | 27.1 | 47.3 | 60.9 | 64.2 | 64.4 | 61.4 | 58.7 | 50.7 | 28.2 |
|      | M     | 50.5 | 7.1 | 31.4 | 53.8 | 69.2 | 72.3 | 75   | 75.9 | 69.9 | 63.6 | 39.1 |
|      | F     | 33.7 | 4.4 | 22.6 | 40.6 | 52.2 | 55.6 | 53.6 | 46.7 | 47.4 | 37.8 | 17.9 |
| 2016 | Total | 43.1 | 4.6 | 26.1 | 49.6 | 63.4 | 65.6 | 65.5 | 62.7 | 61.1 | 50.7 | 29.6 |
|      | M     | 52.3 | 6.2 | 32.5 | 56.7 | 71.9 | 74.2 | 75.3 | 77.5 | 73.1 | 65.2 | 43.5 |
|      | F     | 33.8 | 2.9 | 19.3 | 42.2 | 54.5 | 56.7 | 55.5 | 47.7 | 49   | 36.2 | 16.2 |
| 2017 | Total | 44.1 | 4.8 | 28.4 | 51.5 | 62.4 | 68.5 | 67.2 | 66.3 | 60.7 | 51.1 | 31   |
|      | M     | 53.6 | 6.3 | 36.6 | 61.1 | 70.9 | 77.5 | 76.7 | 78.9 | 75.2 | 63.8 | 44.3 |
|      | F     | 34.6 | 3.1 | 19.6 | 41.3 | 53.5 | 59   | 57.4 | 53.5 | 46   | 38.4 | 18.1 |

|                                                                                                  |       |      |     |      |      |      |      |      |      |      |      |      |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|------|-----|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| 2018                                                                                             | Total | 45.1 | 3.9 | 29   | 53.4 | 63.3 | 71.9 | 69.4 | 64   | 61.4 | 53.5 | 31.2 |
|                                                                                                  | M     | 54.4 | 5.4 | 35.9 | 61.9 | 71.1 | 82.1 | 77.4 | 76.6 | 75.1 | 68.2 | 44.5 |
|                                                                                                  | F     | 35.8 | 2.4 | 21.8 | 44.4 | 55.2 | 61.1 | 61.2 | 51.2 | 47.5 | 38.8 | 18.2 |
| 2019                                                                                             | Total | 47.3 | 4.7 | 35   | 56.7 | 66.9 | 74.1 | 71.3 | 66.7 | 64.4 | 56.1 | 33.2 |
|                                                                                                  | M     | 56.6 | 6.9 | 41.8 | 65.1 | 74.3 | 81.6 | 81.8 | 78.6 | 77.7 | 71.5 | 47.7 |
|                                                                                                  | F     | 38.1 | 2.4 | 27.7 | 47.8 | 59.2 | 66.2 | 60.4 | 54.7 | 51   | 40.8 | 19.1 |
| 2020                                                                                             | Total | 47.2 | 4.7 | 33.4 | 55.7 | 68.2 | 71.5 | 72.9 | 66.9 | 63.3 | 55.6 | 35.1 |
|                                                                                                  | M     | 55.9 | 6.1 | 42.1 | 62.4 | 74.4 | 79   | 82.3 | 76.7 | 75.4 | 69.7 | 50.1 |
|                                                                                                  | F     | 38.4 | 3.3 | 24.2 | 48.6 | 61.7 | 63.7 | 63   | 57   | 51.1 | 41.5 | 20.5 |
| <b>Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut</b> |       |      |     |      |      |      |      |      |      |      |      |      |

Por, shikuar nga këndvështrimi i mirëqenies së popullsisë nuk është shkalla e punësimit i vetmi faktor që duhet përfillur. Përkundrazi, një varg i trendëve tjerë siç janë të ardhurat, lëvizjet e kostove të jetesës dhe shumë të tjerë duhet patur parasysh.


Graf.8. Të puënsuar sipas lartësisë së pagës neto në periudhën 2017-2020



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në garf.7, pjesa dërmuese e të punësuarve në vend, në katër vitet e fundit i kanë takuar kategorisë së personave të ardhurat neto-mujore të cilëve kanë qenë midis 10.000 dhe 20.000 denarë.

Graf.9. Struktura e të punësuarve sipas pagës neto në vitin 2020




Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Vetëm për ilustrim, në vitin 2020 vetëm 35% e të punësuarve i kanë takuar kategorisë së personave me të ardhura neto mbi 20001 denarë në muaj, vetëm 1.7% kanë realizuar të ardhura mujore neto mbi 40000 denarë. Kundrejt kësaj rreth 52% i të punësuarve kanë realizuar pagë neto midis 12.000 dhe 20.000 përkatësisht midis 200-300 euro.

Nga ana tjetër, Organizata Sindikale e Maqedonisë ka kalkuluar Korpën e mbijetesës në muajin Nëntor të vitit 2020 në 33742 denarë neto, për një familje nukleus katër anëtarëshe. Poqëse këto të dhëna krahasohen me pagat neto, nën supozimin se vetëm një anëtarë i familjes është i punësuar, matematikisht shikuar jo më shumë se 30.000 familje mundet vetes tija lejojnë vetëm kënaqjen e këtyre nevojave elementare-esenciale për të mbijetuar. Pra, nuk bëhet fjalë për jetesë komode, por thjeshtë për mundësi të mbijetesës. Përsëri, poqëse thjeshtë matematikisht përpjesëtojmë korpën për 4 anëtarë të familjes arrihet në një sumë prej 8435 denarë për person. Kjo nënkupton se përsëri sipas të dhënave zyrtare afro 16.000 ndonëse të punësuar, nuk arrijnë të realizojnë të ardhura të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e tyre elementare.

Graf.10. Përfitues të ndihmës sociale në periudhën 2000-2016



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Nga ana tjetër, që nga viti 2000 është shënuar rrënie permanente në numrin e personave që kanë qenë shfrytëzues të ndihmës sociale në vend, edhe atë nga 277049 në vitin 2000 në 111737 16 vite më vonë.

## 2.Ndarja administrative dhe territoriale e Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020

I tërë territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka qenë i ndarë në 84 komuna të klasifikuara në tre kategori edhe atë: komuna me seli në fshat, komuna me seli në qytet dhe komuna që i përkasin territorit të qytetit të Shkupit. Në qytetin e Shkupit funksionojnë gjithsej dhjetë komunë, edhe atë: Komuna Aerodrom, Komuna Butel, Komuna Gazi Babë, Komuna Gjorçe Petrov, Komuna Karposh, Komuna Kisella Vodë, Komuna Saraj, Komuna Qendër, Komuna Çair dhe Komuna Shuto Orizare. Gjithsej 33 komuna në vend i përkasin kategorisë së komunave me seli në qytet edhe atë: Komuna e Berovës, Komuna e Manastirit, Komuna e Bogdancit, Komuna e Vallandovës, Komuna e Velesit, Komuna e Vinicës, Komuna e Gjevgjelisë, Komuna e Gostivarit, Komuna e Dibrës, Komuna e Dellçevës, Komuna e Demir Kapisë, Komuna e Demir Hisarit, Komuna e Kavadarit, Komuna e Kërçovës, Komuna e Koçanit, Komuna e Kratovës, Komuna e Kriva Pallankës me seli në qytetin Kriva Pallankë; Komuna e Krushevës, Komuna e Kumanovës, Komuna e Makedonska

Kamenicës, Komuna e Makedonski Brodit, Komuna e Negotinës, Komuna e Ohrit, Komuna e Pehçevës, Komuna e Prilepit, Komuna e Probishtipit, Komuna e Radovishit, Komuna e Resnjës, Komuna e Sveti Nikollës, Komuna e Strugës, Komuna e Strumicës, Komuna e Tetovës, dhe Komuna e Shtipit. Pjesa tjetër e komunave në vend i përkasin kategorisë së komunave me seli në fshat, edhe atë: Komuna e Haraçinës me seli në fshatin Haraçinë; Komuna e Bosillovës me seli në fshatin Bosillovë; Komuna e Bërvenicës me seli në fshatin Bërvenicë; Komuna e Vasilevë me seli në fshatin Vasilevë; Komuna e Vevçanit me seli në fshatin Vevçan; Komuna e Vraneshticë me seli në fshatin Vraneshticë; Komuna e Vrapçishtit me seli në fshatin Vrapçisht; Komuna e Gradskos me seli në fshatin Gradsko; Komuna e Debarcës me seli në fshatin Bellçishtë; Komuna e Dojranit me seli në fshatin Dojran i Vjetër; Komuna e Dollnenit me seli në fshatin Dollnen; Komuna e Drugovës me seli në fshatin Drugovë; Komuna e Zhelinës me seli në fshatin Zhelinë; Komuna e Zajazit me seli në fshatin Zajaz; Komuna e Zelenikovës me seli në fshatin Zelenikovë; Komuna e Zërnovcit me seli në fshatin Zërnovc, Komuna e Ilindenit me seli në fshatin Ilinden; Komuna e Jegunovcit me seli në fshatin Jegunovcë; Komuna e Bogovinës me seli në fshatin Bogovinë; Komuna e Karbincit me seli në fshatin Karbinc; Komuna e Konçes me seli në fshatin Konçe; Komuna e Krivogashtanit me seli në fshatin Krivogashtan; Komuna e Likovës me seli në fshatin Likovë; Komuna e Llozovës me seli në fshatin Llozovë; Komuna e Mavrovës dhe Rostushës me seli në fshatin Rostushë; Komuna e Mogillës me seli në fshatin Mogillë; Komuna e Novacit me seli në fshatin Novac; Komuna e Novo Sellës me seli në fshatin Novo Sellë; Komuna e Oslomesë me seli në fshatin Oslome; Komuna e Petrovecit me seli në fshatin Petrovec; Komuna e Pllasnicës me seli në fshatin Pllasnicë; Komuna e Rankovcit me seli në fshatin Rankovc; Komuna e Rosomanit me seli në fshatin Rosoman; Komuna e Sopishtës me seli në fshatin Sopishtë; Komuna e Nagoriçanit të Vjetër me seli në fshatin Nagoriçan i Vjetër; Komuna e Studeniçanit me seli në fshatin Studeniçan; Komuna e Tearcës me seli në fshatin Tearcë; Komuna e Qendrës Zhupë me seli në fshatin Qendër Zhupë; Komuna e Çashkës me seli në fshatin Çashkë; Komuna e Çeshinovës me seli në fshatin Çeshinovë; dhe Komuna e Çuçer-Sandevës me seli në fshatin Çuçer-Sandevë.<sup>1</sup> Në vitin 2013, komunat e Zajazit, Drugovës, Oslomejit dhe Vraneshticës i janë bashkëngjitur komunës së Kërçovës.

<sup>1</sup> Ligji Për Organizimin Territorial Të Vetadministrimit Lokal Në Republikën E Maqedonisë, Verzion i konsoliduar, neni. 10

Pos kësaj, i tërë territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut është i ndarë në tetë rajone planore-zhvillimore, tab.6.

| Tab.6. Rajonet planore në Republikën e Maqedonisë së Veriut |                                  |                     |                                                                                                                                                                                                                                    |
|-------------------------------------------------------------|----------------------------------|---------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Rajoni                                                      | Sipërfaqja<br>(km <sup>2</sup> ) | Popullsia<br>(2002) | Komuna                                                                                                                                                                                                                             |
| Verilindor                                                  | 2310                             | 173982              | Komuna e Kratovës, Komuna e Kriva Palankës, Komuna e Rankocës, Komuna e Staro Nagoricane, Komuna e Kumanovës, Komuna e Likovës                                                                                                     |
| Lindor                                                      | 3537                             | 180938              | Komuna e Berovës, Komuna e Pehçevës, Komuna e Dellçevës, Komuna e Vinicës, Komuna e Zërnovcit, Komuna e Karbincit, Komuna e Shtipit, Komuna e Probishtipit, Komuna e Çeshinovës,, Komuna e Koçanit, Komuna e Makedonska Kamenicës. |
| Juglindor                                                   | 2739                             | 171972              | Komuna e Bogdancit, Komuna e Gjevgjelis, Komuna e Dojranit, Komuna e Vallandovës, Komuna e Strumicës, Komuna e Novo Sellës, Komuna e Bosilevës, Komuna e Vasilevës, Komuna e Konçes, Komuna e Radovishit.                          |
| Vardarit                                                    | 4042                             | 154230              | Komuna e Çashkës, Komuna e Kavadarcit, Komuna e Rosomanit, Komuna e Demir                                                                                                                                                          |




|                                                                                       |      |        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|---------------------------------------------------------------------------------------|------|--------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                                       |      |        | Kapisë, Komuna e Negotinës, Komuna e Gradskos, Komuna e Velesit, Komuna e Llozovës, Komuna e Sveti Nikollës.                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <b>Pellagonia</b>                                                                     | 4717 | 236088 | Komuna e Dollnenit, Komuna e Krushevës, Komuna e Krivogashtanit, Komuna e Demir Hisarit, Komuna e Resnjës, Komuna e Manastirit, Komuna e Novacit, Komuna e Prilepit, Komuna e Mogilës.                                                                                                                                                                              |
| <b>Jugperëndimor</b>                                                                  | 3340 | 222385 | Komuna Makedonski Brodit, Komuna Plasnicës, Komuna e Kërçovës, Komuna e Dibrës, Komuna e Centar Zhupës, Komuna e Debërcës, Komuna e Strugës, Komuna e Vevçanit, Komuna e Ohrit.                                                                                                                                                                                     |
| <b>Pollogu</b>                                                                        | 2416 | 310178 | Komuna e Jegunovcës, Komuna e Tearcës, Komuna e Tetovës, Komuna e Zhelinës, Komuna e Bogovinës, Komuna e Brvenicës, Komuna e Vrapçishtës, Komuna e Gostivarit, Komuna e Mavrovës dhe Rostushë                                                                                                                                                                       |
| <b>Shkupi</b>                                                                         | 1812 | 590455 | Komuna e Qendrës, Komuna e Karposhit, Komuna e Kisela Vodës, Komuna e Aerodromit, Komuna e Gazi Babës, Komuna e Butelit, Komuna e Çairit, Komuna e Gjorçe Petrovit, Komuna e Sarajit, Komuna e Shuto Orizares, Komuna e Sopishtës, Komuna e Studenicënit, Komuna e Zelenikovës, Komuna e Petrovecit, Komuna e Ilindenit, Komuna e Haraçinës, Komuna e Çuçer Sandevë |
| <b>Burimi. Ministria e Vetëqeverisjes Lokale e Republikës së Maqedonisë së Veriut</b> |      |        |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |

### 3. Analizë krahasimore e rajoneve planore dhe administrative në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2020

Shikuar për nga sipërfaqja që përfshijnë ekziston një diskrepancë e vogël dhe në shikim të parë ndoshta edhe normale në mes rajoneve planore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, graf.11.

Graf.11. Rajonet planore në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas sipërfaqes




Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Pra shikuar sipas shtrirjes territorial, si rajon më i vogël në vend mundet të veçohet ai i Shkupit me një pjesëmarrje prej vetëm 7% në totalin e sipërfaqes së vendit, ndërsa si rajoni më i madh veçohet ai i Pelagonisë i cili ngërthen gati 19% të

territorit të vendit. Pra, bëhet fjalë për një diskrepancë reale e cila ndoshta është e kushtëzuar nga rrethana objektive, por më pas shkakton pasoja në tërheqjen e mjeteve për financim të nevojave të qytetarëve.

Graf.12. Rajonet planore në Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas popullsisë



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Shikuar sipas numrit të popullsisë, paraprin rajoni i Shkupit i cili participon me 29% në totalin e popullsisë së vendit, komfor regjistrimit të popullsisë së vitit 2002 e menjëherë më pas radhitet rajoni i Pollogut me një pjesëmarrje prej 15% në totalin e popullsisë së vendit. Poqëse përjashtohet nga analiza kryeqyteti i vendit, në atë rast vërehet qartë se rajoni i Pollogut është rajoni me dendësinë më të madhe të popullsisë në vend. Dendësia e popullsisë në këtë rajon është 128 banorë në km<sup>2</sup>.

Rajoni i radhës me dendësi më të madhe të popullsisë është ai verilindor me 75 banorë për km<sup>2</sup>.

Tab.7. persona të ardhur në RMV sipas regjioneve në vitet 2000-2019

| Viti | Rajonii i Vardarit | Lindor | Jugpe-rëndimor | Juglindor | Pelago-nisë | Pollog | Veri-lindor | Shkupit |
|------|--------------------|--------|----------------|-----------|-------------|--------|-------------|---------|
| 2000 | 38                 | 47     | 252            | 50        | 136         | 382    | 63          | 231     |
| 2001 | 64                 | 47     | 185            | 40        | 161         | 226    | 42          | 420     |
| 2002 | 26                 | 45     | 151            | 77        | 225         | 231    | 43          | 459     |
| 2003 | 12                 | 78     | 114            | 48        | 121         | 248    | 75          | 449     |
| 2004 | 10                 | 65     | 148            | 43        | 157         | 536    | 105         | 317     |
| 2005 | 34                 | 26     | 104            | 36        | 180         | 320    | 66          | 725     |
| 2006 | 54                 | 34     | 150            | 46        | 194         | 199    | 115         | 782     |
| 2007 | 84                 | 43     | 122            | 88        | 268         | 125    | 114         | 383     |
| 2008 | 32                 | 21     | 104            | 43        | 158         | 40     | 67          | 311     |
| 2009 | 57                 | 22     | 124            | 36        | 185         | 101    | 84          | 650     |
| 2010 | 56                 | 61     | 173            | 75        | 335         | 158    | 57          | 744     |
| 2011 | 72                 | 181    | 233            | 117       | 322         | 252    | 96          | 823     |
| 2012 | 93                 | 227    | 262            | 117       | 344         | 287    | 128         | 1010    |
| 2013 | 201                | 184    | 340            | 138       | 341         | 210    | 114         | 903     |
| 2014 | 162                | 127    | 330            | 275       | 275         | 209    | 116         | 1044    |
| 2015 | 118                | 272    | 512            | 276       | 297         | 456    | 172         | 1773    |
| 2016 | 105                | 135    | 253            | 154       | 347         | 362    | 105         | 1303    |
| 2017 | 89                 | 127    | 207            | 168       | 279         | 351    | 67          | 1338    |
| 2018 | 103                | 151    | 244            | 179       | 448         | 490    | 139         | 1172    |
| 2019 | 88                 | 245    | 220            | 163       | 299         | 687    | 136         | 1309    |

**Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelarin e mëlartëm:


- Në vitin 2000, Rajoni i Pollogut i ka paraprirë listës së rajoneve sipas numrit të personave të ardhur në rajonet në fjalë. Në fakt në këtë vit, në rajon e Pollogut janë vendosur gjithsej 382 persona ose 32% nga numri i përgjithshëm i personave në nivel shtetërorë. Menjëherë pas rajonit të Pollogut është ranguar rajoni Jugperëndimor me një pjesëmarrje prej 21% dhe rajoni i Shkupit me një pjesëmarrje prej 19%.

- Në vitin 2001, listën e kryeson Rajoni i Shkupit me një pjesëmarrje prej 35.4% në numrin e përgjithshëm e personave të ardhur në vend, i ndjekur nga rajoni i Pollogut me një pjesëmarrje prej 19% dhe ai Jugperëndimor me 15%. Trende këto që kanë vazhduar gati në kontinuitet për tërë periudhën e studiuar.
- Influks më të madh të qytetarëve rajoni i Vardarit ka shënuar në vitin 2015, vit ky kur ky rajon në numrin e përgjithshëm e të ardhurve në vend ka participuar me 7%, ndërsa influx më të vogël ky rajon ka shënuar në vitin 2004 kur ka participuar me vetëm 0.7% në numrin e përgjithshëm e personave të ardhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- Influks më të madh të qytetarëve e rajoni Lindor ka shënuar në vitin 2012, vit ky kur ky rajon në numrin e përgjithshëm e të ardhurve në vend ka participuar me 9%, ndërsa influx më të vogël ky rajon ka shënuar në vitin 2005 kur ka participuar me vetëm 1.7% në numrin e përgjithshëm e personave të ardhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- Influks më të madh të qytetarëve rajoni Jugperëndimor ka shënuar në vitin 2000, vit ky kur ky rajon në numrin e përgjithshëm e të ardhurve në vend ka participuar me 21%, ndërsa influx më të vogël ky rajon ka shënuar në vitin 2018 kur ka participuar me vetëm 7% në numrin e përgjithshëm e personave të ardhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- Influks më të madh të qytetarëve rajoni Juglindor ka shënuar në vitin 2014, vit ky kur ky rajon në numrin e përgjithshëm e të ardhurve në vend ka participuar me 10.8%, ndërsa influx më të vogël ky rajon ka shënuar në vitin 2005 kur ka participuar me vetëm 2.4% në numrin e përgjithshëm e personave të ardhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- Influks më të madh të qytetarëve rajoni i Pellagonisë ka shënuar në vitin 2007, vit ky kur ky rajon në numrin e përgjithshëm e të ardhurve në vend ka participuar me 21.8%, ndërsa influx më të vogël ky rajon ka shënuar në vitin 2019 kur ka participuar me vetëm 9.5% në numrin e

përgjithshëm e personave të ardhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

- Influx më të madh të qytetarëve rajoni i Pollogut ka shënuar në vitin 2000, vit ky kur ky rajon në numrin e përgjithshëm e të ardhurve në vend ka participuar me 31%, ndërsa influx më të vogël ky rajon ka shënuar në vitin 2008 kur ka participuar me vetëm 5.5% në numrin e përgjithshëm e personave të ardhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- Influx më të madh të qytetarëve rajoni Verilindor ka shënuar në vitin 2007, vit ky kur ky rajon në numrin e përgjithshëm e të ardhurve në vend ka participuar me 9.2%, ndërsa influx më të vogël ky rajon ka shënuar në vitin 2010 kur ka participuar me vetëm 3.4% në numrin e përgjithshëm e personave të ardhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- Influx më të madh të qytetarëve rajoni i Shkupit ka shënuar në vitin 2009, vit ky kur ky rajon në numrin e përgjithshëm e të ardhurve në vend ka participuar me 51.6%, ndërsa influx më të vogël ky rajon ka shënuar në vitin 2000 kur ka participuar me vetëm 9% në numrin e përgjithshëm e personave të ardhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Graf.13. Të ardhur sipas rajoneve në vitet 2000-2019



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm, siç është edhe e pritur numrin më të madh të qytetarëve të ardhur e ka shënuar rajoni i Shkupit respektivisht kryeqyteti i vendit ku është edhe më i lartë përqendrimi i popullsisë, por njëkohësisht edhe janë të përqendruara më shumë mundësitë afariste. Menjëherë pas këtij rajoni radhitet rajoni i Pollogut me 5072 persona të ardhur në periudhën në fjalë.

Tab.8. Persona të shpërngulur nga RMV sipas regjioneve në vitet 2000-2019

| Viti | Rajonii i Vardarit | Lindor | Jugpe-rëndimor | Juglindor | Pelago-nisë | Pollog | Veri-lindor | Shkupit |
|------|--------------------|--------|----------------|-----------|-------------|--------|-------------|---------|
| 2000 | 172                | 8      | 18             | 13        | 21          | 16     | 8           | 32      |
| 2001 | 503                | 19     | 22             | 20        | 71          | 29     | 16          | 215     |
| 2002 | 141                | 9      | 5              | 6         | 3           | 21     | 1           | 58      |
| 2003 | 144                | 8      | 6              | 8         | 9           | 14     | 2           | 50      |
| 2004 | 669                | 3      | 429            | 19        | 164         | 4      | 3           | 26      |
| 2005 | 1300               | 6      | 389            | 308       | 457         | 11     | -           | 114     |
| 2006 | 1108               | 7      | 56             | 875       | 16          | 6      | -           | 91      |
| 2007 | 240                | 6      | 18             | 115       | 2           | 4      | -           | 72      |



|                                                                                                  |      |    |     |      |     |    |     |    |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------|------|----|-----|------|-----|----|-----|----|
| 2008                                                                                             | 751  | 2  | 46  | 382  | 91  | 2  | 144 | 46 |
| 2009                                                                                             | 792  | -  | 57  | 601  | 2   | 2  | 79  | 7  |
| 2010                                                                                             | 1007 | -  | 73  | 523  | 8   | 11 | 290 | 17 |
| 2011                                                                                             | 1290 | -  | 89  | 931  | 24  | 1  | 84  | 23 |
| 2012                                                                                             | 1415 | 2  | 60  | 1091 | 9   | 5  | 167 | 9  |
| 2013                                                                                             | 1041 | 3  | 55  | 596  | 2   | 2  | 292 | 8  |
| 2014                                                                                             | 839  | 23 | 56  | 416  | 25  | 6  | 275 | 6  |
| 2015                                                                                             | 1016 | 13 | 47  | 455  | 84  | 23 | 312 | 9  |
| 2016                                                                                             | 630  | 7  | 27  | 128  | 10  | 21 | 276 | 18 |
| 2017                                                                                             | 424  | 26 | 35  | 55   | 23  | 23 | 121 | 11 |
| 2018                                                                                             | 377  | 10 | 44  | 22   | 14  | 36 | 146 | 10 |
| 2019                                                                                             | 798  | 25 | 155 | 75   | 221 | 35 | 198 | 13 |
| <b>Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut</b> |      |    |     |      |     |    |     |    |

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelarin e mëlartëm:


- Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të personave të shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut rajoni i vardarit e ka shënuar në vitin 2003 kur ky rajon ka participuar me 59.7% në totalin zyrtar të personave të shpërngulur, ndërsa pjesëmarrje më të ulët në numrin e përgjithshëm të personave të shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut rajoni i vardarit e ka shënuar në vitin 2014 kur ky rajon ka participuar me 50.9% në totalin zyrtar të personave të shpërngulur.
- Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të personave të shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut rajoni Lindor ka shënuar në vitin 2002 kur ky rajon ka participuar me 3.6% në totalin zyrtar të personave të shpërngulur, ndërsa pjesëmarrje më të ulët në numrin e përgjithshëm të personave të shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut ky rajon e ka shënuar në vitin 2008 kur ky rajon ka participuar me 0.1% në totalin zyrtar të personave të shpërngulur.
- Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të personave të shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut rajoni

Jugperëndimor ka shënuar në vitin 2004 kur ky rajon ka participuar me 32% në totalin zyrtar të personave të shpërngulur, ndërsa pjesëmarrje më të ulët në numrin e përgjithshëm të personave të shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut ky rajon e ka shënuar në vitin 2001 kur ky rajon ka participuar me 2.1% në totalin zyrtar të personave të shpërngulur.

- Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të personave të shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut rajoni Juglindor ka shënuar në vitin 2006 kur ky rajon ka participuar me 40.5% në totalin zyrtar të personave të shpërngulur, ndërsa pjesëmarrje më të ulët në numrin e përgjithshëm të personave të shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut ky rajon e ka shënuar në vitin 2004 kur ky rajon ka participuar me 1.4% në totalin zyrtar të personave të shpërngulur.
- Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të personave të shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut rajoni i Pellagonisë ka shënuar në vitin 2005 kur ky rajon ka participuar me 17.6% në totalin zyrtar të personave të shpërngulur, ndërsa pjesëmarrje më të ulët në numrin e përgjithshëm të personave të shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut ky rajon e ka shënuar në vitin 2009 kur ky rajon ka participuar me 0.1% në totalin zyrtar të personave të shpërngulur.
- Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të personave të shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut rajoni i Pollogitka shënuar në vitin 2002 kur ky rajon ka participuar me 8.6% në totalin zyrtar të personave të shpërngulur, ndërsa pjesëmarrje më të ulët në numrin e përgjithshëm të personave të shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut ky rajon e ka shënuar në vitin 2008 kur ky rajon ka participuar me 0.1% në totalin zyrtar të personave të shpërngulur.
- Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të personave të shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut rajoni Verilindor ka shënuar në vitin 2008 kur ky rajon ka participuar me 9.8% në totalin zyrtar të personave të shpërngulur, ndërsa pjesëmarrje më të ulët në numrin e përgjithshëm të personave të shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut ky rajon e ka shënuar në vitin 2004 kur ky rajon ka participuar me 0.2% në totalin zyrtar të personave të shpërngulur.

- Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të personave të shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut rajoni i Shkupit ka shënuar në vitin 2003 kur ky rajon ka participuar me 20.7% në totalin zyrtar të personave të shpërngulur, ndërsa pjesëmarrje më të ulët në numrin e përgjithshëm të personave të shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut ky rajon e ka shënuar në vitin 2012 kur ky rajon ka participuar me 0.3% në totalin zyrtar të personave të shpërngulur.

Graf.14. Të shpërngulur sipas rajoneve në vitet 2000-2019



## Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Siç mundet të vërehet, zyrtarisht numër më i madh i personave janë shpërngulur nga vendi në periudhën 2000-2019 nga rajoni i Vardarit, ndjekur nga ai Juglindor. Megjithatë, duhet theksuar se në këto evidenca nuk janë të regjistruar personat që janë shpërngulur realisht, por nuk kanë realizuar dokumentacionin përkatës.

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelarin vijues:

- Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të nxënësve të regjistruar rajoni i Vardarit e ka shënuar në vitin shkollor 2001/2002 kur ky rajon ka participuar me 7.3% në totalin e nxënësve të regjistruar, ndërsa pjesëmarrjen më të vogël ky rajon e ka shënuar në vitin shkollor 2005/2006 kur ka participuar me 6.5% në totalin e nxënësve në arsim fillorë në vend.
- Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të nxënësve të regjistruar rajoni Lindor e ka shënuar në vitin shkollor 2007/2008 kur ky rajon ka participuar me 8.3% në totalin e nxënësve të regjistruar, ndërsa pjesëmarrjen më të vogël ky rajon e ka shënuar në vitin shkollor 2019/2020 kur ka participuar me 6.8% në totalin e nxënësve në arsim fillorë në vend.
- Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të nxënësve të regjistruar rajoni Jugperëndimor e ka shënuar në vitin shkollor 2001/2002 kur ky rajon ka participuar me 11.89% në totalin e nxënësve të regjistruar, ndërsa pjesëmarrjen më të vogël ky rajon e ka shënuar në vitin shkollor 2019/2020 kur ka participuar me 9.49% në totalin e nxënësve në arsim fillorë në vend.
- Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të nxënësve të regjistruar rajoni Juglindor e ka shënuar në vitin shkollor 2001/2002 kur ky rajon ka participuar me 7.89% në totalin e nxënësve të regjistruar, ndërsa pjesëmarrjen më të vogël ky rajon e ka shënuar në vitin shkollor 2019/2020 kur ka participuar me 7.40% në totalin e nxënësve në arsim fillorë në vend.

- Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të nxënësve të regjistruar rajoni i Pellagonisë e ka shënuar në vitin shkollor 2001/2002 kur ky rajon ka participuar me 10.33% në totalin e nxënësve të regjistruar, ndërsa pjesëmarrjen më të vogël ky rajon e ka shënuar në vitin shkollor 2012/2013 kur ka participuar me 10.1% në totalin e nxënësve në arsim fillorë në vend.
- Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të nxënësve të regjistruar rajoni Verilindor e ka shënuar në vitin shkollor 2008/2009 kur ky rajon ka participuar me 9.54% në totalin e nxënësve të regjistruar, ndërsa pjesëmarrjen më të vogël ky rajon e ka shënuar në vitin shkollor 2018/2019 kur ka participuar me 8.3% në totalin e nxënësve
- Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të nxënësve të regjistruar rajoni i Pollogut e ka shënuar në vitin shkollor 2005/2006 kur ky rajon ka participuar me 18.9% në totalin e nxënësve të regjistruar, ndërsa pjesëmarrjen më të vogël ky rajon e ka shënuar në vitin shkollor 2019/2020 kur ka participuar me 15.4% në totalin e nxënësve në arsim fillorë në vend.
- Pjesëmarrje më të madhe në numrin e përgjithshëm të nxënësve të regjistruar rajoni i Shkupit e ka shënuar në vitin shkollor 2019/2020 kur ky rajon ka participuar me 34.7% në totalin e nxënësve të regjistruar, ndërsa pjesëmarrjen më të vogël ky rajon e ka shënuar në vitin shkollor 2001/2002 kur ka participuar me 27.2% në totalin e nxënësve në arsim fillorë në vend.


Tab.9. Nxënës në shkollat fillore të RMV sipas regjioneve

| Viti      | Rajonii i Vardarit | Lindor | Jugpe-rëndimor | Juglindor | Pelagonisë | Pollog | Verilindor | Shkupit |
|-----------|--------------------|--------|----------------|-----------|------------|--------|------------|---------|
| 2001/2002 | 18332              | 19826  | 29670          | 19719     | 25767      | 46084  | 21976      | 68001   |
| 2002/2003 | 17241              | 19860  | 29092          | 19189     | 25325      | 44329  | 22408      | 67296   |
| 2003/2004 | 16645              | 19062  | 28057          | 18633     | 24489      | 43485  | 21250      | 65960   |
| 2004/2005 | 15904              | 18418  | 27407          | 18104     | 23755      | 42528  | 20857      | 64895   |
| 2005/2006 | 15537              | 17607  | 26108          | 17602     | 23105      | 43072  | 20511      | 63712   |
| 2006/2007 | 14328              | 19944  | 26457          | 18296     | 24334      | 43067  | 21910      | 67355   |
| 2007/2008 | 14050              | 19428  | 25336          | 18077     | 23999      | 41958  | 21703      | 66946   |
| 2008/2009 | 13374              | 19184  | 24004          | 17211     | 22578      | 38830  | 21217      | 65961   |



Si rezultat i ekzistimit real të dallimeve në numra të shkollave fillore dhe numrat e nxënësve të regjistruar për të mësuar në to, haset dhe një diskrepancë në këtë drejtim. Kështu, në rajonin Lindor në vitin e fundit shkollorë janë regjistruar mesatarisht 147 nxënës për shkollë, në rajonin Jugperëndimor 144 nxënës për shkollë fillore, në rajonin e Vardarit 165 nxënës për shkollë, në rajonin Verilindor 176 nxënës për shkollë, në rajon e Pollogut 200 nxënës për shkollë fillore, kurse në atë të Shkupit më shumë së dyfishi i këtij numri.


Graf.15. Numri i mësuesve në arsimin fillorë sipas rajoneve në vitin shkollor 2019/2020



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Siç mundet të vërehet nga grafiku i mëlartëm, për nga numri i mësuesve të angazhuar në shkollimin fillorë paraprin rajoni i Shkupit, ndjekur nga rajoni i Pollogut. Por, shikuar nga aspekti i proporcionit nxënës-mësues fitohet një pasqyrë më ndryshe.

Graf.16. Proporcioni mësues-nxënës në arsimin fillorë sipas rajoneve në vitin shkollor 2019/2020






Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Pra, edhe pranë numrit më të madh të mësuesve të angazhuar në shkollimin fillor, rajoni i Shkupit karakterizohet njëkohësisht edhe me proporcion më të ngarkuar mësues-nxënës. Në fakt, në këtë rajon, mesatarisht ka të angazhuar një mësues në çdo 14 nxënës me atë që te regjionet tjera ky numër varion nga 8.5 në Rajonin Jugperëndimor në 10.7 në atë të Vardarit.

Në vitin shkollor 2019/2020 në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë ka patur gjithsej 60980 nxënës në shkolla të mesme, në ç 'rast për nga numri paraprijnë rajoni i Shkupit dhe rajoni i Pollogut.


Graf.17. Numri i nxënësve në shkollat e mesme sipas rajoneve në vitin shkollor 2019/2020



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Pra në vitin shkollor 2019/2020 rajoni i Shkupit ka participuar me 35% në numrin e përgjithshëm të nxënësve në shkollë të mesme, ndjekur nga rajoni i Pollogut me një pjesëmarrje prej 15% dhe rajoni i Pellagonisë me 11%.


Graf.18. Numri i shkollave të mesme sipas rajoneve në vitin shkollor 2019/2020



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në këtë vit shkollor në Republikën e Maqedonisë së veriut kanë funksionuar gjithsej 130 shkolla të mesme nga të cilat 35 në rajonin e Shkupit. Më pas radhiten rajoni i Pellagonisë me gjithsej 20 shkolla të mesme dhe ai i Pollogut me gjithsej 18 shkolla të mesme.

Graf.19. Numri i nxënësve për shkollë të mesme sipas rajoneve në vitin shkollor 2019/2020



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm, edhe pranë numrit më të madh të shkollave të mesme, përsëri rajoni i Shkupit, rajoni Verilindor dhe ai i Pollogut janë më të ngarkuar shikuar sipas numrit të nxënësve për shkollë të mesme.

Tab.11. Numri i studentëve të diplomuar sipas rajoneve në periudhën 2000-2019

|      | Rajoni i Vardarit | Rajoni Lindor | Rajoni Jugperëndimor | Rajoni Juglindor | Rajoni i Pellagonisë | Rajoni i Pollogut | Rajoni Verilindor | Rajoni i Shkupit |
|------|-------------------|---------------|----------------------|------------------|----------------------|-------------------|-------------------|------------------|
| 2000 | 297               | 366           | 348                  | 213              | 621                  | 182               | 179               | 1500             |
| 2001 | 257               | 338           | 252                  | 163              | 570                  | 173               | 212               | 1486             |
| 2002 | 312               | 331           | 320                  | 212              | 556                  | 211               | 184               | 1475             |
| 2003 | 348               | 399           | 403                  | 271              | 587                  | 245               | 285               | 1839             |
| 2004 | 358               | 421           | 507                  | 297              | 718                  | 272               | 313               | 2107             |
| 2005 | 457               | 535           | 480                  | 360              | 807                  | 326               | 294               | 2124             |
| 2006 | 538               | 567           | 623                  | 402              | 917                  | 292               | 366               | 2494             |
| 2007 | 574               | 659           | 804                  | 484              | 1277                 | 837               | 490               | 3063             |
| 2008 | 822               | 833           | 1240                 | 656              | 1313                 | 1141              | 673               | 3960             |
| 2009 | 662               | 827           | 1051                 | 596              | 1378                 | 1239              | 678               | 3605             |
| 2010 | 675               | 953           | 1029                 | 638              | 1300                 | 1061              | 618               | 3533             |

|      |     |      |     |     |      |      |     |      |
|------|-----|------|-----|-----|------|------|-----|------|
| 2011 | 791 | 821  | 950 | 653 | 1459 | 1042 | 652 | 3339 |
| 2012 | 851 | 1070 | 945 | 795 | 1243 | 1076 | 696 | 3534 |
| 2013 | 749 | 894  | 844 | 661 | 1117 | 1105 | 729 | 3067 |
| 2014 | 684 | 954  | 835 | 751 | 1292 | 906  | 729 | 3511 |
| 2015 | 568 | 701  | 771 | 662 | 971  | 1047 | 580 | 2816 |
| 2016 | 593 | 579  | 786 | 526 | 1031 | 1022 | 646 | 2764 |
| 2017 | 530 | 665  | 785 | 592 | 1068 | 1016 | 566 | 2863 |
| 2018 | 498 | 553  | 669 | 503 | 1003 | 954  | 590 | 2493 |
| 2019 | 508 | 519  | 804 | 359 | 959  | 1080 | 602 | 2602 |


**Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mëlartme:

- Participim më të lartë në numrin e përgjithshëm të diplomuarve në vend, rajoni i vardarit ka shënuar në vitin 2006 kur pa participuar me 8.6% në numrin e përgjithshëm të të diplomuarve në vend. Ky rajon, shkallën më të ulët të participimit në numrin e përgjithshëm të diplomuarve në vend prej 6.5% e ka shënuar në vitin 2017.
- Participim më të lartë në numrin e përgjithshëm të diplomuarve në vend, rajoni Lindor ka shënuar në vitin 2012 kur pa participuar me 10.4% në numrin e përgjithshëm të të diplomuarve në vend. Ky rajon, shkallën më të ulët të participimit në numrin e përgjithshëm të diplomuarve në vend prej 6.9% e ka shënuar në vitin 2019.
- Participim më të lartë në numrin e përgjithshëm të diplomuarve në vend, rajoni Jugperëndimor ka shënuar në vitin 2008 kur pa participuar me 11.6% në numrin e përgjithshëm të të diplomuarve në vend. Ky rajon, shkallën më të ulët të participimit në numrin e përgjithshëm të diplomuarve në vend prej 8.8% e ka shënuar në vitin 2002.
- Participim më të lartë në numrin e përgjithshëm të diplomuarve në vend, rajoni Juglindor ka shënuar në vitin 2015 kur pa participuar me 8.1% në numrin e përgjithshëm të të diplomuarve në vend. Ky rajon, shkallën më të ulët të participimit në numrin e përgjithshëm të diplomuarve në vend prej 4.7% e ka shënuar në vitin 2001.

- Participim më të lartë në numrin e përgjithshëm të diplomuarve në vend, rajoni i Pellagonisë e ka shënuar në vitin 2000 kur pa participuar me 16.7% në numrin e përgjithshëm të të diplomuarve në vend. Ky rajon, shkallën më të ulët të participimit në numrin e përgjithshëm të diplomuarve në vend prej 11.9% e ka shënuar në vitin 2015.
- Participim më të lartë në numrin e përgjithshëm të diplomuarve në vend, rajoni i Pollogut ka shënuar në vitin 2019 kur pa participuar me 14.5% në numrin e përgjithshëm të të diplomuarve në vend. Ky rajon, shkallën më të ulët të participimit në numrin e përgjithshëm të diplomuarve në vend prej 4.9% e ka shënuar në vitin 2000.
- Participim më të lartë në numrin e përgjithshëm të diplomuarve në vend, rajoni Veriperëndimor ka shënuar në vitin 2016 kur pa participuar me 8.1% në numrin e përgjithshëm të të diplomuarve në vend. Ky rajon, shkallën më të ulët të participimit në numrin e përgjithshëm të diplomuarve në vend prej 4.1% e ka shënuar në vitin 2008.
- Participim më të lartë në numrin e përgjithshëm të diplomuarve në vend, rajoni i Shkupit ka shënuar në vitin 2001 kur pa participuar me 43% në numrin e përgjithshëm të të diplomuarve në vend. Ky rajon, shkallën më të ulët të participimit në numrin e përgjithshëm të diplomuarve në vend prej 33.4% e ka shënuar në vitin 2013.

Graf.20. Totali i të diplomuarve sipas rajoneve në vitet 2000-2019



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Nuk duhet befasuar aspak fakti që në periudhën 2000-2019 pjesa dërmuese e popullsisë në vend origjinojnë nga rajoni i Shkupit, meqë edhe përqendrimi i popullsisë në këtë rajon është dukshëm më i madh në krahasim me rajonet tjera në vend. Në periudhë në fjalë kanë diplomuar gjithsej 147968 studentë, nga të cilët 54175 ose 36% nga rajoni i Shkupit. Më pas rangohen rajoni i Pellagonisë me 20187 të diplomuar ose 14% nga numri përgjithshëm i të diplomuarve për periudhën në fjalë, dhe rajoni i Pollogut me 15227 të diplomuar ose rreth 10% nga numri i përgjithshëm i të diplomuarve në vend për periudhën në fjalë.

Kapitulli



## **Trende të përgjithshme ekonomike në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-202**


- 
1. Tendencat dhe trendët afariste në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020
  2. Ndërtimtaria në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020
  3. Standardi i jetës në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020
  4. Bujqësia në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020
  5. Blegtoria në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020
  6. Gjahtaria dhe peshkataria në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020
  7. Pylltaria në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020
  8. Turizmi në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

## 1. Tendencat dhe trendët afariste në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

Rajoni i Pollogut karakterizohet me një strukturë specifike të ndërmarrjeve që në shumë aspekte derivon nga mesatarja shtetërore si dhe nga karakteristikat e rajoneve tjera planore në vend.

Në dhjetëvjetorin e fundit është shënuar një rritje permanente në numrin e subjekteve afariste aktive që veprojnë në rajonin e Pollogut, graf.21.

Graf.21. Subjekte afariste aktive në rajonin e Pollogut në periudhën 2010-2020



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Edhe pse në trend fitohet përshtypje pozitive, e që është reale, komfor edhe të dhënave të paraqitura në grafikun e mëlartëm, përsëri duhet theksuar se rajoni i Pollogut në këtë drejtim nuk është në nivelin e duhur, krahasuar me numrin e përgjithshëm të subjekteve afariste në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kështu, ky rajon në periudhën në fjalë, në asnjë vit nuk ka participuar me as 12% në totalin e subjekteve afariste që veprojnë në nivel shtetërorë. Marrë për bazë numrin e popullsisë, por edhe kapacitetet reale për zhvillim të aktivitetit afarist në këtë rajon, duhet synuar një aktiviteti afarist më intensiv në periudhat e ardhshme kohore.



Tab.12. Subjekte afariste aktive në komunat e rajonit të Pollogut në periudhën 2010-2020

|                      | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|----------------------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| Bogovina             | 375  | 377  | 360  | 338  | 340  | 356  | 397  | 400  | 403  | 422  | 432  |
| Bërvenica            | 290  | 291  | 298  | 288  | 291  | 293  | 293  | 280  | 273  | 292  | 290  |
| Vrapçishti           | 356  | 350  | 347  | 352  | 365  | 387  | 447  | 447  | 465  | 460  | 444  |
| Gostivari            | 235  | 226  | 235  | 236  | 233  | 236  | 251  | 251  | 254  | 264  | 251  |
|                      | 4    | 5    | 0    | 9    | 9    | 2    | 3    | 9    | 4    | 2    | 2    |
| Zhelina              | 293  | 294  | 301  | 282  | 273  | 278  | 276  | 287  | 291  | 308  | 330  |
| Jegunovca            | 160  | 157  | 165  | 155  | 157  | 178  | 178  | 182  | 184  | 178  | 181  |
| Mavrova dhe Rostusha | 165  | 158  | 163  | 155  | 157  | 155  | 147  | 139  | 132  | 130  | 127  |
| Tearca               | 276  | 287  | 284  | 290  | 292  | 311  | 352  | 384  | 385  | 392  | 385  |
| Tetova               | 301  | 292  | 301  | 300  | 310  | 323  | 343  | 348  | 359  | 379  | 370  |
|                      | 1    | 1    | 7    | 7    | 9    | 4    | 0    | 0    | 5    | 0    | 7    |

**Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Siç është edhe e pritshme numri më i madh i ndërmarrjeve gravitojnë në komunat me seli në qytet, përkatësisht në komunën e Tetovës dhe atë të Gostivarit, por edhe komunat me seli në fshat kanë trend pozitiv në numrin e ndërmarrjeve aktive. Kështu në komunën e Bogovinës numri i ndërmarrjeve është rritur nga 375 në vitin 2010 në 432 në vitin 2020 duke shënuar rritje madhe edhe në kohë të pandemisë, në komunën e Vrapçishtit numri i ndërmarrjeve është rritur nga 356 në vitin 2010 në 460 në vitin 2019 që të bie në 444 në vitin 2020. Rritje të numrit të ndërmarrjeve është shënuar edhe në komunën e Tearcës, edhe atë nga 276 në vitin 2010 në 385 në vitin 2020; në komunën e Jegunovcës nga 160 në vitin 2010 në 181 në vitin 2020; dhe të Zhelinës nga 293 në vitin 2010 në 330 në vitin 2020. Zvogëlim i numrit të ndërmarrjeve në këtë periudhë është shënuar vetëm në komunën e Mavrovës dhe Rostushës, edhe atë nga 165 në vitin 2010 në 127 në vitin 2020.

Pos kësaj duhet theksuar se rajoni i Pollogut, ndonëse ngjashëm si dhe rajonet tjera, karakterizohet me një dominim të shprehur të bizneseve mikro dhe të vogla në numrin e përgjithshëm të ndërmarrjeve. Kështu, numri i bizneseve që punësojnë mbi 250 persona, pra sipas kriterit të numrit të punësuarve bizneseve të mëdha ka rrënë nga 9 në vitin 2008 në vetëm 7 në vitin 2020, ndërsa numri i bizneseve të mesme është rritur nga 79 në vitin 2008 në 106 në vitin 2018 që më pas të bien ë 101 në vitin 2020. Strukturë e ngjashme haset edhe te rajonet tjera në Republikën e Maqedonisë së Veriut, megjithatë me një pjesëmarrje më të shprehur të bizneseve të mëdha dhe atyre të mesme në strukturën e përgjithshme të bizneseve.

Tab.13. Ndërmarrje në rajonin e Pollogut sipas numrit të punësuarve në periudhën 2008-2020

|      | Gjithsej | 0 të punësuar ose<br>pa të dhëna | 1-9  | 10-49 | 50-249 | 250+ |
|------|----------|----------------------------------|------|-------|--------|------|
| 2008 | 6050     | 334                              | 5417 | 210   | 79     | 10   |
| 2009 | 6577     | 323                              | 5944 | 226   | 75     | 9    |
| 2010 | 7280     | 6211                             | 268  | 82    | 7      |      |
| 2011 | 7100     | 317                              | 6414 | 288   | 75     | 6    |
| 2012 | 7285     | 302                              | 6592 | 306   | 79     | 6    |
| 2013 | 7236     | 217                              | 6620 | 313   | 79     | 7    |
| 2014 | 7323     | 192                              | 6707 | 335   | 81     | 8    |
| 2015 | 7554     | 355                              | 6756 | 347   | 89     | 7    |
| 2016 | 8032     | 424                              | 7122 | 382   | 96     | 8    |
| 2017 | 8118     | 398                              | 7214 | 398   | 100    | 8    |
| 2018 | 8272     | 427                              | 7323 | 408   | 106    | 8    |
| 2019 | 8614     | 451                              | 7628 | 424   | 103    | 8    |
| 2020 | 8408     | 302                              | 7547 | 451   | 101    | 7    |

**Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut**


## 2.Ndërtimtaria në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

Ndërtimtaria në Republikën e Maqedonisë së Veriut është shndërruar në një nga degët kryesore dhe forcat kryesore lëvizëse të trendëve të përgjithshëm

ekonomik në vend. Ajo në masë të madhe ndikon rritjen ekonomike, shkallën e papunësisë dhe një varg të treguesve tjerë ekonomik.

Në rajonin e Pollogut gjatë dhjetëvjeçarit të fundit është shënuar rrënie permanente e lejeve për ndërtim edhe atë nga 737 në vitin 2008 në 497 në vitin 2020, graf.22.

Graf.22. Trendi i dhënies së lejeve për ndërtim në rajonin e Pollogut në periudhën 2008-2020



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Pjesa dërrmuese e lejeve për ndërtime në periudhën në fjalë kanë të bëjnë me ndërtime të larta, me një participim shumë të ulët të ndërtimeve të ulta, tab.14.

Tab.14. Leje ndërtimi sipas tipit të objektit për periudhën 2008-2020 në rajonin e Pollogut


| Viti | Gjithsej | Ndërtime të larta |      | Ndërtime të ulta |     |
|------|----------|-------------------|------|------------------|-----|
|      |          | n                 | %    | n                | %   |
| 2008 | 737      | 654               | 88.7 | 15               | 2.0 |

|      |     |     |      |    |     |
|------|-----|-----|------|----|-----|
| 2009 | 690 | 623 | 90.3 | 16 | 2.3 |
| 2010 | 581 | 525 | 90.4 | 12 | 2.1 |
| 2011 | 564 | 510 | 90.4 | 5  | 0.9 |
| 2012 | 593 | 514 | 86.7 | 24 | 4.0 |
| 2013 | 439 | 378 | 86.1 | 10 | 2.3 |
| 2014 | 454 | 387 | 85.2 | 23 | 5.1 |
| 2015 | 473 | 379 | 80.1 | 28 | 5.9 |
| 2016 | 529 | 398 | 75.2 | 48 | 9.1 |
| 2017 | 581 | 438 | 75.4 | 41 | 7.1 |
| 2018 | 478 | 349 | 73.0 | 44 | 9.2 |
| 2019 | 470 | 311 | 66.2 | 41 | 8.7 |
| 2020 | 497 | 377 | 75.9 | 34 | 6.8 |

**Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mëlartme, edhe pranë dominimit të vazhdueshëm të lejeve për ndërtime të larta në periudhën në fjalë, pjesëmarrja e tyre në totalin e lejeve për ndërtim ka shënuar rrënie në pesë vitet e fundit krahasuar me periudhën paraprake.


Graf.23. Objekte të ndërtuara në rajonin e Pollogut në periudhën 2007-2020



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Numri i objekteve të ndërtuara në rajonin e Pollogut ka shënuar rritje permanent edhe atë nga vetëm 55 objekte në vitin 2007 në 176 objekte në vitin 2019. Në vitin 2020 është shënuar një rrënie në 132 objekte, megjithatë kjo rrënie më shumë mundet tu përshkruhet pasojave të pandemisë e cila gjithsesi që ka goditur edhe këtë sektor me rëndësi vitale për ekonominë e rajonit të Pollogut.

Graf.24. Vlera monetare e objekteve të ndërtuara në rajonin e Pollogut në periudhën 2007-2020 (në denar)



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Rëndësia e madhe të sektorit të ndërtimtarisë për ekonominë e Pollogut , në veçanti gjatë dhjetëvjetorit të fundit, në veçanti e dëshmon rritja permanente e vlerës së objekteve të ndërtuara edhe atë nga 143442000 denarë në vitin 2007 në 1237172000 në vitin 2020 respektivisht 1893732000 denarë në vitin 2019. Në periudhën në fjalë, në rajonin e Pollogut janë ndërtuar objekte të vlerësuar në 10759550000 denarë ose rreth 174668019.5 euro.

### 3.Bujqësia në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

Bujqësia paraqet një ndër degët kryesore dhe njëkohësisht primare ekonomike në rajonin e Pollogut, ndonëse eksiton një qëndrim general se nga viti në vit bujqësia në këtë rajon humb në peshë paralelisht me largimin e popullsisë nga ky rajon por edhe paralelisht me orientimin e popullsisë drejt degëve tjera ekonomike.

Tab.15. Të dhëna mbi ekonomitë dhe sipërfaqet bujqësore sipas rajoneve në vitin 2016

|                   | 1      | 2      | 3      | 4      | 5      | 6     | 7     |
|-------------------|--------|--------|--------|--------|--------|-------|-------|
| Gjithsej          | 178125 | 366462 | 320738 | 217557 | 103181 | 23826 | 21898 |
| Rajoni i vardarit | 21944  | 46848  | 42708  | 24320  | 18388  | 3375  | 764   |
| Lindor            | 26003  | 56205  | 43949  | 34386  | 9563   | 4639  | 7618  |
| Jugperëndimor     | 17114  | 22869  | 17635  | 15121  | 2514   | 923   | 4311  |
| Juglindor         | 25323  | 38813  | 32995  | 22452  | 10543  | 4390  | 1428  |
| Pellagonia        | 26977  | 96369  | 90243  | 50887  | 39356  | 3631  | 2495  |
| Pollogu           | 21216  | 26856  | 25180  | 18551  | 6629   | 603   | 1073  |
| Verilindor        | 22083  | 49313  | 43263  | 33396  | 9867   | 3370  | 2680  |
| Shkupi            | 17465  | 29189  | 24765  | 18444  | 6321   | 2896  | 1528  |

1-Numri i ekonomive bujqësore 2-Toka që kanë në disponim 3-Sipërfaqe e shfrytëzuar 4-Sipërfaqe në pronësi personale 5-Sipërfaqe e huazuar 6-Sipërfaqe bujqësore të pashfrytëzuara 7-Toka tjera


**Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Në këtë drejtim duhet theksuar se rajoni i Pollogut në fakt krahasuar me rajonet tjera në vend, nuk ka sipërfaqe bujqësore të mjaftueshme edhe pranë shfrytëzimit maksimal të tyre. Kështu ky rajon përfshin vetëm 7.3% të tokës së përpunueshme bujqësore në vend. Nga ana tjetër rajoni i Pollogut është rajoni me shkallën më të lartë të shfrytëzimit të sipërfaqeve bujqësore në vend, duke lënë pas mesataren shtetërore. Kështu në këtë rajon shfrytëzohen rreth 94% të sipërfaqeve bujqësore, duke kaluar kështu edhe rajonin e Pellagonisë i cili ka gati pesëfish më shumë tokë bujqësore në krahasim me rajonin e Pollogut. Pra, realisht shikuar nuk

mundet të bëhet fjalë për nënvlerësim të bujqësisë në rajonin e Pollogut, por thjeshtë për mospasje të sipërfaqeve të mjaftueshme bujqësore, në veçanti krahasuar me numrin e lartë të popullsisë në këtë rajon. Kështu, vetëm për ilustrim në tabelën në vijim është paraqitur një analizë krahasimore e sipërfaqeve bujqësore dhe ekonomive bujqësore në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2016.

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun vijues pjesa dërmuese e ekonomive bujqësore në rajonin e Pollogut janë të orientuara rreth prodhimit të drithërave, kulturave ushqimore dhe patateve.


Graf.25. Numri i ekonomive bujqësore sipas kulturave bujqësore në rajonin e Pollogut në vitin 2016



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun vijues, pjesa më e madhe e tokave bujqësore në rajonin e Pollogut i përkasin kategorisë së tokave të lëvruara dhe livadheve me një pjesëmarrje shumë të vogël të sipërfaqeve të mbjella me pemë dhe vreshtave.

Graf.26. Sipërfaqe bujqësore sipas dedikimit në rajonin e Pollogut në vitin 2016




Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në grafikun vijues janë të paraqitura të dhëna mbi sipërfaqet bujqësore në rajonin e Pollogut sipas kulturave specifike bujqësore.



Graf.27. Sipërfaqe bujqësore sipas kulturës bujqësore në rajonin e Pollogut në vitin 2016



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Molla mbetet pema më e preferuar për kultivim në rajonin e Pollogut, tab.x.


| Tab.16. Pemë të kultivuara në rajonin e Pollogut |                  |      |            |      |
|--------------------------------------------------|------------------|------|------------|------|
|                                                  | Numri i rrënjëve |      | Sipërfaqja |      |
|                                                  | n                | %    | n          | %    |
| Molla                                            | 181073           | 35.6 | 263        | 38.0 |
| Dardha                                           | 6875             | 1.4  | 11         | 1.6  |
| Kumbulla                                         | 19221            | 3.8  | 34         | 4.9  |
| Qershi                                           | 3585             | 0.7  | 7          | 1.0  |
| Vishnja                                          | 97577            | 19.2 | 116        | 16.7 |
| Kajsi                                            | 1394             | 0.3  | 10         | 1.4  |

|                 |       |      |     |      |
|-----------------|-------|------|-----|------|
| Pjeshka         | 168   | 0.0  | 0   | 0.0  |
| Ara             | 11519 | 2.3  | 84  | 12.1 |
| Bajame          | 2854  | 0.6  | 13  | 1.9  |
| Lejthi          | 92369 | 18.2 | 126 | 18.2 |
| Mjedra          | 21939 | 4.3  | 2   | 0.3  |
| Manaferra tjera | 65977 | 13.0 | 25  | 3.6  |
| Pemë tjera      | 3962  | 0.8  | 2   | 0.3  |

**Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Pra, siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mëlartme pema dukshëm më e kultivuar në rajonin e Pollogut është molla me 181073 rrënjë respektivisht mbi 1/3 nga numri i përgjithshëm i pemëve të kultivuara në këtë rajon. Rreth 38% i sipërfaqes së përgjithshme të mbjellur me pemë në rajonin e Pollogut është sipërfaqe e mbjellur me molla. Vishnja është pema e dytë më e kultivuar e ndjekur nga lejthitë.

Graf.28. Sipërfaqe bujqësore sipas klasës në rajonin e Pollogut në vitin 2016



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut


Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm pjesa më e madhe e tokës bujqësore në rajonin e Pollogut është tokë bujqësore e klasifikuar si tokë deri e klasës së tretë me një pjesëmarrje më të ulët të klasëve tjera të tokës bujqësore në këtë rajon,

#### 4. Blegtoria në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

Blegtoria në rajonin e Pollogut historikisht ka qenë ndër veprimtaritë me rëndësi të jetësore për popullsinë, nënkuptohet paralelisht me bujqësinë. Megjithatë, viteve të fundit vërehet një rrënie permanente e angazhimit të banorëve në mbajtjen dhe mirëmbajtjen e kafshëve shtëpiake.

Shikuar në numra absolut fitohet përshtypje se rajoni i Pollogut nuk shënon ndonjë ngecje të veçantë në mbajtjen e kafshëve shtëpiake, krahasuar me rajonet tjera në vend, graf.29.

Graf.29. Njësi blegtorale sipas rajoneve në vitin 2016




Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Pra, për nga numri i përgjithshëm i njësive blegtorale, rajoni i Pollogut rangohet i treti në vend, menjëherë pas Pellagonisë dhe rajonit Lindor. Megjithatë shikuar si proporcion në krahasim me popullsinë rajoni i Pollogut rangohen i

parafundit në vend për nga numri i njësi blegtorale për kokë banori, menjëherë pas rajonit të Shkupit. Në fakt, në rajonin e Pollogut kultivohen 0.151 njësi blegtorale për banor, ndërsa në rajonet tjera ky numër është midis 0.2 dhe 0.3 njësi blegtorale për kokë banori. Përfundimisht në rajonin e Shkupit me 0.06 njësi blegtorale për kokë banori dhe ai Jugperëndimor me 0.158 njësi blegtorale për kokë banori.

Graf.30. Njësi blegtorale në rajonin e Pollogut në vitin 2016




Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm, në vitin 2016 në rajonin e Pollogut janë kultivuar gjithsej 59685 dele, 34521 lopë, 837 thundrorë përkatësisht juaj dhe gomerë si dhe 10743 koshere bletë.

## 5. Gjahtaria në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

Gjahtaria në rajonin e Pollogut edhe pranë ekzistimit të parakushteve natyrore nuk është e zhvilluar në nivel të mjaftueshëm. Në fakt

Graf.31. Gajhtaria në rajonin e Pollogut në periudhën 2010-2019




Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Ndonëse me oscilime evidente gajhtaria në rajonin e Pollogut në decenien e fundit në përgjithësi marrë ka shënuar rritje, me vetë faktin se në vitin 2010 kanë qenë të raportuara 4963 kafsha të gjuajtura kurse në vitin 2019 ky numër ka qenë 11446 . Në fakt, për periudhën në fjalë, gajhtaria në rajonin e Pollogut në nivel më të ulët ka qenë në vitin 2010, ndërsa nivelin më të lartë e ka arritur në vitin 2012. Përndryshe dhia e egër, kaprolli, lepuri dhe derri i egër janë kafshët më shpesh të gjuajtura në rajonin e Pollogut. Kështu, në këtë periudhë në rajonin e Pollogut kanë qenë të gjuajtura rreth 17340 dhi të egra, 12788 kaproj, 15511 lepuj, 9658 derra të egër. Por, kanë qenë të gjuajtura edhe 1659 arinj, 962 ujë dhe 2186 dhelpra.

## 6. Pylltaria në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

Komfor të dhënave zyrtare, në rajonin e Pollogut sipërfaqet e pyllëzuara gjatë decencies së fundit kanë mbetur relativisht konstante, siç edhe mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëposhtëm.


Graf.32. Sipërfaqe pyjore në rajonin e Pollogut në periudhën 2010-2019



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në periudhën 2010-2019 legalisht janë prerë rreth 625463 kg drunj në rajonin e Pollogut. Shpërndarja sipas viteve është shprehur në grafikun vijues.


Graf.33. Drunj të prerë në rajonin e Pollogut në periudhën 2010-2019



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Rreth 11387 m/3 dru në mënyrë të jashtëligjshme janë prerë në rajonin e Pollogut në periudhën 2010-2018, numër ky që ka gjasa reale të jetë dukshëm më i madh në praktikë, graf.34.

Graf.34. Drunj të prerë në mënyrë të jashtëligjshme rajonin e Pollogut në periudhën 2010-2019



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

## 7.Turizmi në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

Edhe pranë kapaciteteve reale për zhvillim të turizmit malor, kulturor dhe dimërorë, të dhënat statistikore flasin qartë se rajoni i Pollogut nuk paraqet ndonjë destinacion të preferuar për turistë, qofshin ato të jashtëm ose vendor.

Tab.17. Numri i turistëve në rajonin e Pollogut në periudhën 2006-2020

| Viti | Lloji    | Republika e Maqedonisë së Veriut | Pollogu |     |
|------|----------|----------------------------------|---------|-----|
|      |          |                                  | n       | %   |
| 2006 | Gjithsej | 499473                           | 21890   | 4.4 |

|      |          |        |       |     |
|------|----------|--------|-------|-----|
|      | Vendorë  | 297116 | 12705 | 4.3 |
|      | Të huaj  | 202357 | 9185  | 4.5 |
| 2007 | Gjithsej | 536212 | 17188 | 3.2 |
|      | Vendorë  | 306132 | 9174  | 3.0 |
|      | Të huaj  | 230080 | 8014  | 3.5 |
| 2008 | Gjithsej | 605320 | 19153 | 3.2 |
|      | Vendorë  | 350363 | 9931  | 2.8 |
|      | Të huaj  | 254957 | 9222  | 3.6 |
| 2009 | Gjithsej | 587770 | 31596 | 5.4 |
|      | Vendorë  | 328566 | 17500 | 5.3 |
|      | Të huaj  | 259204 | 14096 | 5.4 |
| 2010 | Gjithsej | 586241 | 31828 | 5.4 |
|      | Vendorë  | 324545 | 17350 | 5.3 |
|      | Të huaj  | 261696 | 14478 | 5.5 |
| 2011 | Gjithsej | 647568 | 29153 | 4.5 |
|      | Vendorë  | 320097 | 16196 | 5.1 |
|      | Të huaj  | 327471 | 12957 | 4.0 |
| 2012 | Gjithsej | 663633 | 29884 | 4.5 |
|      | Vendorë  | 312274 | 17098 | 5.5 |
|      | Të huaj  | 351359 | 12786 | 3.6 |
| 2013 | Gjithsej | 701794 | 30823 | 4.4 |
|      | Vendorë  | 302114 | 15491 | 5.1 |
|      | Të huaj  | 399680 | 15332 | 3.8 |
| 2014 | Gjithsej | 735650 | 29143 | 4.0 |
|      | Vendorë  | 310336 | 15886 | 5.1 |
|      | Të huaj  | 425314 | 13257 | 3.1 |
| 2015 | Gjithsej | 816067 | 30200 | 3.7 |
|      | Vendorë  | 330537 | 14565 | 4.4 |
|      | Të huaj  | 485530 | 15635 | 3.2 |
| 2016 | Gjithsej | 856843 | 27318 | 3.2 |
|      | Vendorë  | 346359 | 13805 | 4.0 |
|      | Të huaj  | 510484 | 13513 | 2.6 |
| 2017 | Gjithsej | 998841 | 30124 | 3.0 |




|      |          |         |       |     |
|------|----------|---------|-------|-----|
|      | Vendorë  | 368247  | 14150 | 3.8 |
|      | Të huaj  | 630594  | 15974 | 2.5 |
| 2018 | Gjithsej | 1126935 | 37091 | 3.3 |
|      | Vendorë  | 419590  | 16802 | 4.0 |
|      | Të huaj  | 707345  | 20289 | 2.9 |
| 2019 | Gjithsej | 1184963 | 41994 | 3.5 |
|      | Vendorë  | 427370  | 18560 | 4.3 |
|      | Të huaj  | 757593  | 23434 | 3.1 |
| 2020 | Gjithsej | 467514  | 31061 | 6.6 |
|      | Vendorë  | 349308  | 20723 | 5.9 |
|      | Të huaj  | 118206  | 10338 | 8.7 |

**Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Pra, rajoni i Pollogut edhe pranë faktit që ka Kodrën e Diellit, Liqenin e Mavrovës, parkun nacional të Mavrovës, ski qendrën e Bistrës, sytë e maleve të Sharit dhe shumë atraksione tjera turistike, në periudhë 2006-2020 asnjëherë nuk ia ka dale të participojë me më shumë se 7% në numrin e përgjithshëm të turistëve në nivel shtetërorë. Kështu sukses më i lartë në këtë drejtim është realizuar në vitin 2019 kur ky rajon ka qenë i vizituar nga gjithsej 41994 turistë, por që është një participim prej vetëm 3.5% në numrin total prej 1184963 turistë të regjistruar atë vit në nivel shtetërorë.

Gjatë tërë periudhës 2006-2020 vetëm 877842 kalime nate nga turistë në rajonin e Pollogut janë regjistruar. Vetëm për ilustrim në periudhën në fjalë gjithsej 34739492 natë janë kaluar nga ana e turistëve në nivel shtetërorë, që nënkupton se rajoni i Pollogut sipas këtij treguesi participon me vetëm 2.5% në totalin shtetërorë.


Graf.35. Netë të kaluara në rajonin e Pollogut nga ana e turistëve në periudhën 2006-2020



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Por edhe pranë kësaj në periudhën në fjalë është shënuar një rritje gati permanente e kapaciteteve akomoduese në rajonin e Pollogut, graf.36.

Graf.36. Kapacitete për akomodim të turistëve në rajonin e Pollogut në periudhën 2006-2020



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Pra, në periudhën në fjalë numri i shtretërve në rajonin e Pollogut është zmadhuar nga 3069 në vitin 2006 në 3743 në vitin 2020, ndërsa numri i dhomave nga 987 në vitin 2006 në 1230 në vitin 2020.

Kapitulli



## **Specifika dhe trendë të popullsisë në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020**

- 
1. Karakteristika demografike të popullsisë në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020
  2. Shtimi natyror i popullsisë së Pollogut në periudhën 2000-2020
  3. Migrimet e popullsisë së Pollogut në periudhën 2000-2020


## 1. Karakteristika demografike të popullsisë në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

Fatkeqësisht në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk është realizuar regjistrim adekuat i popullsisë që nga viti 2002, por edhe ato që janë realizuar asnjëherë nuk kanë përfituar besimin e plotë të qytetarëve meqë regjistrimet e popullsisë më tepër konsiderohen në rastin e vendit tonë si operacione politike sesa si operacione reale statistikore. Kjo në veçanti vjen në shprehje pas vitit 2001 respektivisht pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe ndryshimeve Kushtetuese të bazuara në të, e sipas të cilave të drejtat kolektive të qytetarëve varen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga participimi i tyre në numrin e përgjithshëm të popullsisë në vend. Ç'është e vërteta para disa viteve pati një regjistrim të filluar e më pas të ndërprerë, pra të dështuar ndërsa në vitin 2021 pati edhe një tendencë për regjistrim të popullsisë, por pas pazarllëqeve politike u akordua prolongimi i të njëjtit për disa muaj duke marrë dikush si shkak e dikush si shkak pandeminë COVID-19.

Andaj, në mungesë të regjistrimeve më të reja, dhe në tërësi të vetëdijshëm për dyshimet në korrektësinë e rezultateve të regjistrimit të vitit 2002, me qëllim të identifikimit të disa trendëve të përgjithshëm të lëvizjes së popullsisë në rajonin e Pollogut gjatë dy dekenieve të fundit, do të shërbehemi si pikë nisëse me rezultatet zyrtare nga regjistrimi i vitit 2002 i popullsisë dhe amvisërive në Republikën e Maqedonisë atëbotë, respektivisht në Republikën e Maqedonisë së Veriut sot.

Komfor të dhënave nga regjistrimi i vitit 2002, rajoni i Pollogut ka numëruar gjithsej 304125 banorë, duke qenë i ranguar si rajoni i dytë për nga numri i popullsisë menjëherë pas rajonit të Shkupit. Pollogu i Poshtëm ka numëruar një popullsi më të lartë në krahasim me Pollogun e Epërm i cili numëron vetëm tre nga gjithsej nëntë komunat që përbëjnë rajonin e Pollogut në përgjithësi.


Graf.37. Popullsia e komunave të rajonit të Pollogut sipas regjistrimit të vitit 2002 të popullsisë



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Pra, dy komunat me seli në qytet, komuna e Tetovës dhe Gostivarit janë edhe logjikisht dy komunat me numër më të madh të popullsisë në suaza të këtij rajoni , komuna këto me një dallim të vogël në numrin e popullsisë. Nga ana tjetër komuna më e vogël me seli në fshat në suaza të rajonit të Gostivarit numëron vetëm 8618 banorë, ndërsa më e madhja gati 29.000 banorë.

Graf.38. Pjesëmarrja e komunave të veçanta në totalin e popullsisë së rajonit të Pollogut sipas regjistrimit të vitit 2002



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm komuna e Tetovës dhe Gostivarit bashkërisht participojnë me rreth 55% në totalin e popullsisë së rajonit të Pollogut. Komuna e Mavrovës dhe Rostushës si dy komuna me seli në fshat e që i përkasin Pollogut të epërm bashkërisht participojnë me 11% në totalin e popullsisë së rajonit të Pollogut, kurse komunat me seli në fshat që i përkasin Pollogut të poshtëm participojnë me rreth 1/3 në totalin e popullsisë së rajonit të Pollogut.

Tab.18. Struktura gjinore e komunave në rajonin e Pollogut

|            | Gjithsej | Meshkuj |      | Femra |      |
|------------|----------|---------|------|-------|------|
|            |          | n       | %    | n     | %    |
| Bogovina   | 28997    | 14636   | 50.5 | 14361 | 49.5 |
| Bërvenica  | 15855    | 7924    | 50.0 | 7931  | 50.0 |
| Vrapçishti | 25399    | 12422   | 48.9 | 12977 | 51.1 |
| Gostivari  | 81042    | 40507   | 50.0 | 40535 | 50.0 |
| Zhelina    | 24390    | 12335   | 50.6 | 12055 | 49.4 |




|                                                                                                  |       |       |      |       |      |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|-------|------|-------|------|
| Jegunovca                                                                                        | 10790 | 5543  | 51.4 | 5247  | 48.6 |
| Mavrova dhe Rostusha                                                                             | 8618  | 4295  | 49.8 | 4323  | 50.2 |
| Tearca                                                                                           | 22454 | 11502 | 51.2 | 10952 | 48.8 |
| Tetova                                                                                           | 86580 | 43543 | 50.3 | 43037 | 49.7 |
| <b>Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut</b> |       |       |      |       |      |

Pra, komfor të dhënave nga regjistrimi i vitit 2002, rajoni i Pollogut karakterizohet me një strukturë relativisht të balancuar gjinore të popullsisë, ndonëse rreth 50.2% i popullsisë i përkasin gjinisë mashkullore. Specifike është se komuna e Gostivarit dhe ajo e Bërvenicës kanë gati strukturë të barazuar gjinore të popullsisë. Komuna e Bogovinës, Zhelinës, Jegunovcës, dhe Tearcës kanë një pjesëmarrje më të shprehur të popullsisë së gjinisë mashkullore në totalin e popullsisë, përderisa një trend i kundërt vërehet te komuna e Vrapçishtit dhe ajo e Mavrovës dhe Rostushës.

Komfor të dhënave të regjistrimit të vitit 2002, shikuar sipas strukturës etnike të popullsisë rajoni i Pollogut është kryesisht i popullzuar me popullsi shqiptare, e më pas radhiten për nga numri i popullsisë maqedonasit dhe turqit. Kështu 72% i përkasin bashkësisë etnike shqiptare, 19% bashkësisë etnike maqedonase dhe 6% bashkësisë etnike turke. Bashkësitë tjera etnikë janë shumë pak të përfaqësuara në strukturën e popullsisë së rajonit të Pollogut.

Graf.39. Struktura etnike e popullsisë së Pollogut



Megjithatë, jo të gjitha komunat që përbëjnë rajonin e Pollogut kanë të njëjtën strukturë etnike të popullsisë.

| Tab.19. Struktura etnike e popullsisë në komunat e veçanta në rajonin e Pollogut |              |           |      |          |      |      |      |       |     |
|----------------------------------------------------------------------------------|--------------|-----------|------|----------|------|------|------|-------|-----|
|                                                                                  | Gjiths<br>ej | Maqedonas |      | Shqiptar |      | Turq |      | Tjerë |     |
|                                                                                  |              | n         | %    | n        | %    | n    | %    | n     | %   |
| Bogovina                                                                         | 28997        | 37        | 0.1  | 2761     | 95.4 | 118  | 4.1  | 163   | 0.6 |
| Bërvenica                                                                        | 15855        | 5949      | 37.5 | 9770     | 61.6 | 2    | 0.0  | 134   | 0.8 |
| Vrapçishti                                                                       | 25399        | 1041      | 4.1  | 2110     | 83.1 | 313  | 12.3 | 123   | 0.5 |
| Gostivari                                                                        | 81042        | 15877     | 19.6 | 5403     | 66.8 | 799  | 9.9  | 313   | 3.9 |
| Zhelina                                                                          | 24390        | 71        | 0.3  | 2419     | 99.5 | 2    | 0.0  | 122   | 0.5 |

|                                                                                                  |       |       |      |           |          |          |          |          |     |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|-------|------|-----------|----------|----------|----------|----------|-----|
| Jegunovca                                                                                        | 10790 | 5963  | 55.3 | 4642      | 43.<br>0 | 4        | 0.0      | 181      | 1.7 |
| Mavrova dhe<br>Rostusha                                                                          | 8618  | 4349  | 50.5 | 1483      | 17.<br>2 | 268<br>0 | 31.<br>1 | 106      | 1.2 |
| Tearca                                                                                           | 22454 | 2739  | 12.2 | 1895<br>0 | 84.<br>4 | 516      | 2.3      | 249      | 1.1 |
| Tetova                                                                                           | 86580 | 20053 | 23.2 | 6088<br>6 | 70.<br>3 | 188<br>2 | 2.2      | 375<br>9 | 4.3 |
| <b>Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut</b> |       |       |      |           |          |          |          |          |     |

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mëlartme, bashkësia etnike maqedonase pjesëmarrje më të ulët ka në strukturën etnike të popullsisë në komunën e Bogovinës, kurse më të lartë në komunën e Jegunovcës. Bashkësia etnike shqiptare participim më të lartë në totalin e popullsisë ka në komunën e Zhelinës kurse më të ulët në komunën e Mavrovës dhe Rostushës. Nga ana tjetër, bashkësia etnike turke pjesëmarrje më të lartë ka në komunën e Mavrovës dhe Rostushës, ndërsa participim minor ka në komunën e Bërvenicës, Zhelinës dhe Jegunovcës.

Ndonëse nuk ekziston ndonjë e dhënë e konfirmuar statistikore për strukturën fetare të popullsisë, marrë për bazë regjistrimin e vitit 2002 dhe faktin se së paku të gjithë shqiptarët dhe turqit në rajonin e Pollogut i përkasin bashkësisë fetare islame dhe të njëjtës i përkasin edhe një pjesë e popullsisë maqedonase në komunën e Mavrovës dhe Rostushës si dhe një pjesë e popullsisë rome në këtë rajon, mundet të konkludohet se popullsia myslimane participon me së paku 4/5 në strukturën fetare të popullsisë në rajonin e Pollogut. Pjesa tjetër e popullsisë u përkasin bashkësive tjera fetare, kryesisht bashkësisë fetare ortodokse.


Ndonëse regjistrimi në fjalë përmban dhe të dhëna për strukturën e popullsisë edhe sipas kriterëve tjera, duke patur para sysh që kanë kaluar gati dy decenie nga realizimi i të njëjtit të dhënat në fjalë nuk duhet marrë si adekuate për të përshkruar strukturën demografike në vend ose rajonet e veçanta të tij.

## 2. Shtimi natyror i popullsisë së Pollogut në periudhën 2000-2020

Kur bëhet fjalë për shtimin natyror të popullsisë, para së gjithash mendohet në dallimet në mes shkallës së natalitetit dhe mortalitetit në një rajon të caktuar.

Në periudhën 2000-2019 në rajonin e Pollogut janë regjistruar gjithsej 71781 foshnje të lindura të gjalla, graf.40.

Graf.40. Foshnje të lindura të gjalla në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019




Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm që nga viti 2000 në rajonin e Pollogut, edhe pranë oscilimeve është shënuar një rënie graduale në natalitetin e popullsisë. Kështu, përderisa në vitin 2000 ka patur 4429 foshnje të lindura të gjalla, në vitin 2019 ky numër ka rrenë në 3028 e që është njëkohësisht edhe shkalla më e ulët e lindshmërisë në këtë rajon për periudhën e hulumtuar. Por duhet theksuar fakti se edhe pranë kësaj, rajoni i Pollogut është rajoni

me shkallën më të lartë në lindshmërisë në vend, në vazhdimësi që nga viti 2000, menjëherë pas rajonit të Shkupit që përfshin kryeqytetin e vendit.

Graf.41. Numri i të vdekurve në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm, në periudhën 2000-2019 nuk mundet të bëhet fjalë për oscilime më të shprehura në numrin e të vdekurve në rajonin e Pollogut. Në periudhën në fjalë, gjithsej 45231 persona kanë ndërruar jetë në rajonin e Pollogut. Numri më i vogël i të vdekurve

është shënuar në vitin 2001 kur gjithsej janë regjistruar 2012 persona të vdekur në këtë rajon, ndërsa si vit me numër më të madh të vdekurve në periudhën e analizuar është viti 2011 me gjithsej 2416 persona të vdekur.


Graf.42. Shtimi natyror i popullsisë në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019

Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në periudhën 2000-2019, rajoni i Pollogut në vazhdimësi ka patur saldo pozitive të shtimit natyror të popullsisë. Kështu, saldoja pozitive për periudhën në fjalë është 26550 persona. Në fakt, rajoni i Pollogut për periudhën në fjalë është rajoni i

dytë për nga shtimi natyror i popullsisë, i ranguar menjëherë pas Shkupit i cili ka shënuar shkallë dyfish më të lartë në shtimin natyror të popullsisë në vend. Ndonëse numri i shtimit natyror të popullsinë në rajonin e Pollogut është më i ulët në krahasim me periudhat paraprake, duhet patur parasysh se në periudë 2000-2019 ka patur dhe rajone me shtim negative natyror të popullsisë, përkatësisht rajone ku mortaliteti ka tejkaluar natalitetin, graf.43.


Graf.43. Analizë krahasimore e shtimit natyror të popullsisë në rajonet e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2019



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në përputhje me rënien permanente në numrin e të lindurve në rajonin e Pollogut është shënuar edhe rrënie permanente në shkallën e natalitetit, graf.44.

Graf.44. Nataliteti në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019




Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Pra edhe pranë oscilimeve të kohë pas kohëshme, nataliteti në rajonin e Pollogut ka shënuar rrënie permanente, edhe atë nga 14.61 në vitin 2000 kur dhe ka qenë në nivelin më të lartë për periudhën e hulumtuar në 9.4 në vitin 2019 kur edhe ka qenë në pikën më të ulët për periudhën e hulumtuar. Por, edhe pranë trendit rrënës, në periudhën e hulumtuar, rajoni i Pollogut ka patur natalitet më të lartë se mesatarja shtetërore, graf.45.




Graf.45. Analizë krahasimore e natalitetit në rajonin e Pollogut dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2000-2019



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Analizat nxjerrin në pah një lëvizje të zhdrejtë në mortalitetin e popullsisë së Pollogut në periudhën 2000-2019, graf.46.


Graf.46. Mortaliteti në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në rajonin e Pollogut shkalla më e lartë e mortalitetit për periudhën e hulumtuar është shënuar në vitin 2016, përkatësisht 7.6 kurse shkalla më e ulët e mortalitetit është shënuar në vitin 2001 përkatësisht 6.59.

Graf.47. Shkalla e shtimit natyror të popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019




Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Rajoni i Pollogut në periudhën e hulumtuar në vazhdimësi ka patur shkallë pozitive të shtimit natyror të popullsisë, ndonëse kjo shkallë ka shënuar rrënie permanente nga viti në vit, edhe atë nga 7.94 në vitin 2000 në 2.3 në vitin 2019. Por, edhe pranë rënies në fjalë, siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm, në vazhdimësi ky rajon ka patur shkallë së paku dyfish më të lartë në krahasim me mesataren shtetërore. Në fakt në vitin 2019, Republika e Maqedonisë së Veriut ka shënuar shkallë negative të rritjes natyrore të popullsisë prej -0.3, ndërsa rajoni i Pollogut ka shënuar shkallë pozitive të shtimit natyror të popullsisë prej 2.3.

### 3. Migrimet e popullsisë së Pollogut në periudhën 2000-2020

Edhe pranë shkallëve relativisht të volitshme të shtimit natyror të popullsisë, rajoni i Pollogut ndodhet shumë larg një situatë ideale, për çka në masë më të madhe ndikojnë emigrimet permanente të popullsisë. Por, duke patur para sysh se bëhet fjalë për qëndrime të përkohshme (ose të planifikuara si të përkohshme), pjesa më e madhe e mërgimtarëve nuk menaxhojnë pjesën e dokumentacionit në mënyrë të rregullt andaj dhe nuk figurojnë një evidencat zyrtare statistikore. Për pasojë ekziston një diskrepancë reale në mes shkallës reale dhe asaj zyrtare të emigrimeve të jashtme në rajonin e Pollogut.

Graf.48. Emigrime nga rajoni i Pollogut në periudhën 2000-2019



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kështu, për periudhën 2000-2019 janë regjistruar gjithsej 2414 emigrime nga rajoni i Pollogut, që aspak nuk korrespondon me realitetin duke patur para sysh se në këtë periudhë aq persona janë shpërngulur vetëm nga komuna më e vogël që bën pjesë në rajonin e Pollogut. Por, në mungesë të të dhënave tjera zyrtare në grafikun vijues janë të paraqitura të dhënat ekzistuese mbi numrin e emigrimeve nga rajoni i Pollogut në periudhën 2000-2019.

Tab.20. Imigrantë në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019

| Viti | Gjithsej | Qytetarë të RMV |      | Të huaj |      |
|------|----------|-----------------|------|---------|------|
|      |          | n               | %    | n       | %    |
| 2000 | 382      | 309             | 80.9 | 73      | 19.1 |
| 2001 | 226      | 194             | 85.8 | 32      | 14.2 |
| 2002 | 231      | 225             | 97.4 | 6       | 2.6  |
| 2003 | 248      | 203             | 81.9 | 45      | 18.1 |
| 2004 | 536      | 202             | 37.7 | 334     | 62.3 |
| 2005 | 320      | 213             | 66.6 | 107     | 33.4 |
| 2006 | 199      | 147             | 73.9 | 52      | 26.1 |
| 2007 | 125      | 42              | 33.6 | 83      | 66.4 |

|      |     |     |      |     |      |
|------|-----|-----|------|-----|------|
| 2008 | 40  | 29  | 72.5 | 11  | 27.5 |
| 2009 | 101 | 15  | 14.9 | 86  | 85.1 |
| 2010 | 158 | 32  | 20.3 | 126 | 79.7 |
| 2011 | 252 | 62  | 24.6 | 190 | 75.4 |
| 2012 | 287 | 39  | 13.6 | 248 | 86.4 |
| 2013 | 210 | 11  | 5.2  | 199 | 94.8 |
| 2014 | 209 | 27  | 12.9 | 182 | 87.1 |
| 2015 | 456 | 11  | 2.4  | 445 | 97.6 |
| 2016 | 362 | 24  | 6.6  | 338 | 93.4 |
| 2017 | 351 | 79  | 22.5 | 272 | 77.5 |
| 2018 | 490 | 112 | 22.9 | 378 | 77.1 |
| 2019 | 687 | 88  | 12.8 | 599 | 87.2 |

**Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Rajoni i Pollogut nuk është destinacion i preferuar për imigrime. Kështu në tërë kohëzgjatjen e periudhës 2000-2019 në këtë rajon janë vendosur gjithsej 5870 persona, afro 2/3 nga të cilët nënshtetas të huaj. Në fakt, në periudhën pas vitit 2009, pjesa dërmuese e imigrantëve drejt rajonit të Pollogut kanë qenë nënshtetas të huaj dhe një pjesë shumë e vogël nënshtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut, tab.20.

Kur bëhet fjalë për migrimet e brendshme duhet theksuar se rajoni i Pollogut gati në vazhdimësi në periudhën 2000-2019 është ballafaquar me saldo negative, tab.21.

**Tab.21. Migrimet e brendëshme në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019**

| Viti | Imigrant | Emigrant | Saldo |
|------|----------|----------|-------|
| 2000 | 204      | 269      | -65   |
| 2001 | 158      | 302      | -144  |
| 2002 | 223      | 453      | -230  |
| 2003 | 238      | 444      | -206  |
| 2004 | 229      | 439      | -210  |
| 2005 | 264      | 376      | -112  |
| 2006 | 240      | 354      | -114  |

|      |     |     |      |
|------|-----|-----|------|
| 2007 | 234 | 357 | -123 |
| 2008 | 305 | 343 | -38  |
| 2009 | 277 | 365 | -88  |
| 2010 | 286 | 236 | 50   |
| 2011 | 271 | 329 | -58  |
| 2012 | 304 | 367 | -63  |
| 2013 | 259 | 293 | -34  |
| 2014 | 182 | 268 | -86  |
| 2015 | 193 | 328 | -135 |
| 2016 | 210 | 367 | -157 |
| 2017 | 215 | 330 | -115 |
| 2018 | 196 | 280 | -84  |
| 2019 | 211 | 342 | -131 |

**Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Pra, në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019 janë shënuar gjithsej 4699 imigrime të brendshme dhe gjithsej 6842 emigrime të brendshme që nënkupton një saldo negative prej 2143 persona.

Kapitulli

# IV

## Arsimi në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

- 
1. Arsimi fillorë në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020
  2. Arsimi i mesëm në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020
  3. Arsimi i lartë në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020
  4. Përkujdesja shëndetësore në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

## 1. Arsimi fillorë në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

Në vitin shkollor 2019-2020 në rajonin e Pollogut kanë funksionuar gjithsej 147 shkolla fillore nga të cilat 13 shkolla fillore të pavarura, 41 shkolla fillore qendrore, dhe 93 shkolla fillore regjionale. Vetëm dy shkolla fillore që funksionojnë në rajonin e Pollogut janë shkolla në pronësi private, nga të cilat njëra është shkollë e pavarur dhe njëra shkollë regjionale.

Tab.22. Mësues në shkollat fillore në rajonin e Pollogut


|                                         |                            |          | Gjithsej | Në shkolla fillore<br>shtetërore | Në shkolla fillore<br>private |
|-----------------------------------------|----------------------------|----------|----------|----------------------------------|-------------------------------|
| Gjithsej                                | Gjithsej                   | Gjithsej | 3117     | 3053                             | 64                            |
|                                         |                            | Femra    | 2004     | 1961                             | 43                            |
|                                         |                            | Meshkuj  | 1113     | 1092                             | 21                            |
|                                         | Me orar<br>të plotë        | Gjithsej | 2753     | 2701                             | 52                            |
|                                         |                            | Femra    | 1763     | 1723                             | 40                            |
|                                         |                            | Meshkuj  | 990      | 978                              | 12                            |
|                                         | Me orar<br>të<br>shkurtuar | Gjithsej | 364      | 352                              | 12                            |
|                                         |                            | Femra    | 241      | 238                              | 3                             |
|                                         |                            | Meshkuj  | 123      | 114                              | 9                             |
| Me<br>kontratë<br>të<br>paafatizu<br>ar | Gjithsej                   | Gjithsej | 2438     | 2419                             | 19                            |
|                                         |                            | Femra    | 1585     | 1572                             | 13                            |
|                                         |                            | Meshkuj  | 853      | 847                              | 6                             |
|                                         | Me orar<br>të plotë        | Gjithsej | 2255     | 2236                             | 19                            |
|                                         |                            | Femra    | 1461     | 1448                             | 13                            |
|                                         |                            | Meshkuj  | 794      | 788                              | 6                             |
|                                         | Me orar<br>të<br>shkurtuar | Gjithsej | 183      | 183                              | -                             |
|                                         |                            | Femra    | 124      | 124                              | -                             |
|                                         |                            | Meshkuj  | 59       | 59                               | -                             |
| Me<br>kontratë<br>në vepër              | Gjithsej                   | Gjithsej | 679      | 634                              | 45                            |
|                                         |                            | Femra    | 419      | 389                              | 30                            |
|                                         |                            | Meshkuj  | 260      | 245                              | 15                            |



|                                                                                           |                            |          |     |     |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|----------|-----|-----|----|
|                                                                                           | Me orar<br>të plotë        | Gjithsej | 498 | 465 | 33 |
|                                                                                           |                            | Femra    | 302 | 275 | 27 |
|                                                                                           |                            | Meshkuj  | 196 | 190 | 6  |
|                                                                                           | Me orar<br>të<br>shkurtuar | Gjithsej | 181 | 169 | 12 |
|                                                                                           |                            | Femra    | 117 | 114 | 3  |
|                                                                                           |                            | Meshkuj  | 64  | 55  | 9  |
| Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut |                            |          |     |     |    |

Në shkollat fillore në rajonin e Pollogut janë të angazhuar gjithsej 3117 mësues 98% nga të cilët në shkollat fillore në pronësi shtetërore dhe vetëm 2% në shkollat fillore në pronësi private. Rreth 2/3 e mësuesve të angazhuar në arsimin fillorë janë të gjinisë femërore me atë që pjesëmarrja e femrave është pak më e lartë te shkollat fillore në pronësi private, krahasuar me shkollat fillore në pronësi shtetërore. Rreth 88% i mësuesve të angazhuar në arsimin fillorë në rajonin e Pollogut kanë angazhim të plotë ndërsa 12% kanë angazhim më të shkurtë se orari i plotë i ngarkesës mësimore. Rreth 78% i mësuesve të angazhuar në arsimin fillorë në rajonin e Pollogut janë të angazhuar me kontratë të paafatizuar dhe rreth 22% me kontratë të afatizuar. Nga numri i përgjithshëm i mësuesve të angazhuar me kontratë të paafatizuar rreth 92.5% kanë ngarkesë të plotë mësimore, ndërsa nga numri i përgjithshëm i mësuesve të angazhuar me kontratë në vepër 73% janë të angazhuar me ngarkesë të plotë mësimore.


Graf.49. Numri i nxënësve në shkollat fillore në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Për fat të keq në rajonin e Pollogut, në periudhën e hulumtuar ka ardhur deri në rrënie permanente në numrin e nxënësve në shkollat fillore. Rrënia ka qenë graduale dhe gati e njëtrajtshme, edhe atë nga 46084 nxënës në vitin shkollor 2000/2001, në 43067 nxënës në vitin shkollor 2005/2006, në 33527 nxënës në vitin shkollor 2010/2011 që të bie në 28624 në vitin shkollor 2019/2020.

Graf.50. Analizë krahasimore e lëvizjes së nxënësve në shkollat fillore sipas komunave për vite të caktuara shkollore



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Siç mundet të vërehet nga grafiku i mëlartëm në periudhën 2000-2020 është shënuar rrënie në numrin e nxënësve në arsimin fillorë në të gjitha komunat në rajonin e Pollogut. Megjithatë rrënia më e madhe është shënuar në komunën e Mavrovës dhe Rostushës ku numri i nxënësve është zvogëluar për 67%, komunën e Tearcës në të cilën në periudhën në fjalë është shënuar përgjysmim në numrin e nxënësve, dhe komunën e Gostivarit ku numri i nxënësve në shkollimin fillorë është zvogëluar për 47%, pra është shumë afër përgjysmimit për një periudhë njëzet vjeçare. Më pak e goditur në këtë drejtim në mesin e komunave në rajonin e Pollogut është komuna e Tetovës te e cila është shënuar rrënie për vetëm 23% në numrin e nxënësve në shkollimin fillorë në periudhën në fjalë.

## 2. Arsimi i mesëm në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

Në vitin shkollor 2019-2020 në rajonin e Pollogut kanë funksionuar gjithsej 18 shkolla të mesme me 10687 nxënës të ndarë në 591 paralele.

Tab.23. Mësimdhënës në shkollat e mesme në rajonin e Pollogut

|          |                      |          |      |
|----------|----------------------|----------|------|
| Gjithsej | Gjithsej             | Gjithsej | 1299 |
|          |                      | Femra    | 719  |
|          |                      | Meshkuj  | 580  |
|          | Me orar të plotë     | Gjithsej | 1173 |
|          |                      | Femra    | 652  |
|          |                      | Meshkuj  | 521  |
|          | Me orar të shkurtuar | Gjithsej | 126  |
|          |                      | Femra    | 67   |
|          |                      | Meshkuj  | 59   |

**Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Në shkollat e mesme në rajonin e Pollogut janë të punësuar gjithsej 1299 mësimdhënës nga të cilët 90% me orar të plotë dhe vetëm 10% me angazhim më të ulët se orari i plotë. Edhe në mesin e shkollave të mesme dominojnë mësimdhënësit e gjinisë femërore me rreth 55%.

Tab.24. mësimdhënës në shkollat e mesme të Pollogut sipas viteve shkollore


|           | Bogovina | Bërvenica | Vrapçishti | Gostivari | Mavrova dhe Rostusha | Tetova |
|-----------|----------|-----------|------------|-----------|----------------------|--------|
| 2000/2001 |          |           | 21         | 277       | 19                   | 534    |
| 2001/2002 |          |           | 23         | 293       | 19                   | 549    |
| 2002/2003 |          |           | 24         | 295       | 19                   | 589    |
| 2003/2004 |          |           | 22         | 304       | 15                   | 593    |
| 2004/2005 |          |           | 21         | 335       | 17                   | 534    |
| 2005/2006 |          |           | 22         | 331       | 16                   | 556    |
| 2006/2007 |          |           | 23         | 369       | 16                   | 585    |

|           |    |    |    |     |    |     |
|-----------|----|----|----|-----|----|-----|
| 2007/2008 |    |    | 13 | 370 | 17 | 599 |
| 2008/2009 |    |    | 15 | 390 | 18 | 591 |
| 2009/2010 |    |    | 15 | 406 | 18 | 680 |
| 2010/2011 |    |    | 14 | 475 | 17 | 721 |
| 2011/2012 |    |    | 14 | 473 | 21 | 762 |
| 2012/2013 |    |    | 14 | 457 | 20 | 805 |
| 2013/2014 |    |    | 23 | 457 | 19 | 813 |
| 2014/2015 |    |    | 22 | 502 | 19 | 847 |
| 2015/2016 | 39 | 11 | 23 | 407 | 20 | 806 |
| 2016/2017 | 38 | 14 | 24 | 408 | 19 | 820 |
| 2017/2018 | 36 | 17 | 24 | 424 | 18 | 827 |
| 2018/2019 | 32 | 29 | 27 | 436 | 18 | 825 |
| 2019/2020 | 32 | 39 | 24 | 392 | 19 | 793 |

**Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Numri i nxënësve në arsimin e mesëm në rajonin e Pollogut është në rrënie e sipër, ndonëse në këtë nivel rrënia është më e vonuar në krahasim me arsimin fillorë, graf.51.

Graf.51. Numri i nxënësve në arsimin e mesëm ne rajonin e Pollogut



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut


Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm, numri i nxënësve në shkollimin e mesëm nuk e ndjek trendin e nxënësve në shkollimin fillor, me atë që në pesë vitet e fundit për 1/3 është zvogëluar numri i nxënësve në arsimin e mesëm në rajonin e Pollogut.

### 3. Arsimi i lartë në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

Në rajonin e Pollogut kanë selitë e tyre tre institucione të arsimit të lartë, edhe atë: Universiteti i Tetovës, Universiteti i Evropës Juglindore, Universiteti "Vizion". Në këtë rajon gjithashtu funksionojnë edhe degë të disperzuara të Universitetit Ndërkombëtarë të Strugës.

Që nga fillimi me funksionim i Universiteteve në gjuhë shqipe, në mënyrë permanente ka qenë në rritje edhe numri i të diplomuarve në rajonin e Pollogut, në fakt në periudhën 2000-2020 ka ardhur deri në dhjetëfishim të numrit të diplomuarve për vit, graf.52.

Graf.52. Studentë të diplomuar në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2019



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Siç mundet të vërehet nga grafiku i mëlartëm në periudhën 2006-2010 është shënuar një rritje drastike e numrit të diplomuarve nga rajoni i Pollogut. Në fakt në vitin 2009 është shënuar dhe maja e numrit të diplomuarve, përkatësisht 1239 që më pas numri i të diplomuarve të rrotullohet midis 900 dhe 1100 të diplomuar nga viti në vit.





Kapitulli




## **Specifika sociale të popullsisë në rajonin e Pollogut**

- 
1. Papunësia në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020
  2. Punësimi në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020
  3. Mbrotjtja sociale në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020
  4. Mbrotjtja e fëmijëve në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

## 1. Papunësia në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

Papunësia në rajonin e Pollogut nuk manifeston ndonjë trend të njëtrajtshëm të lëvizjes, siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëposhtëm. Kështu mundet të vërehet se komfor evidencave zyrtare të Agjencionit për punësim në Republikën e Maqedonisë së Veriut, niveli më i ulët i papunësisë në këtë rajon ka qenë në vitin 2013 që menjëherë më pas të shënojë rritje, ndërsa niveli më i lartë i papunësisë ka qenë i regjistruar në fund të vitit 2007 kur janë regjistruar 46468 persona të papunësuar në rajonin e Pollogut.


Graf.53. Persona të papunësuar në rajonin e Pollogut në periudhën 2007-2020



Grafikoni i përpiluar sipas të dhënave zyrtare të Agjencionit për punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Trendët e kësaj natyre janë mjaft specifike dhe mundet të sinjalizojnë ose lëvizje jo të njëtrajtshme të ekonomisë nacionale dhe të rajonit të Pollogut në veçanti, ose gabime në evidence ose ndryshime në metodologji, ose ndryshime ciklike në regjistrimin e personave të papunësuar. Pra, mbetet komfor të dhënave të mëlartme diskutabile se mos eventualisht bëhet fjalë për abuzim me evidencat e të papunësuarve për nevoja tjera.


Graf.54. Struktura gjinore e të papunësuarve ne rajonin e Pollogut më datë 31.Dhjetor.2021



Grafikoni i përpiluar sipas të dhënave zyrtare të Agjencionit për punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm nuk ekzistojnë gati aspak dallime në strukturën gjinore të papunësuarve në rajonin e Pollogut.

Graf.55. Struktura moshore e të papunësuarve më datë 31.Dhjetor.2021




Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Pra, nuk ekzistojnë dallime në strukturën moshore të papunësuarve në rajonin e Pollogut.

## 2. Punësimi në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

Shkalla e punësimit në rajonin e Pollogut është në nivel shumë të ulët në vazhdimësi gjatë tërë periudhës së analizuar.

Graf.56. Shkalla e punësimit në rajonin e Pollogut për periudhën 2009-2020




Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikonin e mësipërm, shkallë më të lartë të punësimit rajoni i Pollogut ka shënuar në vitin 2019, ndërsa shkallën më të ulët të punësimit prej 29.3% e ka shënuar në vitin 2012.

### 3. Mbrojtja sociale në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

Në periudhën 2000-2016 në rajonin e Pollogut në vazhdimësi është shënuar rritje në numrin e familjeve shfrytëzuese të ndihmës sociale, graf.x.


Graf.57. Familje shfrytëzuese të ndihmës sociale në periudhën 2000-2016 në rajonin e Pollogut



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm, në periudhën 2000-2016 është përgjysmuar numri i familjeve shfrytëzuese të ndihmës sociale, edhe atë nga 12722 në vitin 2000 në 6273 në vitin 2016. Numri më i lartë i familjeve shfrytëzuese të ndihmës sociale në rajonin e Pollogut prej 14477 është shënuar në vitin 2002.

Graf.58. Shfrytëzues të ndihmës sociale në periudhën 2000-2016 në rajonin e Pollogut




Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Logjikisht edhe numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale në rajonin e Pollogut është përgjysmuar në vitin 2016 në krahasim me vitin 2000, edhe atë nga 46970 në vitin 2000 në 23703 në vitin 2016.

#### 4. Mbrojtja e fëmijëve në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

Në pjesën e mbrojtjes së fëmijëve në rajonin e Pollogut, rëndësi e veçantë duhet kushtuar dy komponentave kryesore, edhe atë: numrit të fëmijëve nën përkujdesje në çerdhe dhe numri i të punësuarve në institucionet e kësaj natyre. Kur bëhet fjalë për numrin e fëmijëve nën përkujdesje institucionale në çerdhe, duhet theksuar se në rastin e rajonit të Pollogut vërehet një zvogëlim permanent në numrin e fëmijëve nën përkujdesje, ndonëse trendi në esencë nuk është drejtvizorë dhe vërehen jaze të mëdha në vite individuale. Por edhe pranë kësaj është mëse evidente se numri i fëmijëve nën përkujdesje në çerdhe në periudhën 2000-2017 është përgjysmuar, duke rrënë nga 3529 në vitin 2000 në 1636 në vitin 2017, graf.59.


Graf.59. Fëmijë nën përkujdesje në çerdhe në periudhën 2000-2017 në rajonin e Pollogut



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Kur bëhet fjalë për numrin e personave të punësuar në përkujdesje për fëmijët, duhet theksuar se aktualisht në rajonin e Pollogut janë të punësuar gjithsej 240 persona, graf.60.

Graf.60. Persona të punësuar për përkujdesje për fëmijë



Burimi i të dhënave: Enti Shtetërorë i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut



Kapitulli

# VI


## Qëndrimet e qytetarëve mbi proceset dhe lëvizjet socio-ekonomike në rajonin e Pollogut në periudhën 2000-2020

- 
1. Përshkrim i mostrës
  2. Përshkrim i rezultateve
  3. Komentim i rezultateve

## 1. Përshkrim i mostrës


Paralelisht me studimin e rrjedhave reale dhe të argumentuara socio-ekonomike në rajonin e Pollogut, me qëllim të kornizimit më të drejtë të problematikës komplekse të proceseve dhe rrjedhave në fjalë është realizuar dhe një studim përmes pyetësorit në të cilin kanë qenë të kyçur 1000 banorë të rajonit të Pollogut, persona me prapavija të ndryshme etnike, fetare, moshore, martesore dhe kështu me radhë.

Graf.61. Struktura gjinore e të anketuarve




Shikuar sipas strukturës gjinore, mostra është kryesisht e dominuar nga të anketuar të gjinisë mashkullore të cilët janë të përfaqësuar me 68% në totalin e të anketuarve krahasuar me të anketuarit e gjinisë femërore të cilët janë të përfaqësuar me vetëm 32% në totalin e të anketuarve. Ndonëse në këtë drejtim paraqitet një disbalanc, i njëjti rezulton nga pamundësia për të siguruar respondentë të gjinisë femërore të moshave më të vjetra, duke patur para sysh faktin që në pjesën më të madhe të rasteve pyetësorët janë plotësuar përkatësisht siguruar në kontakte individuale e shumë më pak në formë të organizuar përmes rinisë studentore dhe përmes rrjeteve sociale në disponim.

Graf.62. Struktura moshore e të anketuarve




Mostra është mjaft e balancuar në kontekst të strukturës moshore të anketuarve. Kështu grup moshave më të reja përkatësisht kategorisë së personave deri 35 vjeçarë u përkasin diç më tepër se 1/3 e totalit të anketuarve. Rreth 35% nga numri i përgjithshëm i personave të anketuar i përkasin një mëzo-moshe, pra grup moshave midis 26 dhe 55 vjeçare dhe pjesa tjetër prej afro 30% i totalit të anketuarve i përkasin grup moshave 56 vjeç e më lartë.

Graf.63. Struktura arsimore e të anketuarve



Mostra është plotësisht e dominuar nga persona që kanë arritur një nivel të caktuar të gradës universitare, ose janë në proces të realizimit të njëjtës. Kështu 23.6% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve janë studentë në studime deridiplomike dhe studime të ciklit të dytë, mbi 42% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve kanë arritur të përfundojnë arsimin universitar të ciklit të parë të studimeve dhe janë përcaktuar të mos vazhdojnë me ciklet tjera studimore, ndërsa afro 22% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve kanë përfunduar studime të ciklit të dytë ose të ciklit të tretë studimorë. Rreth 19% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve kanë të kryer vetëm shkollimin fillorë ose vetëm shkollimin e mesëm dhe nuk kanë vijuar me studime universitare. Pra, shikuar sipas strukturës arsimore të anketuarve mostra garanton një cilësi adekuate të përgjigjeve të dhëna nga ana e respondentëve.


Graf.64. Struktura e të anketuarve sipas përkatësisë etnike



Struktura e mostrës sipas strukturës etnike të popullsisë në esencë reflekton karakterin multientnik të rajonit të Pollogut. Kështu, pjesa më e madhe e mostrës është e dominuar nga respondentë që u përkasin dy bashkësive më të mëdha etnike në vend, pra bashkësisë etnike shqiptare dhe maqedonase të përfaqësuara me 42.3% dhe 31.2% në strukturën e mostrës. Pjesën tjetër të mostrës e përbejnë bashkësi tjera etnike, përkatësisht turqit, romët dhe të tjerët. Në suaza të anketës së kryer kanë qenë të kyçur dhe personë të bashkësisë etnike fetare islame që gjuhë të


zakontë komunikimi e kanë gjuhën maqedonase, të referuar në pyetësor si torbeshë komfor vetë deklarimit personal të personave në fjalë.

Graf.65. Struktura e të anketuarve sipas përkatësisë fetare




Struktura fetare e të anketuarve gati këmba-këmbës reflekton strukturën etnike të popullsisë. Kështu 64.4% i të anketuarve janë deklaruar se i përkatësin bashkësisë fetare myslimane, rreth 34.5% bashkësisë fetare ortodokse dhe rreth 1.1% kanë deklaruar se i pëkasin ndonjë bashkësie tjetër fetare. Qëllimisht në suaza të mostrës nuk është bërë kërkesë që të anketuarit të pozicionojnë vehten në ndonjërin nga krahët e bashkësive të caktuara fetare, meqë ndonëse e rëndësishme është vlerësuar si faktor me peshë sekondare për nevojat e studimit për përpilim të disertacionit të magjistraturës.

Graf.66. Struktura e të anketuarve sipas tipit të vendbanimit



Pjesa më e madhe e respondentëve janë persona me vendbanim në fshat, kategori kjo së cilës i përkasin rreth 73.6% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, krahasuar me kategorinë e respondentëve që janë me vendbanim të përhershëm në qytet, kategori kjo së cilës i përkasin rreth 26.4% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve. Ndonëse në shikim të parë mundet të fitohet përshtypje e disbalancit në këtë drejtim, duhet theksuar se një strukturë e tillë e respondentëve në fakt e reflekton në mënyrë adekuate strukturën reale të popullsisë në Pollog sipas këtij kriteri. Kështu, nga gjithsej nëntë komuna vetëm dy janë komuna me seli në qytet, por edhe në ato komuna mbi gjysma e popullsisë janë me vendbanim permanent në ndonjërin nga fshatrat përkatëse.

Graf.67. Struktura e të anketuarve sipas vendbanimit




Rreth 46% i të anketuarve janë me rezidencë permanente në ndonjërin nga dy komunat me seli në qytet kurse pjesa tjetër janë me rezidencë në komunat me seli në fshat. Rreth 37% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve i përkasin pjesë së Pollogut të epërme, ndërsa pjesa tjetër Pollogut të Poshtëm. Ndonëse në mostër janë të kyçur banorë të të gjitha nëntë komunave që bëjnë pjesë në rajonin e Pollogut, jo të gjitha komunat janë njësoj të përfaqësuara. Pra, siç edhe mundet të vërehet nga grafiku i mëlartëm komunat e mëdha kanë dhe përfaqësim më të lartë në strukturën e mostrës. Komuna me më pak përfaqësim në strukturën e mostrës është komuna e Mavrovës dhe Rostushës e cila një rendi është edhe komuna më e

vogël sipas numrit të popullsisë, por më e madhja sipas gjerësisë së sipërfaqes në rajonin e Pollogut.

## 2. Përshkrim i rezultateve

Me qëllim të sigurimit të informatave reale mbi qëndrimet e qytetarëve të Pollogut për trendët socio-ekonomik në këtë rajon, respondentët janë ballafaquar me një sërë të pyetjeve që kanë synuar sigurimin e këndvështrimit të tyre për natyrën e trendëve në fjalë, në kontekst të shkaqeve dhe të pasojave. Kjo me qëllim që të dhënat statistikore të mishërohen dhe me komponentin njerëzorë në suaza të studimit të realizuar.


Graf.68. Besueshmëria e qytetarëve në rezultatet e regjistrimit të popullsisë në vitin 2002



Së pari duhet theksuar fakti se një pjesë e madhe e respondentëve shprehin dyshime në saktësinë e të dhënave të reflektuara në regjistrimin e fundit të popullsisë në vend. Kështu, mosbesim në saktësinë e rezultateve në fjalë kanë shprehur rreth 61.4% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve që në esencë paraqet një shkallë shumë të lartë të mosbesimit në një aktivitet që për nga natyra duhet të jetë statistikore dhe me efekte mbi planifikimet, por në realitet në rastin e Maqedonisë së Veriut, por edhe një varg të shteteve me ekonomi dhe demokraci shumë më të

zhvilluar reflekton pasoja të drejtpërdrejta mbi organizimin e jetës së përgjithshme shoqërore në vend. Kështu, një shkallë kaq e lartë e mosbesimit në rezultatet e regjistrimit në mënyrë të drejtpërdrejtë mundet të rezultojë dhe me shkallë më të lartë të mosbesimit në mes bashkësive më të mëdha etnike dhe fetare në këtë rajon, por edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përgjithësi.


Graf.69. Shkalla e pajtueshmërisë së bashkësive etnike se regjistrimi i vitit 2002 nuk reflekton në mënyrë adekuate strukturën reale etnike të popullsisë në Pollog (në %)



Me përjashtim të respondentëve të bashkësisë etnike maqedonase dhe rome, në mesin e respondentëve dominues është qëndrimi se struktura reale etnike e popullsisë në vend nuk është reflektuar në rezultatet e regjistrimit të fundit të popullsisë. Pritshëm kjo ndjenjë ka rezultuar të jetë më e shprehur në mesin e respondentëve shqiptarë, 96% i të cilëve ndajnë një mendim të tillë. Nga ana tjetër, ndoshta dhe habit fakti që madje 88% i myslimanëve që flasin si gjuhë amë gjuhën maqedonase janë të po të njëjtit mendim. Këtë mendim e ndajnë edhe 68% i popullsisë turke, 41% i popullsisë rome dhe vetëm 32% i popullsisë maqedonase në vend.


Graf.70. Shkalla e pajtueshmërisë së bashkësive fetare se të dhënat mbi strukturën fetare të popullsisë në Pollog nuk e reflektojnë realitetin (në %)





Në grafikun e mëlartëm janë të paraqitura të dhëna mjaft specifike mbi besueshmërinë e statistikave zyrtare mbi strukturën fetare të popullsisë siç është reflektuar në statistikat zyrtare. Kështu 73% nga muslimanët e anketuar të cilët kanë shprehur dyshim në rezultatet e regjistrimit të popullsisë, janë të mendimit se në statistikat zyrtare nuk është në mënyrë të saktë dhe të drejtë e reflektuar struktura fetare e popullsisë në rajonin e Pollogut. Kundrejt tyre një mendim të kësaj natyre e ndajnë vetëm 21% nga totali i ortodoksëve që kanë shprehur dyshim në rezultatet e regjistrimit të fundit të popullsisë në vend.


Graf.71. Perceptimet e respondentëve mbi arsyet e rënies së numrit të nxënësve në shkollim fillorë në rajonin e Pollogut



Pjesa dërrmuese e respondentëve si arsye kryesore për rënien permanente të numrit të nxënësve në shkollat fillore në rajonin e Pollogut në vend i theksojnë rënien e natalitetit dhe emigrimet s shprehura të popullsisë. Në fakt, mbi 52% i të anketuarve si shkaktar kryesor të një trendi të kësaj natyre i theksojnë emigrimet ndërsa afro 47% si shkak kryesor e theksojnë rënien e natalitetit. Një pakicë e vogël e respondentëve, përkatësisht vetëm 7 respondentë janë të mendimit se arsye për këtë trend është fakti se ato që kanë mundësi financiare i dërgojnë në shkollim fillorë fëmijët e tyre në shkolla jashtë vendit që nënkupton edhe jashtë rajonit të Pollogut.

Një fakt tjetër që duhet theksuar në këtë drejtim është edhe një shkallë shumë e lartë e pesimizmit të respondentëve në kontekst të pritjeve të tyre për trendët e numrave të nxënësve në arsimin fillorë në vend. Kështu, rreth 92% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve janë të mendimit se situata do të përkeqësohet edhe në vitet në vijim dhe vetëm 4% i të anketuarve janë të mendimit se në të ardhmen do shënohet rritje e numrit të nxënësve në shkollimin fillorë në rajonin e Pollogut.


Graf.72. Perceptimet e respondentëve mbi cilësinë në shkollim fillorë në rajonin e Pollogut



Respondentët shprehin rezerva të mëdha kur bëhet fjalë për vlerësimet e tyre mbi cilësinë në arsimin fillorë në rajonin e Pollogut. Kjo dëshmohet me vetë faktin se më pak se 1/5 e të anketuarve pajtohen me qëndrimin se cilësia është në nivel të kënaqshëm dhe mbi 4/5 pajtohen me qëndrimin se cilësia në arsimin fillorë është në nivel të pakënaqshëm. Shqetësues është fakti se në mesin e të anketuarve dominon qëndrimi se cilësia në arsimin fillorë është në rrënie permanente. Në fakt, afro 95% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve janë të mendimit se krahasuar me periudhën e një decenie më herët, cilësia në arsimin fillorë është ulur në vend që të rritet dhe mbi 95% i të anketuarve janë të mendimit se cilësia në arsimin fillorë ka rrënë në vazhdimësi. Pos kësaj, respondentët shprehin dhe një dozë të lartë të

pesimizmit mbi të ardhmen e arsimit filorë në rajonin e Pollogut, me vetë faktin që vetëm një në çdo dhjetë të anketuar është shpreh mendimin se ka gjasa që në të ardhmen të përmirësohet cilësinë në arsimin fillorë në rajonin e Pollogut.


Graf.73. Perceptimet e respondentëve mbi arsyet e rënies së numrit të nxënësve në shkollim e mesëm në rajonin e Pollogut



Ngjashëm si në rastin e shkollimit fillorë, pjesa dërmuese e respondentëve si arsye kryesore për rënien permanente të numrit të nxënësve në shkollat e mesme në rajonin e Pollogut në vend i theksojnë rënien e natalitetit dhe emigrimet e shprehura të popullsisë. Në fakt, mbi 62% i të anketuarve si shkaktar kryesor të një trendi të kësaj natyre i theksojnë emigrimet ndërsa afro 35% si shkak kryesor e theksojnë rënien e natalitetit. Një pakicë e vogël e respondentëve, përkatësisht vetëm 2.8% i respondentëve janë të mendimit se arsye për këtë trend është fakti se ato që kanë mundësi financiare i dërgojnë në shkollim të mesëm fëmijët e tyre në shkolla jashtë vendit që nënkupton edhe jashtë rajonit të Pollogut.


Edhe në rastin e shkollimit të mesëm vërehet një shkallë shumë e lartë e pesimizmit të respondentëve në kontekst të pritjeve të tyre për trendët e numrave të nxënësve në arsimin fillorë në vend. Kështu, rreth 94% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve janë të mendimit se situata do të përkeqësohet edhe në vitet në vijim dhe vetëm 5% i të anketuarve janë të mendimit se në të ardhmen do shënohet rritje e numrit të nxënësve në shkollimin e mesëm në rajonin e Pollogut.

Graf.74. Perceptimet e respondentëve mbi cilësinë në shkollim e mesëm në rajonin e Pollogut




Respondentët shprehin rezerva të mëdha edhe kur bëhet fjalë për vlerësimet e tyre mbi cilësinë në arsimin e mesëm në rajonin e Pollogut. Kjo dëshmohet me vetë faktin se vetëm 14% e të anketuarve pajtohen me qëndrimin se cilësia është në nivel të kënaqshëm dhe afro 86% pajtohen me qëndrimin se cilësia në arsimin e mesëm është në nivel të pakënaqshëm. Shqetësues është fakti se në mesin e të anketuarve dominon qëndrimi se cilësia në arsimin e mesëm është në rrënie permanente. Në fakt, rreth 92% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve janë të mendimit se krahasuar me periudhën e një decenie më herët, cilësia në arsimin e mesëm është ulur në vend që të rritet dhe mbi 91% i të anketuarve janë të mendimit se cilësia në arsimin e mesëm ka rënë në vazhdimësi. Pos kësaj, respondentët shprehin dhe një dozë të lartë të pesimizmit mbi të ardhmen e arsimit fillorë në rajonin e Pollogut, me vetë faktin që vetëm 8.5% nga numri i përgjithshëm i personave të anketuar janë të mendimit se ka gjasa që në të ardhmen të përmirësohet cilësia në arsimin e mesëm në rajonin e Pollogut.

Graf.75. Perceptimet e respondentëve mbi gjendjen ekonomike në rajonin e Pollogut



Respondentët shprehin një pesimizëm të skajshëm kur bëhet fjalë për trendët e përgjithshëm ekonomik në rajonin e Pollogut. Kjo dëshmohet me vetë faktin se vetëm 26% i të anketuarve janë të mendimit se ekonomia në rajonin e Pollogut është duke lëvizur në drejtim të duhur, vetëm 30% janë të mendimit se gjendja ekonomike e popullsisë sot është më e mirë krahasuar me periudhën para vitit 2000, vetëm 30.5% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve vlerësojnë se gjendja ekonomike e familjes së tyre sot është më e mirë krahasuar me periudhën para vitit 2000, vetëm 30% janë të mendimit se nga vit 2000 gjendja ekonomike e popullsisë është përmirësuar në vazhdimësi, dhe vetëm 30.6% i të anketuarve janë të mendimit se nga viti 2000 gjendja ekonomike e familjes së tyre është përmirësuar në vazhdimësi. Pra, realisht shikuar as 1/3 e të anketuarve nuk kanë qëndrim pozitiv mbi trendët dhe lëvizjet ekonomike në rajonin e Pollogut në dy decaeniet e fundit.


Graf.76. Perceptimet e respondentëve mbi ndërtimtarinë në rajonin e Pollogut



Edhe pranë përfitimeve reale ekonomike nga zhvillimi i sektorit të ndërtimtarisë, qytetarët e anketuar shprehin pakënaqësi lidhur me mënyrën e realizimit të zhvillimit të këtij sektori gjatë dy dekenieve të fundit në veçanti. Ndonëse gati 100% e të anketuarve janë të mendimit se ndërtimtaria është sektor i rëndësishëm i ekonomisë së Pollogut dhe si e tillë duhet zhvilluar në vazhdimësi, përsëri pjesa më e madhe e të anketuarve janë të mendimit se duhet ndryshuar qasja në ndërtime në qytetet e rajonit të Pollogut, përkatësisht në Tetovë dhe Gostivar. Kështu, qytetarët janë të mendimit se duhet kaluar në një lloj të zgjerimit të qyteteve në vend të ngufatjes së mëtejme të hapësirave ekzistuese përmes ndërtimit të lagjeve të reja që do të ishin ndërtuar me standardet e caktuara hapësinore dhe do kishin mundësuar edhe një jetesë më të rehatshme për banorët e tyre. Kështu afro 85% nga numri i përgjithshëm i të anketuarve janë të mendimit se

është tepruar me numrin e ndërtimeve të larta në qytetet e Pollogut, 91.5% janë të mendimit se qytetet janë të ngulfatur si rezultat i ndërtimeve të paplanifikuara, rreth 94.5% janë të mendimit se planet urbanistike nuk përfillin ndikimin negativ të ndërtimtarisë në ambientin jetësorë, afro 99% i të anketuarve janë të mendimit se qyteteve në Pollog u mungojnë vend parkimet dhe kështu me rradhë.

Graf.77. Perceptimet e respondentëve mbi bujqësinë dhe blegtorinë në rajonin e Pollogut




Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm, në mesin e respondentëve mbizotëron qëndrimi se bujqësia, blegtoria dhe bletaria nuk janë mjaftueshëm të zhvilluar dhe se duhet menduar në drejtim të zhvillimit më




intensiv të tyre në të ardhmen. Siç mundet të vërehet pjesa më e madhe e të anketuarve janë të mendimit se përkrahja shtetërore në formë të subvencioneve është e dobishme por është e pamjaftueshme. Pos kësaj, në mesin e respondentëve mbizotëron qëndrimi se pos përkrahjes financiare bujqve, bletarëve dhe blegtorëve duhet ofruar edhe përkrahje shtesë në formë të shërbimeve konsultuese për mënyrat e ndryshme të avancimit të bujqësisë, blegtorisë dhe bletarisë. Në këtë drejtim duhet theksuar se vetëm 8% i të anketuarve kanë deklaruar se merren dhe me bujqësi ose blegtori, ndërsa si arsye më të zakonata për këtë theksohen madhësia e pamjaftueshme e parcelave bujqësore dhe mungesa e përvojës në bujqësi dhe blegtori.

Graf.78. Arsye më të zakonata për ikje prej bujqësisë dhe blegtorisë



Pra, siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mëlartëm 1/3 e të anketuarve refuzimin për kyçe në veprimtari bujqësore dhe blegtorale ia përshkruajnë mungesës së përvojës në këto veprimtari, afro ¼ ia përshkruajnë mungesës së përkrahjes shtetërore dhe afro 38% mungesës së arsyeshmërisë ekonomike për shkak të mungesës së parcelave më të mëdha bujqësore.

Graf.79. Perceptimet e respondentëve mbi arsyet e emigrimeve të popullsisë së Pollogut



Siç mundet të vërehet nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm si arsye më të zakonshme për emigrim të popullsisë së Pollogut në botën e jashtme respondentët e theksojnë mungesën e mundësive për punësim në vendlindje, mendim ky të cilin e ndajnë rreth 55% i respondentëve. Rreth 17% i respondentëve arsye kryesore për emigrim të popullsisë nga Pollogu e theksojnë lartësinë e pagave.

### 3.Komentim i rezultateve

Studimi i qëndrimeve të qytetarëve ka shërbyes si shtesë ndaj studimit të të dhënave statistikore e që i përshkruajnë trendët dhe rrjedhat socio-ekonomike në rajonin e Pollogut. Studimi në fjalë ka nxjerrë në pah një shkallë shumë të ulët të besimit në të dhënat statistikore në mesin e qytetarëve në rajonin e Pollogut si dhe një shkallë të shprehur të pesimizmit në mesin e banorëve të Pollogut për çështje kyç siç është arsimi, degët e ndryshme ekonomike, emigrimet e popullsisë dhe kështu me rradhë.

## Diskutime përmbyllëse

### Diskutimi i hipotezave të parashtruara

Disertacioni i magjistraturës ka patur për synim primarë shqyrtimin e tre hipotezave edhe atë:

- Rajoni i Pollogut karakterizohet me trende të pavolitshme socio-ekonomike në rrjedhën e deritanishme të shek. XXI, në krahasim me rajone tjera të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Nuk ekzistojnë dallime të mëdha në trendët socio-ekonomike në mes dy komunave urbane të rajonit të Pollogut.
- Ekzistojnë dallime të shprehura në trendët socio-ekonomike në mes komunave urbane dhe rurale të rajonit të Pollogut.

Analizat krahasimore të realizuara në suaza të pjesës së parë të disertacionit të magjistraturës shpjen drejt përfundimit se Rajoni i Pollogut në periudhën e hulumtuar ka shënuar numër më të madh të imigrantëve krahasuar me rajonet tjera në vend, me përjashtim të rajonit të Shkupit i cili ka dhe përqendrim dukshëm më të madh të popullsisë. Gjithnjë zyrtarisht në periudhën në fjalë rajoni i Pollogut ka shënuar edhe shkallë më të ulët të emigrimeve permanente krahasuar me rajonet tjera në vend, ndonëse përvojat e dëshmojnë të kundërtën. Me përjashtim të rajonit të Shkupit, rajoni i Pollogut në vazhdimësi ka patur dhe numër më të madh të nxënësve në arsimin fillorë dhe të mesëm, ndërsa në decenien e fundit është shënuar trend pozitiv edhe në numrin e studentëve të diplomuar. Rajoni i Pollogut karakterizohet më numër relativisht të madh të mësuesve në shkollimin fillorë, por jo dhe me proporcion të përkeqësuar në relacionin numër i nxënësve kundrejt numrit të mësuesve të angazhuar. Rajoni i Pollogut ka një proporcion të volitshëm të numrit të nxënësve sipas numrit të shkollave të mesme. Pos kësaj, zyrtarisht nuk vërehen dallime të mëdha negative në shkallën e punësimit dhe të papunësisë, hapjes dhe mbylljes së bizneseve, përkujdesit social ose trendëve tjerë në rajonin e Pollogut dhe rajoneve tjera në vend. Andaj, studimi në fjalë nuk mundëson konfirmimin e hipotezës së parë.

Të dhënat statistikore, në shikim të parë lënë përshtypje se ekzistojnë dallime të shprehura në trendë socio-ekonomike në mes dy komunave me seli në qytet si dhe në mes komunave me seli në qytet nga njëra anë dhe komunave me seli në fshat nga ana tjetër, megjithatë përpjesëtuat për kokë banori dallimet në relacionet në fjalë janë dallime minore. Ekzistojnë dallime të caktuara në intensitetin e afarizmit në relacionin Tetovë-Gostivar, si dhe dallim evidente në rrjedhën e migrimeve të brendshme në mes komunave me seli në fshat dhe atyre me seli në qytet. Megjithatë edhe këto lëvizje nuk janë në realitet lëvizje nga komuna në komunë, por më tepër duhet kundruar si lëvizje fshat-qytet e që janë dhe normale për botën e zhvilluar. Pra, disertacioni i magjistraturës në këto relacione ka nxjerrë në pah dallime të vogla, por jo të natyrës esenciale. Kjo vjen si rezultat i faktit që në këtë rajon, vendbanimet fshatare janë relativisht të mëdha, realisht shikuar me madhësinë e disa vendbanimeve urbane në rajonet tjera të vendit, karakterizohet me popullsi mjaft aktive e cila zhvillon në masë të madhe edhe veprimtarinë afariste duke mos ardhur deri në ndonjë diskrepancë të madhe, gjithnjë duke analizuar për kokë banori, komfor asaj se sa banorë realisht janë prezent në vendbanimet e ndryshme. Andaj, mundet të konkludohet se disertacioni i magjistraturës ka mundësuar vërtetimin e hipotezës së dytë, por jo edhe të hipotezës së tretë të parashtruar.

### **Përfundime dhe rekomandime**

Bazuar në studimin e realizuar duhet theksuar se edhe pranë ekzistimit të një përtpje gjenerale negative për rrjedhat dhe trendët socio-ekonomik në rajonin e Pollogut, përsëri krahasuar me shumë rajone tjera, së paku zyrtarisht, treguesi për rajonin e Pollogut nuk janë edhe shumë negativ. Megjithatë, të dhënat statistikore në mënyrë të drejtpërdrejtë sfidohen përmes qëndrimeve të qytetarëve të definuar falë studimit të mendimeve të tyre e të cilat përshkruajnë një situatë socio-ekonomike jo edhe të volitshme në këtë rajon.

Ndonëse në shikim të parë ndoshta edhe të përgjithshme dhe të pritura, gjetjet e realizuara në suaza të punimit rezultojnë me nevojën e theksimit të disa rekomandimeve, para së gjithash për bërësit e politikave në vend:

- Edhe pse në rastin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ndarja territoriale e vendit ka një komponentë të shprehur politike, përsëri me qëllim të racionalizimit të kostove dhe ngritjes së cilësisë së shërbimeve

për qytetarët duhet rishqyrtuar organizimi territorial dhe numri i komunave. Kjo në veçanti duke patur para sysh se pjesën më të madhe të shërbimeve që kanë të bëjnë me shëndetësinë, arsimin, punët sociale etj qytetarët e komunave me seli në fshat i realizojnë në komunat me seli në qytet.

- Në nivel shtetërorë duhet rishqyrtuar politikat e menaxhimit të shkollimit fillorë, duke ndërtuar strategji reale e jo copy-paste sipas përvojave të huaja e të cilat do të kishin rezultuar me një përmirësim adekuat të cilësisë së arsimit fillorë në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përgjithësi dhe rajonin e Pollogut në veçanti.
- Në nivel shtetërorë duhet rishqyrtuar politikat e menaxhimit të shkollimit të mesëm, duke ndërtuar strategji reale e jo copy-paste sipas përvojave të huaja e të cilat do të kishin rezultuar me një përmirësim adekuat të cilësisë së arsimit të mesëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut në përgjithësi dhe rajonin e Pollogut në veçanti.
- Duhet rishqyrtuar politikat e shpërndarjes së përkrahjes financiare për bujqit dhe blegtorët, duke inkorporuar më shumë mekanizma kontrolli që do të kishin rezultuar shpërndarje të subvencioneve në fjalë në baza më reale dhe në këtë mënyrë do të kishin rezultuar edhe me një rritje më të madhe të interesit të qytetarëve për tu kyçur në veorimtari bujqësore dhe blegtorale.
- Duhet rishqyrtuar politikat e shfrytëzimit dhe privatizimit të sipërfaqeve bujqësore me qëllim të krijimit të parakushteve për bashkim të sipërfaqeve të vogla në tërësi më të mëdha me çka mundet investitorë të caktuar të qasen edhe në prodhimtari industriale bujqësore.
- Duhet ndërtuar qendër koleksionuese për produktet bujqësore për rajonin e Pollogut, meqë me politikat ekzistuese ky rajon është i përjashtuar nga mundësia në fjalë.
- Duhet ri-dizajnuar politikat në lëminë e ndërtimtarisë jo me qëllim të uljes së intensitetit të ndërtimtarisë, por në drejtim të përshtatjes së intensitetit në fjalë me kapacitetet reale infrastrukturore të qyteteve të rajonit të Pollogut.

- Duhet insistuar në një orientim më të lartë në investitorëve të huaj për të investuar në zonën ekonomike në Tetovë me çka do ishin krijuar midis tjerash edhe më shumë mundësi për sigurimin e vendit të punës në vendlindje e me këtë do të ishte zbutur dhe shkalla e emigrimeve.
- Dhënie e statusit të investitorit të huaj për mërgimtarët e interesuar për realizim të investimeve në vend, me çka do të ishin krijuar edhe mundësi të rritura për lehtësime për zhvillimin e aktivitetit afariste të tyre.

## Bibliografia

- Barker, Elisabeth, Macedonia: Its Place in Balkan Power Politics (London and New York: Royal Institute for International Affairs, 1950)
- Crampton, RJ, The Balkans Since the Second World War (London: Pearson Education, 2002)
- Glenny, Misha, The Balkans, 1804–1999: Nationalism, War and the Great Powers (London: Granta Books, 1999)
- Mazower, Mark, The Balkans (London: Weidenfeld and Nicolson, 2001)
- Etem Aziri. The Development of Democratic Capacities: A Precondition for Building a Functional Multi-ethnic society in the Republic of Macedonia. In Social Movements in Central and Eastern Europe: Dynamics of protest 25 years after the fall of communism, pp. 520-529. Editura Universitatii Din Bucuresti, Bukuresti, 5 / 2015
- Etem Aziri, Emine Emurllai. The Ohrid Framework Agreement and the Multiethnic Future of the Republic of Macedonia. In Academic Journal of Interdisciplinary Studies, pp. 472-477. MCSER Publishing, Rome, Italy, 7 / 2014
- Etem Aziri. Inter-ethnic relations in the Republic of Macedonia before and after the Ohrid Framework Agreement. In Balkans: Foreign Affairs, Politics and Socio-Cultures, pp. 131-156. Epoka University, 10 / 2011
- Etem Aziri. Sociologjia. SEE University, Tetovw, 2010
- Etem Aziri. Proceset dhe lëvizjet socio-ekonomike në Pollog. Logos A, Shkup, 2002
- International Organization for migration (IOM): The Former Yugoslav Republic of Macedonia Migration Profile, 2008
- Abercrombie, N. and Urry, J. (1983) Capital, Labour and the Middle Class, London: Allen and Unwin.
- Acker, J. (1990) 'Hierarchies, jobs, bodies: a theory of gendered organization', Gender and Society 5:139–58.
- Agg, J. and Phillips, M. (1998) 'Neglected gender dimensions of rural social restructuring', in P.Boyle and K.Halfacree (eds) Migration into Rural Areas: Theories and Issues, London: Wiley, pp. 252–79.

- Bradley, H. (1989) *Men's Work, Women's Work*, Cambridge: Polity Press.
- Bruegel, i. (1996) 'The trailing wife: a declining breed? Careers, geographical mobility and household conflict in Britain, 1970–89', in R.Crompton, D.Gallie and K.Purcell (eds) *Changing Forms of Employment*, London: Routledge, pp. 235–58
- Abrahamson, P. (1997), 'Combating Poverty and Social Exclusion in Europe', in Beck, Van der Maesen and Walker (eds), *The Social Quality of Europe* (The Hague: Kluwer Law International), 127–56.
- Addison, J. and Siebert, W. (1993), 'The UK Labour Market Institutions, Law and Performance', in Hartog and Theeuwes (eds), *Labour Market Contracts and Institutions* (Amsterdam: Elsevier), 351–80
- Allen, M. (1993), 'Do the Unemployed Have the Answers?', in Keane, *The Jobs Crisis* (Dublin: Mercier Press), 52–63.
- Alm, S. (2001), *The Resurgence of Mass Unemployment. Studies of the Social Consequences of Joblessness in Sweden in the 1990s* (Stockholm: Swedish Institute for Social Research).
- Atkinson, A.B. and Micklewright, J. (1991), 'Unemployment Compensation and Labor Market Transitions: A Critical Review', *Journal of Economic Literature* 29, 1679–727. Atkinson, A.B. and Mogensen, G.V. (eds) (1993), *Welfare and Work Incentives* (Oxford: Clarendon Press). Atkinson, R. and Davoudi, S. (2000), 'The Concept of Social Exclusion in the European Union: Context, Development and Possibilities', *Journal of Common Market Studies* 38:3, 427–48.
- Baker, D., Glyn, A., Howell, D. and Schmitt, J. (2005), 'Labour Market Institutions and Unemployment: Assessment of the Cross-Country Evidence', in Howell (ed.), *Fighting Unemployment. The Limits of Free Market Orthodoxy* (Oxford: Oxford University Press), 72–119.
- Barbier, J.-C. (2005), 'The European Employment Strategy, a Channel for Activating Social Protection?', in Zeitlin and Pochet (eds), *The Open Method of Co-ordination in Action. The European Employment and Social Inclusion Strategies* (Brussels: ED), 417–45.
- Bertola, G., Blau, F. and Kahn, L. (2002), 'Comparative Analysis of Labour Market Outcomes: Lessons from the United States from International Longrun Evidence', in Krueger and Solow (eds), *The*



Roaring Nineties: Can Full Employment Be Sustained? (Russell Sage and Century Foundations), 159–218.

- Bonoli, G. (1997), 'Classifying Welfare States: A Two-dimension Approach', *Journal of Social Policy* 26, 351–72.
- Bonoli, G. (2003), 'Social Policy through Labour Markets: Understanding National Differences in the Provision of Economic Security to Wage-Earners', *Comparative Political Studies* 36, 1007–1030.
- Bonoli, G. (2007), 'Time Matters: Postindustrialisation, New Social Risks and Welfare State Adaptation in Advanced Industrial Democracies', *Comparative Political Studies* 40. Börzel, T.A. (2002), 'Pace-Setting, Foot-Dragging, and Fence-Sitting: Member State Responses to Europeanization', *Journal of Common Market Studies* 40:2, 193–214.
- Bradley, J. (1989), 'Competitiveness and Output: What Empirical Models Show?', in McAleese, *Competition and Industry: The Irish Experience* (Dublin: Gill and Macmillan), 22–38.
- Bradshaw, J. (1996), *Lone Mothers and Work* (Findings, York: Joseph Rowntree Foundation). Breathnach, P. (2002), 'Social Polarization in the Post-Fordist International Economy: Ireland in International Context', *Irish Journal of Sociology* 11:1, 3–33.
- Dwyer, P. (2000), *Welfare Rights and Responsibilities: Contesting Social Citizenship* (Bristol: Policy Press).
- Dwyer, P. (2002), 'Making Sense of Social Citizenship: Some User Views on Welfare Rights and Responsibilities', *Critical Social Policy* 22:2, 273–99.
- Dwyer, P. (2004a), *Understanding Social Citizenship: Themes and Perspectives for Policy and Practice* (Bristol: Policy Press)
- Gallie, D. (ed.) (2004), *Resisting Marginalization. Unemployment Experience and Social Policy in the European Union* (Oxford: Oxford University Press).
- Gallie, D. and Benoît-Guilbot, O. (eds) (1994), *Long-Term Unemployment* (London: Pinter Publishers).
- Gallie, D., Marsh, C. and Vogler, C. (eds) (1994), *Social Change and the Experience of Unemployment* (Oxford: Oxford University Press).

- Gallie, D. and Paugam, S. (eds) (2000), *Welfare Regimes and the Experience of Unemployment in Europe* (Oxford: Oxford University Press).
- Gallie, D. and Russell, H. (1998), 'Unemployment and Life Satisfaction', *Archives Européennes de Sociologie* XXXIX, 3–35.
- Gallie, D., White, M., Cheng, Y. and Tomlinson, M. (1998), *Restructuring the Employment Relationship* (Oxford: Clarendon Press). Gamson, W.A. (1992), *Talking Politics* (Cambridge: Cambridge University Press).